



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

#### *Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik*

#### **PROCESVERBAL**

Tiranë, më 11.7.2023, ora 12:00

#### **Drejton mbledhjen:**

**Flutura Aça – kryetare e Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

Vijon diskutimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin, nr. 53/2019, datë 18.7.2019 “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë””, propozim i një grupi deputetësh (*komision përgjegjës*).

#### **Marrin pjesë:**

Flutura Aça, Petro Koçi, Lindita Buxheli, Eduard Ndreca, Teuta Ramaj, Florenc Spaho, Ilir Topi, Enslemvera Zake, Ina Zhupa, Andia Ulliri, Merita Bakiu, Kastriot Piroli dhe Ismeti Beqiraj (*anëtar zëvendësues*).

#### **Mungojnë:**

Blerina Gjylameti, Dasantila Tahiraj, Ilir Metaj, Meri Markiçi, Agron Gjekmarkaj, Eralda Bano dhe Oriela Nebijaj.

#### **Të ftuar:**

Skënder Gjinushi – Kryetar i Akademisë së Shkencave,  
Vasil Tole – Nënkryetar i Akademisë së Shkencave,  
Shaban Sinani – sekretari i Përgjithshëm i Akademisë së Shkencave,  
Gentian Opre – drejtor në Drejtorinë e Analizës dhe Programimit Buxhetor në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

## HAPET MBLEDHJA

**Flutura Aça** – Përshëndetje, të nderuar kolegë!

Fillojmë mbledhjen e radhës të Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

Siç e dini, sot kemi vendosur të zhvillojmë diskutimin, që, në fakt, e filluam dje, por nuk e bëmë dot për arsye se mungonin dy materiale të domosdoshme për të vijuar debatin.

Sot do të diskutojmë projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 53/2019, datë 18.7.2019 “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”, që është propozuar nga një grup deputetësh. Komisioni ynë është komision përgjegjës, pasi më parë projektligji ka kaluar në Komisionin e Ligjeve, me materialin e të cilit jeni njohur dje.

Të ftuar janë: zoti Gjinushi, zoti Sinani dhe miku im Tole. Në fakt, ju keni qenë të ftuar dhe nuk u paraqitët dje, megjithatë sot jeni përsëri pjesë e debatit, sigurisht, nëse dëshironi, ose si dëgjues.

Më vjen mirë që vini për herë të parë në komision. Unë do të doja të ishin edhe kolegët deputetë, që ju kanë ftuar personalisht, të cilët kanë dashur të diskutojnë me ju dhe të bëjnë pyetje për çështje që kanë lidhje ekskluzivisht me Akademinë, megjithatë kurrë nuk është vonë dhe më vjen mirë që jeni këtu.

Mirë se erdhët!

Para se t’ia jap fjalën zotit Beqiraj, ju them se kemi një problem të vogël, se na mungojnë të dyja relatoret, të opozitës dhe të pozitës, të cilat duhet patjetër të shprehen. Duhet të ishte të paktën njëra, por na mungojnë të dyja. Në fakt, zonja Zhupa na ka njoftuar me kohë që të mos e linim debatin dhe mbledhjen e komisionit ditën e martë, pasi është në Gjykatën Kushtetuese për një çështje që ka të bëjë me një vendim të këtij komisioni, kurse zonja Gjylameti është e zënë diku tjetër, duke drejtuar një komision tjetër dhe nuk e di si do të vijojmë dhe a duhet të vijojmë, por lë të presin edhe pak për relatoret.

Ndërkohë, zoti Beqiraj mund të bëjë parashtrimin e projektligjit të tij, të hollësishëm apo të shkurtuar, si të dëshirojë, se ne e kemi një material, dhe më pas do të shohim nëse do të vijmë relatoret që të vijojmë; nëse jo do të mbetet për një herë tjetër.

Zoti Beqiraj, fjala është për ju.

**Ismet Beqiraj** – Edhe një herë, përshëndetje!

Përshëndetje, të nderuar akademikë, që jeni si pjesë...

**Flutura Aça** – Zoti Beqiraj, a mund t'ju ndërpres vetëm pak? Më falni!

Kemi të pranishëm edhe zotin Gentian Opre, drejtor i Drejtorisë së Analizës dhe Programimit Buxhetor në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Mirë se keni ardhur!

**Ismet Beqiraj** – E nderuar zonja kryetare,

Bazuar në nenin 8, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 68, pika 1, të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, ju paraqesim për shqyrtim dhe miratim në këtë komision të nderuar projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 53/2019, datë 18.7.2019 “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë””, me propozimin e deputetëve Ismet Beqiraj dhe Petro Koçi.

Ky projektligj ka si qëllim të korrigjojë me shtesa dhe ndryshime jothelbësore ligjin ekzistues të sipërcituar.

Objektivat e projektligjit kanë të bëjnë me përbërjen dhe detyrat e asamblesë, si organi i zgjedhur i Akademisë, me zgjedhjen e kryesisë, si organi ekzekutiv i saj, me vlefshmërinë dhe ndërprerjen e mandateve, si dhe me dispozitat e fundit, me administratën e Akademisë, që lidhet me strukturën, me organikën dhe me nivelin e pagave për administratën e Akademisë.

Përmirësimet ligjore të propozuara synojnë ta përmirësojnë këtë ligj në lidhje me organizimin dhe funksionimin e Akademisë së Shkencave në përshtatje me nevojat e zhvillimit të vendit, si dhe me nevojën e rritjes së cilësisë, dobisë shoqërore praktike dhe integritetit të kërkimit shkencor.

Ky projektligj është në përputhje të plotë me programin politik të Këshillit të Ministrave dhe me kuadrin ligjor në fuqi, me ligjin nr. 53/2019 “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”.

Projektligji vlerësohet si pjesë integrale e programit qeverisës në vazhdimësi, si dhe në këtë qeverisje, 2021-2025, e materializuar në vetë qëllimin e këtij projektligji, i cili, para se gjithash, ka në fokus disa shtesa dhe ndryshime të ligjit ekzistues për Akademinë e Shkencave në lidhje me organizimin dhe funksionimin e Akademisë së Shkencave, me synim unifikimin dhe partneritetin me vendet e BE-së dhe ato të rajonit, me transfuzionin e standardeve dhe të praktikave më të mira europiane, si dhe parimet e veprimtarisë shkencore europiane.

Ky projektligj me disa shtesa dhe ndryshime vjen pas një periudhe plot 4-vjeçare nga hyrja në fuqi e ligjit ekzistues nr. 53/2019 “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”, kohë kjo e plotë për përmirësime të nevojshme.

Ligji ekzistues është hartuar në përgjigje të kërkesave të drejta të qeverisë së Republikës së Shqipërisë në atë kohë, pra në vitin 2017, por edhe të komunitetit akademik e shkencor të vendit, si dhe interesit publik për të ndërtuar një Akademi të Shkencave sipas modeleve më të suksesshme e bashkëkohore. Pikërisht me ligjin e ri “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”, të miratuar 4 vjet më parë, filloi edhe reformimi i thellë në strukturë, formë e përmbajtje të institucionit publik më të lartë, që përfaqëson dhe mbart vlerat më të mira të shkencës, të kërkimit shkencor, të krijimtarisë, të debatit dhe të bashkëveprimit të mendimit shkencor në vend. Ky ligj ridimensionoi dhe ripërcaktoi funksionet e Akademisë së Shkencave, duke theksuar rolin këshillimor, rekomandues, promovues, botues, nxitës, bashkëpunues dhe bashkërendues të saj në sistemin e kërkimit shkencor të vendit, por asnjëherë urdhërues. Ky ligj realizoi ripërtëritjen e Akademisë së Shkencave dhe të përbërjes së saj me përfaqësues nga më të shquarit të komuniteteve shkencore të vendit. Nëpërmjet harmonizimit të brezave, moshave dhe fushave të kërkimit vendosi kritere më rigorozë dhe të matshme për pranimin e anëtarëve të rinj, si dhe vendosi si kufi pranimi për anëtarët e rinj të Akademisë moshën 65 vjeç. Gjithashtu, ligji nuk përfshin më kategorinë e akademikut të përhershëm, duke u dhënë akademikëve mbi 75 vjeç statusin e merituar dhe duke i çliruar ata nga disa detyrime institucionale të pjesëmarrjes në veprimtarinë e Akademisë.

Ligji i ri formalizoi funksionimin e Akademisë së të Rinjve, si organ këshillues e bashkëpunues pranë Akademisë së Shkencave, më synimin për të inkurajuar drejtpërdrejt veprimtarinë kërkimore e shkencore të kërkuesve të rinj dhe vendosjen e një ure komunikimi dhe promovimi me ta. Me ligjin e ri “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë” u krijuan kushtet ligjore për demokratizimin e funksionimit të Akademisë së Shkencave, duke harmonizuar vendimmarrjen e organeve ekzekutive me atë të asamblesë dhe seksioneve, si dhe duke përcaktuar qartë kompetencat, funksionet dhe procedurat vendimmarrëse, të cilat tashmë kanë dhe statutin e ri, pothuajse që në ditët pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Gjithashtu, ligji i ri kufizoi mandatet e drejtuesve të zgjedhur të Akademisë deri në 2, duke krijuar kushtet për ripërtëritjen edhe të drejtuesve të Akademisë. Ligji i ri ndërtoi një Akademi të Shkencave të hapur drejt komuniteteve të arsimit të lartë dhe atyre kërkimore të

vendit, si asnjëherë më parë. Kjo u realizua nëpërmjet ndërtimit të komisioneve si njësi permanente të Akademisë, në kuadrin e seksioneve, dhe të përbëra, përveçse nga anëtarët e Akademisë, edhe nga profesorë dhe ekspertë të kualifikuar të të gjitha fushave dhe me arritje të spikatura në disiplinat përkatëse. Qendra e gravitetit të veprimtarisë së Akademisë është zhvendosur nga kryesia drejt asamblesë, seksioneve dhe komisioneve. Gjithashtu, integriteti i Akademisë dhe i akademikëve është i garantuar edhe nga përcaktimet ligjore të qarta mbi vlefshmërinë, papajtueshmërinë dhe ndërprerjen e mandateve të akademikëve dhe drejtuesve të Akademisë. Ligji i ri krijoi kushtet ligjore që funksionimi i Akademisë së Shkencave dhe veprimtaria e saj të hapen dhe të sinkronizohen me veprimtarinë akademike dhe të akademikëve shqiptarë jashtë vendit. Një dispozitë e veçantë e atij ligji parashikon që personat me shtetësi shqiptare, anëtarë me të drejta të plota të një Akademie pjesëtare të ALLEA-s, të fitojnë drejtpërdrejt statusin e anëtarit të jashtëm të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, si asnjëherë në ligjet e mëparshme për Akademinë. Ligji i ri mundësoi sinergjinë mes Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë dhe anëtarëve të saj me akademikët shqiptarë në vendet e rajonit dhe në diasporë, për trajtimin në mënyrë më të institucionalizuar dhe më të koordinuar të problematikave shkencore mbarëkombëtare.

Në vijim po citoj disa nga arritjet e Akademisë së Shkencave pas miratimit të ligjit të ri “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë” dhe këtë po e bëj edhe përpara këtij komisioni të nderuar dhe për audiencën publike, sepse këto ndryshime dhe ky ligj janë tepër sensitivë edhe në ambientet mediatike, pra për të thënë disa rezultate ose produktin e madh shoqëror që ka dhënë ndryshimi ose ligji i ri “Për Akademinë e Shkencave në Republikën së Shqipërisë” gjatë periudhës 4-vjeçare.

Së pari, trupës akademike iu rikthye autoriteti i asamblesë ekzistuese me kthimin e së drejtës së votës të anëtarëve mbi 75 vjeç, të cilët ishin privuar nga kjo e drejtë në vitin 2007, sigurisht, këtë të drejtë e kanë marrë me vendim të Gjykatës Kushtetuese, si një realitet i pakëndshëm shqiptar, kur ligjvënësit vendosën të bënin në vitin 2006 ndryshimet në ligjin “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”. U hapën fushat dhe u bënë dy herë pranime të anëtarëve të rinj, me titull “akademik” dhe “akademik i asociuar”, me procedurë të ligjshme pranimi për 4 fusha të reja; u rivendos ekuilibri mes shkencave shoqërore dhe albanologjike dhe atyre natyrore e teknike; u bënë pranime të reja për titullin “anëtar i jashtëm” të personaliteteve më të shquara shqiptare me qëndrim jashtë vendit, duke vendosur urat mes

intelektualëve shqiptarë brenda dhe jashtë vendit; u bënë pranimet e anëtarëve të nderit nga radhët e albanologëve më të shquar të huaj; janë nderuar intelektualët më të njohur të vendit, që për arsye të kufizimeve të moshës, nuk mund të konkurronin më për anëtarë të asamblesë. Është hartuar statusi i ri i Akademisë së të Rinjve mbi bazën e këtyre ndryshimeve ligjore. U themelua komisioni i përhershëm, sipas fushave të ekspertizës, me pjesëmarrjen e dyfishtë të anëtarëve të asamblesë nga radhët e profesoratit dhe të qendrave kërkimore, pra nuk janë lënë jashtë këto institucione, por janë të gjithëpërfshira; u ngritën njësitë e përkohshme të kërkim-studimit për fusha prioritare, që punojnë mbi baza projektsh; u ngritën disa qendra kërkimore me statusin e një parainstituti; u nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi thuajse me të gjitha universitetet e vendit dhe me universitetet shqiptare të vendeve fqinje; u nënshkrua marrëveshje ndërkombëtare me disa vende, si dhe me universitete ku studiohet albanologjia. Bashkëpunimi me Akademinë e Shkencave të Arteve të Kosovës ishte prioritet mbi prioritetet. U hartuan disa projektligje dhe akte ligjore në shërbim të progresit të vendit, ku edhe këto ndryshime e kanë zanafillën dhe frymëzimin nga kryesia; u rrit roli i Akademisë në kuadër të Federatës Europiane të ALLEA-s dhe organizatave të tjera, ku Akademia e Shkencave të Shqipërisë është pjesë.

**Flutura Açka** – Zoti Beqiraj , më falni, ju lutem!

Unë dhe zoti Koçi kemi qenë në mbledhjen e analizës së vitit 2022 dhe të gjitha këto i kemi dëgjuar. I kam respektuar akademikët...

**Ismet Beqiraj** – Të lutem! Nuk i kanë dëgjuar ata që e përbaltën edhe sot, pas 4 vjetësh.

**Flutura Açka** – Nuk jeni zëdhënësi i Akademisë këtu, ndaj, ju lutem, merruni me ligjin!

**Ismet Beqiraj** – Do të kaloj edhe atje.

**Flutura Açka** – Po ju sjell edhe shqetësimin e kolegëve tuaj të mazhorancës.

**Ismet Beqiraj** – E thonë vetë ata.

**Flutura Açka** – Zoti Koçi, thojeni vetë, ose ju, zoti Ndreca. Merrni fjalën për procedurë the thojeni vetë.

**Ismet Beqiraj** – Nuk është normale që në mes...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, ju lutem, se shumë njerëz nuk e dinë se çfarë ka bërë Akademia e Shkencave!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Dyshon? Nuk ka asnjë problem se dyshon, madje aq më mirë që dyshon.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Dakord, do ta marr në konsideratë edhe shqetësimin që keni.

Do të kaloj direkt tek ajo që ju sugjeruat, por nuk e quaj normale që t'i ndërpritet...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Dakord.

Kërkesa juaj është që të filloj direkt te përmbledhja shpjeguese për përmbajtjen e projektligjit? A jam korrekt?

**Flutura Aça** – Po, që të respektojmë nxitimin tuaj. Ju keni pasur nxitim të jashtëzakonshëm gjithë këtë javë dhe thjesht po respektoj nxitimin tuaj, që t'i mbyllni punët dhe të flini i qetë sonte.

**Ismet Beqiraj** – Unë gjithnjë i qetë fle, kam fjetur dhe do të fle, se jam në të drejtën time dhe në detyrën time.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Dakord, por edhe ky panel duhet të respektohet.

Për arritjen e qëllimit të lartpërmendur projektligji propozon disa shtesa dhe ndryshime, si vijojnë:

Neni 1 i projektligjit riformulon pikën 3 të nenit 6 të ligjit ekzistues, në variantin që e kemi paraqitur dhe që e keni si dokument parlamentar, i cili ka kaluar edhe te Komisioni i Ligjeve. Aty hiqen fjalët “i anëtarëve të jashtëm deri në 10 dhe i anëtarëve korrespondentë deri në 15”, si dhe fjalët “këta të fundit nuk përfshihen në llogaritjen e kufirit maksimal të sipërcituar”.

Ajo që unë dhe zoti Petro shtojmë, në konsultim me anëtarët e kryesisë së Akademisë, është që jo vetëm të hiqet pjesa e dytë e fjalisë së pikës 3, por e gjithë fjalia, konkretisht: në variantin final, pra në nenin 6, pika 3, të ligjit ekzistues, të hiqet e plotë fjalia, dhe numri i anëtarëve të nderit është deri në 15, numri i anëtarëve të jashtëm deri në 10 dhe i anëtarëve korrespondentë deri në 15. Gjithashtu, mbetet edhe ajo fjalia tjetër “...dhe këta të fundit nuk përfshihen në llogaritjen e kufirit maksimal të sipërcituar”, që është në fund të nenit të ligjit ekzistues. Pse e bëjmë këtë, pra që të hiqet fjalia e parë edhe për anëtarët e nderit? E bëjmë në mënyrë që të bëjmë një hapje pa barriera dhe për anëtarët e nderit, në vlerësimin dhe nxitjen e figurave të shkencës dhe kulturës, që janë shtetas joshqiptarë me banim jashtë shtetit. Gjithashtu, edhe anëtarët e nderit i vendosim në të njëjtin status sikurse kemi vendosur edhe anëtarin e jashtëm.

Propozimi final për nenin 1.

Pika 3 riformulohet kështu: “Asambleja zgjedh edhe anëtarë të jashtëm ndër personalitetet me shtetësi ose origjinë shqiptare me banim jashtë vendit, figura të shkencës dhe kulturës, si dhe anëtarë nderi ndër figurat e shkencës dhe kulturës, që janë shtetas shqiptarë me banim jashtë vendit, të cilët me punimet e tyre, kanë ndikuar në ecurinë e mendimit dhe të zbatimit të shkencës në Shqipëri apo në promovimin e të vërtetave dhe vlerave të origjinës, gjuhës dhe kulturës shqiptare. Personat me origjinë shqiptare, që janë anëtarë me të drejta të plota të një akademie, pjesë të ALLEA-s, fitojnë drejtpërdrejt statusin e anëtarit të jashtëm të Akademisë së Shkencave, e cila formalizohet nga një mbledhje solemne e asamblesë”. Kjo pikë riformulohet dhe janë hequr 2 fjali. Ky është varianti final që ne i propozojmë këtij komisioni, ku kemi reflektuar si diskutimet që janë bërë në Komisionin e Ligjeve, ashtu dhe ballafaqimet dhe konsultat që kemi bërë edhe me anëtarët e kryesisë së asamblesë.

Neni 2 i projektligjit riformulon nenin 10 të ligjit ekzistues, ku pas togfjalëshit “anëtarë të jashtëm” shtohet “edhe ata”, hiqet fjala “korrespondent” dhe pas togfjalëshit “mbledhjet e asamblesë” shtohet togfjalëshi “pa të drejtë vote”. Nëpërmjet këtij riformulimi përcaktohet edhe statusi i anëtarëve të jashtëm dhe atyre të nderit për të shmangur çdo paqartësi lidhur me të drejtën e votimit. Kur të kalojmë në shqyrtimin nen për nen do të bëjmë edhe komentet përkatëse.

Në nenin 3 të projektligjit, që është dhe neni më i debatuar, projektligji riformulon pikat 3, 4, 8, 9 dhe 10 të nenit 11 të ligjit ekzistues, kurse pika 11 e nenit 11 të ligjit ekzistues bëhet pika 8. Pika 3 riformulohet si bashkim i pikës 3 të fjalisë së parë të pikës 4, si dhe të pikës 8 të nenit 11 të ligjit ekzistues, pra duke shmangur ripërsëritjen e dispozitave parazitare në këtë nen. Në lidhje me zgjedhjen e anëtarëve të kryesisë së Akademisë, me këtë rregullim, kjo dispozitë harmonizohet edhe me dispozitën e parashikuar në nenin 8, pika 6, të ligjit ekzistues.

Në variantin final të projektligjit të sipërcituar është hequr edhe togfjalëshi “vota të vlefshme”, ku është reflektuar edhe propozimi i kolegut Bylykbashi gjatë shqyrtimit të projektligjit në Komisionin e Ligjeve.

Pika 4 riformulohet si bashkimi i pikave 9 dhe 10, se është bërë një lapsus në emërtesë të draftit i paraqitur në Kuvend, të cilin e keni përpara, dhe është shkruar “pikat 8 dhe 9”. Është një lapsus yni gjatë shkrimit. Pra, duhet thënë “pikat 9 dhe 10 të dispozitës ekzistues”, duke shtuar



në fillim të fjalisë së parë togfjalëshin “kryetari dhe”, si dhe hiqet nga fjalia e dytë togfjalëshi “por jo radhazi”.

Nenin 11 të ligjit ekzistues, aty e kemi lënë të bëhet neni 9, por nga riradhitja në variantin final do të bëhet neni 8.

Gjithashtu, nëpërmjet këtij rregullimi bëjmë harmonizimin e plotë të kësaj dispozite për numrin dhe vazhdimësinë e mandateve me dispozitat kushtetuese: nenin 88, zgjedhja e Presidentit; ligjin “Për institucionet e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”, neni 39, zgjedhja e rektorit; nenin 43, zgjedhja e drejtuesit të njësisë kryesore, dekani; nenin 45, përzgjedhja e drejtuesit të njësisë bazë, shefi i departamentit, si dhe me ligje të tjera që rregullojnë veprimtarinë e institucioneve të pavarura kushtetuese, por unë përmenda dy kryesoret. Një eksperiencë e tillë është edhe në akademi të huaja, siç janë, academia austriake, izraelite sllovene, si dhe ajo bullgare. Nuk po përmend Kosovën, Maqedoninë e Veriut apo vende të tjera.

Neni 4 i projektligjit. Në pikën 4 të nenit 14 të ligjit ekzistues fjala “korrespondent” zëvendësohet me fjalën “i jashtëm”, për të njëjtën arsye që u hoq edhe më sipër, sepse janë sinonime.

Neni 5. Në nenin 16 të ligjit ekzistues, që lidhet me ndërprerjen e mandateve, hiqet germa “c”, kurse germa “ç” bëhet “c”. Nëpërmjet këtij ndryshimi harmonizohet statusi i anëtarit *Emeritus* në përputhje me vetë dispozitat e ligjit ekzistues, të parashikuara në nenet 6, pika 1 dhe 4. Kurse si argument juridik do t’ju citoja edhe pjesë nga vendimi nr. 36, datë 15.10.2007, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë gjatë interpretimit të një çështjeje gjyqësore që lidhet me të drejtën e votës të akademikëve mbi moshën 75 vjeç: “Gjykata Kushtetuese vlerëson se mohimi i të drejtës së votës për akademikët mbi moshën 75 vjeç sjell si pasojë bllokimin e procesit të vendimmarrjes institucionale dhe mosrespektimin e standardeve kushtetuese të lirisë akademike dhe të autonomisë institucionale. Në përfundim të shqyrtimit të kësaj çështjeje, Gjykata Kushtetuese ka vendosur shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të frazës “pa të drejtë vote”, e cila ishte në dispozitën ose në nenin 8 të ligjit nr. 9655, datë 11.12.2006 “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”. Aktualisht, edhe ligjvënësi në të njëjtën logjikë juridike me gjykatën Kushtetuese e ka shfuqizuar këtë shprehje në nenin e ligjit të mësipërm. Sigurisht, ligji i ri nr. 53/2019 i Akademisë së Shkencave është bazuar edhe në këtë vendim të Gjykatës Kushtetuese. Pra, kjo ishte për të sqaruar

opinionin publik për atë që është debatuar lidhur me të drejtën e këtyre akademikëve që e kapërcejnë këtë moshë.

Në përfundim të kësaj vendimmarrjeje të Gjykatës Kushtetuese, bazuar edhe në nenin 18 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 14 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, kush ka të drejtë të votojë, ka të drejtën jo vetëm të zgjedhë, por edhe të zgjidhet. Gjithashtu, titulli “akademik” fitohet dhe nuk jepet dhe si i tillë ai mbetet i përhershëm te mbartësit që e kanë fituar.

Neni 6 i projektligjit. Në nenin 22, pika 5, të ligjit ekzistues, pas fjalës “administratë” të shtohet togfjalëshi “dhe anëtarët e kryesisë” dhe të hiqet togfjalëshi “me propozim të kryesisë”. Pika 5 riformulohet si vijon:

“Struktura, organika dhe niveli i pagave për administratën dhe anëtarët e kryesisë përcaktohen nga asambleja, e cila ia paraqet Kuvendit për miratim”. Pra, këtu është shtuar togfjalëshi “edhe anëtarët e kryesisë”, sepse te neni 22, pika 5 është thjesht për administratën e Akademisë.

Po për administratën shkencore, që është kryesia dhe anëtarët e saj? Në mënyrë të sforcuar edhe Kuvendi ...

Tek tabela që bashkëshoqëron draftin, e cila ju është përcjellë, për strukturën, organikën dhe nivelin e pagave janë futur edhe anëtarët e kryesisë, por nuk është e shprehur te dispozita përkatëse e nenit. Ne këtë po bëjmë. Po shtojmë togfjalëshin “edhe anëtarët e kryesisë”, se është një gjë e miratuar. Kërkon mendim nga Ministria e Financave kjo? Përfaqësuesin e Ministrisë së Financave e kemi prezent dhe mund të shprehet. Kjo vetëm rregullon.

Ndërsa pagat e punonjësve dhe drejtuesve shkencorë jo administrativë, si dhe të atyre të njësive të kërkim-studimit përcaktohen sipas nenit 19, pika 4 të këtij ligji, që, për hir të së vërtetës, po bëhet një debat dhe kërkohet mendim nga Ministria e Financave për efektet financiare. Neni 19, në mos gaboj ...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo neni 6.

Pas pikës 5 të shtojmë edhe një pikë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, neni 6 i imi.

Neni 19, njësiti e kërkim-studimit, i ligjit ekzistues, thotë: “Sipas nevojave, detyrave dhe problemeve në fushën e kërkimit në përmbushje të rolit të saj, pranë Akademisë mund të ngrihen njësi të kërkim-studimit me aktivitet afatshkurtër dhe afatgjatë. Këto njësi janë autonome në realizimin e detyrave të tyre, mbajnë marrëdhënie me kryesinë dhe kryeartin dhe raportojnë pranë tyre. Sipas rëndësisë, problematikës dhe kohëzgjatjes këto njësi ngrihen me akte të asamblesë apo të kryesisë për njësitë me afat deri në 2 vjet dhe me vendim të Këshillit të Ministrave për njësi të tjera. Objekti i tyre, financimi, shtrirja, veprimtaria dhe përbërja përcaktohen në aktet përkatëse që dalin për ngritjen e tyre”.

Edhe në këtë kemi bërë këtu. Ne duam të saktësohet edhe për këto institucione, të cilat në drejtimin e tyre kanë kërkues shkencorë dhe nuk është e përcaktuar. Kjo nuk është çështje që do të kërkohen shtesa financiare, mund t’ua bëni drejtpërdrejt pyetjen drejtuesve kryesorë të Akademisë, prandaj nuk e kuptoj pse kërkon mendim nga Ministria e Financave. Megjithatë, përfaqësuesi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është prezent dhe le të prononcohet për këtë pikë.

Ndërsa, si propozim të ri, që nuk është te drafti që kam paraqitur, edhe në emër të kolegut Koçi, kemi shtuar nenin 6/1 në projektligj. Pra, në projektligjin që po shqyrtojmë është e domosdoshme të shtohet një dispozitë ose nen në lidhje me të drejtën e mbartjes së fondeve të papërdorura në nivelin buxhetor pasardhës me përmbajtje: “Në fund të pikës 3, të nenit 23, financimi, të ligjit ekzistues, shtohet fjalia: “fondet e papërdorura mbarten në vitin buxhetor pasardhës””. Në konceptim tim edhe si relator, por edhe të zotit Koçi, çfarë fondi shtesë kërkon kjo? Ne kemi projekte, që nuk kanë lidhje fare me fonde shtesë, siç është projekti ...

**Flutura Aça** - Zoti Beqiraj, pyetjet këtu i bëjmë ne, ju vetëm parashtroi.

**Ismet Beqiraj** - Dakord.

**Flutura Aça** - Të mos i ngatërrojmë pozicionet, sepse është e disata herë që na bëni neve pyetje. Ju i dini rregullat.

**Ismet Beqiraj** – Atëherë, dëgjoni argumentet.

Unë doja të mos i thosha argumentet që mos të zgjatesha, por po i them, meqenëse i doni.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, jo, do t’i them, Ina.

Si argument bindës dhe i domosdoshëm për këtë shtesë nuk është vetëm produktiviteti i madh akademik dhe shkencor i këtij institucioni gjatë këtij 4-vjeçari reformimi, për meritë të

plotë të ligjit nr. 53/2019 “Për Akademinë e Shkencave në RSH”, por do të sillja në vëmendjen tuaj vetëm tri projektet madhore, si sipërmarrja më e madhe shkencore që ka ndërmarrë Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë në këto 30 vjet e më gjerë: Fjalori i Madh i Gjuhës Shqipe, Historia e Shqipërisë, Enciklopedia Shqiptare. Pra, këto projekte kapërcejnë jo kufirin buxhetor të një viti kalendarik, por rrezik edhe të një mandati 4-vjeçar, sepse janë projekte që nuk bëhen as për 6 muaj, as për 3 muaj, as për 1 vit, as për 1 vit e gjysmë. Ne jemi koshientë për këtë gjë dhe këta që janë në krye të kësaj pune e dinë më mirë. Për shembull, nëse fondet e këtij projekti këtë vit konsumohen 20% dhe në fund të dhjetorit ne nuk i transferojmë për vitin tjetër, çfarë efekti financiar duhet të ketë? Pra, ai projekt nuk prokurohet me përqindje, 20% të zbatimit këtë vit dhe 30% të zbatimit vitin tjetër, por prokurohet i gjithi nga fillimi deri në fund.

Për të mos u zgjatur, se e di që zgjatja është bezdi, edhe pse e domosdoshme, këto kisha për të thënë

Faleminderit!

**Flutura Aça** – Faleminderit, zoti Beqiraj!

**Ismet Beqiraj** - Jemi të hapur për çdo pyetje, por, ju lutem, pa prapavijë politike!

**Flutura Aça** - Ju lutem, a mund ta mbyllni mikrofonin?

**Ismet Beqiraj** - Patjetër.

**Flutura Aça** - Faleminderit, zoti Beqiraj!

Në fakt, me sa shikoj, ju keni sjellë një shtesë, nenin 6/1-in, e cila nuk është depozituar në komision dhe kolegët e mi nuk janë njohur me të. Kështu që, edhe dy relatorët, edhe zonja Gjylameti, edhe zonja Zhupa, nuk kanë punuar. Domethënë, janë të kufizuara në informacionin që duhet të kishin për të dhënë një variant përfundimtar të relimitit të tyre. Apo jo? Ka rregulla. Nuk punohet kështu, shtu ujë, shtu miell. Ju lutem, se jua thashë edhe dje. E para kjo.

E dyta, dje keni shprehur në komision që tërhiqeni nga dy pika. E kishit fjalën për pikën 6 ...?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Më vjen shumë keq, por gjithçka është e regjistruar!

Zoti Beqiraj, ju e dini që ne nuk bëjmë shaka këtu.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

E keni të regjistruar.

**Ismet Beqiraj** – Jo, të lutem! Midis rreshtave, jo.

**Flutura Aça** - Më vjen keq!

**Ismet Beqiraj** – Jo, të lutem!

**Flutura Aça** - Në rregull. Nuk ka gjë. E qartë. Nuk tërhiqeni. Keni edhe ju arsyt tuaja.

**Ismet Beqiraj** - E shtrove sot për diskutim. Kush tha që u tërhoqa? Në asnjë mënyrë?

**Flutura Aça** - Zoti Beqiraj, po flas unë tani.

**Ismet Beqiraj** – Mos thuaj gjëra që nuk i kam thënë.

**Flutura Aça** - Zoti Koçi është këtu dhe mund t'jua shpjegojë më mirë. Është diskutuar në grup, është diskutuar në komision. Më vjen shumë keq që e vini në dyshim këtë gjë!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ismet Beqiraj** - Si? Kush e ka thënë?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Flutura Aça** - Më vjen shumë keq! Mbase ju nuk keni qenë.

**Ismet Beqiraj** - Petro Koçi ka mendimin e tij. Unë nuk kam të njëjtin mendim.

**Flutura Aça** - Mbase ju nuk keni qenë në komision në atë moment.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti Beqiraj, ju flisni pa ju dhënë fjala. Më vjen shumë keq! Ju duhet të flisni ...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

*(Mungesë incizimi)*

... këtu, në këtë komision, janë diskutuar edhe në grup për tërheqjen e dy neneve, në mënyrë që të përshpejtohej diskutimi. Në rast se ju vini me mendimin për t'i shtuar përsëri, është çështje tjetër. Përveç kësaj, ju shtoni edhe pikën 6/1, se keni hallin e fondeve të trashëguara. Jeni në të drejtën tuaj, por zotëria nga Ministria e Financave që është këtu sot nuk na ka dorëzuar asgjë me shkrim dhe ne nuk jemi njohur me asnjë opinion të tyre nëse duhet apo jo t'i marrim parasysh këto dy nene dhe duhet t'i kalojmë apo jo. Kjo gjë na pengon që të vazhdojmë punën. Ne mund të bëjmë relatimin, diskutimin, por ne nuk mund të votojmë dot, se nuk mund ta pranojmë të shkelim Rregulloren e Kuvendit. Gjërat janë të përcaktuara me shkrim. Minimumi duhet të na vijë 48 orë përpara. I sillnit një orë më përpara të paktën, që ta lexonim.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Një sekondë, se nuk jua kam dhënë fjalën.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Për procedurë e kërkoni fjalën?

Fjalën e ka për procedurë zoti Ndreca dhe më pas zonja Zhupa.

**Eduard Ndreca** – Faleminderit, kryetare!

Përpara se të kalojmë tek trajtimi i projektligjit në lidhje me dy nenet, ne e kemi këtu përfaqësuesin e Ministrisë së Financave dhe mund ta ftojme që të japë mendimin e tij, që të mos bëjmë ecejake me shkresa. Nëse ka vëmendjen, por e shikoj që nuk e ka vëmendjen, përfaqësuesi mund të shprehet në lidhje me këto dy nene, sepse prandaj është sot këtu.

**Flutura Açka** - Faleminderit, zoti Ndreca!

Fjalën e ka zonja Zhupa.

*(Mungesë incizimi)*

**Ina Zhupa** - Dje, siç dy relatoret ju kanë bërë me dije, ne kemi kërkuar të marrim, sipas ligjit, mendim nga Këshilli i Ministrave, si organi kryesor vendimmarrës dhe ligjbërës për Akademinë e Shkencave. Pra, është Këshilli i Ministrave që propozon legjislacion për Akademinë e Shkencave dhe duhet të jetë i njohur me propozimet e deputetëve, sipas Rregullores për Akademinë e Shkencave. Jua kemi kërkuar zonja Gjylameti dhe unë.

Zoti Koçi, për shkak të zgjatjes që mund të kishte nga Ministria e Financave, është tjetër Ministria e Arsimit dhe është tjetër Ministria e Financave, edhe pse janë të dyja brenda Këshillit të Ministrave, ka thënë me audio, por edhe e ka dërguar me shkrim: “E deklaram në mbledhje që tërhiqemi nga ato nene. Projektligji përmirësohet në komision. Nesër në orën 12:00 është lënë mbledhja e radhës”.

Nëse zoti Koçi ka idenë për t’i hequr, siç e shprehu dje, dhe zoti Beqiraj ka idenë për t’i lënë, e udhës është që të dy këta bashkëpropozues duhet të kenë dakordësi me njëri-tjetrin. Ndaj, t’u lëmë kohë që ta shqyrtojnë me njëri-tjetrin dhe të sjellin draftin final këtu.

E dyta, e marrim të mirëqenë që u dakordësuan që tani dhe menduan t’i lënë të dy nenet, pavarësisht se ne e kemi edhe me shkrim, të zbardhur në procesverbale, por mund t’ju vëmë në dispozicion edhe videon.

Zoti Gentian nga Ministria e Financave, të cilin e vlerësoj shumë dhe e dëgjoj me kënaqësi, le të flasë, nuk kam asnjë kundërshtim, por sipas Rregullores ne kemi detyrimin që ta marrim me shkrim opinionin e Këshillit të Ministrave. Rregullorja dhe Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë thonë që opinioni duhet të merret me shkrim brenda 30 ditëve nga Këshilli i Ministrave, nuk thonë që një drejtor i rëndësishëm mund të vijë dhe ta zëvendësojë këtë mendim

me shkrim, sepse Kushtetuta nuk na ka lënë mundësi për t'u interpretuar. E ka vënë Këshilli i Ministrave, sepse nuk supozon vetëm Ministrinë e Financave. Këshilli i Ministrave do ta shpërndajë këtë projektligj tek të gjitha ministrinë që e gjykon sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave se duhet të japin një opinion. Sigurisht, do të jetë Ministria e Arsimit, që është drejtpërdrejtë e lidhur me Akademinë e Shkencave, do të jetë Ministria e Financave, nuk e di çfarë mund të gjykojë zoti Agaçi në tagrin e tij si sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, dhe më pas mendimi i tyre pro dhe kundër do të na vijë me shkrim në komision për t'u administruar, kurse ne si relatores, zonja Blerina Gjylameti dhe unë, do të duhet që këtë mendim ta mbajmë parasysh edhe në relacionin tonë final.

Nuk ka asnjë të keqe që të bëhet një prezantim paraprak, siç u bë sot. Sot kemi një rast të veçantë dhe unë jam shumë e lumtur që pas 4 vjetësh kemi të pranishëm në komision edhe kryetarin jolegjitim të Akademisë së Shkencave, Skënder Gjinushin, dhe për mua është shumë e rëndësishme ta dëgjojmë. Nuk kam asgjë, përkundrazi, unë ku ta gjej rastin që zotëria erdhi dhe ne kemi mundësi t'i bëjmë drejtpërdrejt pyetje autorit të projektligjit, por të kemi mundësi që, sipas ligjit, votimin ta bëjmë në fund të marrjes së të gjitha dokumenteve, sepse ne, zonja Kryetare, nuk kemi asnjë tagër që të shkelim Rregulloren dhe Kushtetutën. Këto nuk janë çështje për votim. Ne nuk votojmë dot na pëlqen apo jo Kushtetuta, neni i saj apo i Rregullores, por kemi për detyrë ta zbatojmë atë, t'u qëndrojmë strikt rregullave të Kushtetutës dhe të Rregullores së Kuvendit dhe të kërkojmë nga Këshilli i Ministrave një opinion. Nuk është detyrimisht vetëm Ministria e Financave që do ta japë këtë, por do të jetë tagër i Këshillit të Ministrave. Mund ta sjellin ata si organ kolegjal, por mund ta sjellin edhe ministrinë në emër të tyre. Ne nuk hyjmë dot në prerogativat e Këshillit të Ministrave duke thënë se e kemi zgjedhur ne kush do të flasë në emrin tuaj, do të flasë vetëm Ministria e Financave, do të flasë iks drejtor në komision dhe mos ta sjellë mendimin e arsyetuar me shkrim. Nuk na e jep këtë tagër legjislatori. Në qoftë se do të na e jepte këtë tagër, mund ta kishim bërë.

Më gjeni ju një nen që na lejon ne të zëvendësojmë Këshillin e Ministrave me një drejtor të Ministrisë së Financave, më gjeni një nen që na e lejon të zëvendësojmë mendimin me shkrim të Këshillit të Ministrave brenda 30 ditëve me një mendim me gojë me një seancë pyetjesh me drejtorin dhe mund ta kemi për diskutim. Këto nuk ekzistojnë.

Edhe një herë, unë shpreh gatishmërinë time edhe në emër të opozitës që ne mund të vazhdojmë të pyesim përfaqësuesin e lartë të Akademisë dhe zotërinjtë propozues, Beqiraj dhe

Koçi, në mënyrë që të shterojmë procesin e diskutimeve, kurse pjesën e dokumentacionit dhe relacionit ta sqarojmë në seancën, kur ato të administrohen në mënyrë të rregullt nga komisioni, siç e kërkon ligji.

Në fakt, siç e vendosëm edhe ne dje...

Unë nuk e kuptoj shpejtësinë pse u bë sot, kur ne e morëm një vendim dje që do ta çonim në Këshillin e Ministrave dhe do të prisnim përgjigje. Aludova që ishte për shkak të shpejtësisë që i mbaron mandati zotit Gjinushi dhe ka hall se mos nuk kandidon më, e vetmja arsye që unë gjej, por...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

E drejtë. Është aludim imi, nuk kam prova për këtë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

I nderuar, zoti Beqiraj, nuk do të bëj politikë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju keni një politikan në krah, kështu që unë nuk do të bëj politikë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Të mbaroj unë, se nuk kam fyer askënd dhe akoma.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Sipas Dekartit, unë kam të drejtën time që të dyshoj, *cogito ergo sum*, “Dyshoj, prandaj jam”. Të ftuarit flasin në një moment tjetër...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Të lutem, ta mbaroj unë?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Për sqarim, zoti Beqiraj dhe zoti Koçi janë propozuesit e projektligjit në dijeninë time, Akademia ka ardhur për të dhënë mendim, duke qenë se preket nga ky projektligj, siç e kërkuam edhe ne. Mendimi i Akademisë është shumë i vyer dhe shumë i kërkuar nga ana jonë. Unë nuk kam asgjë, përkundrazi, kam qenë personi që kam kërkuar në mënyrë nominale, që të vijë zoti Gjinushi në këtë komision. Si procedurë parlamentare dhe si ish - Kryetar i Kuvendit, zoti Gjinushi duhet ta dijë që të ftuarit kanë një moment për të folur, mbasi mbyllet procedura dhe dakordësohet si do vazhdohet...



*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nuk është me pyetje, është me Rregullore.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Pra, për procedurë nuk pyetet i ftuari. Nuk ekziston kjo në Rregullore. Për procedurë flasin propozuesit, deputetët. Nuk ka ndodhur ndonjëherë, që të kërkojë fjalën për procedurë ministrja e Arsimit. Nuk lejohet. Pra, janë disa të drejta dhe detyrime që i kanë anëtarët e komisionit, sikundër janë disa të drejta dhe detyra që i kanë të ftuarit. Nuk barazohen dot të ftuarit, edhe pse mund të kenë...

**Flutura Açka** – Zonja Zhupa, e kapërcejmë këtë moment, se e vendosëm!

E kapërcejmë këtë moment, ju lutem!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, një sekondë, zoti Gjinushi, ju lutem!

**Ina Zhupa** – Nostalgjia e Kuvendit mund të jetë e madhe, por nuk ka ardhur këtu në kuptimin...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Flutura Açka** – Zonja Zhupa, të mos hyjmë në të tilla gjëra!

Të lutem, i kalojmë!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ina Zhupa** – Mund të kenë njerëzit nostalgji, nuk është e ndaluar.

**Flutura Açka** – Zonja Zhupa, përmbliidheni, ju lutem!

**Ina Zhupa** – Ju lutem, të respektojmë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Flutura Açka** – Zonja Zhupa, ju lutem, përmbliidheni, se do të bëjmë edhe relatimin, do të bëjmë edhe pyetje! Kemi shumë punë, mbylleni procedurën!

**Ina Zhupa** – Po. Është e përcaktuar që për procedurë është shkurt.

**Flutura Açka** – Për procedurë, ju lutem, shkurt!

**Ina Zhupa** – Në qoftë se ne...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, fare.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Procedurë është.

Ju duhet ta dini si deputetë, që për procedurë flasim vetëm ne, flasin deputetët, nuk flasin të ftuarit.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Flutura Açka** – Ju lutem, mbani qetësi!

Mos ndërhyuni, se nuk regjistroheni!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zonja Zhupa, konkludo!

**Ina Zhupa** – Nuk flasin të ftuarit për procedurë.

**Flutura Açka** – Zonja Zhupa, e vendos unë. Mos ki merak për atë gjë, mos u shqetëso kot.

**Ina Zhupa** – Që ta sqaroj, nuk e vendos dot as kryetarja, sepse ka Rregullore dhe Rregullorja nuk e ka lënë në tagër të askujt. Pra, të ftuarit flasin në momentin e tyre, deputetët flasin për procedurë.

**Flutura Açka** – Zoti Beqiraj, tani e keni ju fjalën për procedurë.

**Ina Zhupa** – Për ta mbyllur: i qëndrojmë Rregullores dhe Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, kërkojmë mendimin me shkrim nga Këshilli i Ministrave, siç është detyrim.

**Flutura Açka** – Zonja Zhupa, unë sapo e thashë, e përmenda, këtu ka një gjë: në votim nuk shkojmë dot pa pasur shkresat. E thashë: do të bëjmë diskutimin, do të bëjmë pyetjet, çfarë kemi për të bërë do ta shterojmë, por nuk votojmë dot për shkak se na mungojnë shkresat dhe nuk shkelim dot Rregulloren. Nuk e kemi bërë ne Rregulloren, e kanë bërë njerëz të tjerë më të mençur se ne. Ne kemi detyrë për ta respektuar qoftë Kushtetutën, qoftë Rregulloren.

**Ina Zhupa** – Sepse zoti Ndreca bëri një propozim, për ta sqaruar që propozimi nuk është për t'u bërë, sepse nuk zëvendëson dot praninë tonë...

**Flutura Açka** – Zonja Zhupa, konkludo!

**Ina Zhupa** – Në lidhje me propozimin e zotit Ndreca, prania fizike e drejtorit të nderuar të ministrisë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Flutura Açka** – Ju lutem, zoti Gjinushi, ju jeni i ftuar këtu, madje as i ftuari ynë sot, por, megjithatë, unë kam respekt për punën, për akademikët në përgjithësi, se jam në një fushë me ta.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti Beqiraj, këtu drejtoj unë, nuk drejton zonja Zhupa.

Zonja Zhupa, ju lutem!

**Ina Zhupa** – Ta mbaroj fjalinë?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Flutura Aça** – Jam tolerante, me të gjithë jam tolerante.

**Ina Zhupa** – Nuk zëvendëson dot prania e një drejtori të Ministrisë së Financave mendimin me shkrim të Këshillit të Ministrave.

**Flutura Aça** – Ja ku i ke kolegët e tu, e ke të regjistruar.

Unë jam tolerante kur vjen puna te fjala, sepse unë për fjalën kam luftuar gjithë jetën, kështu që do t'i lë deri në fund.

**Ina Zhupa** – Zoti Beqiraj, si propozues...

**Flutura Aça** – Zonja Zhupa, kur të kemi relatimin, do të vazhdojmë.

**Ina Zhupa** – Zoti Beqiraj, si deputet i vjetër duhet ta dini që mendimi i një drejtori të Ministrisë së Financave në komision nuk zëvendëson dot detyrimin për ta sjellë me shkrim mendimin e Këshillit të Ministrave.

**Flutura Aça** – Zonja Zhupa, e vendosëm atë gjë, e kemi prerë atë gjë. Nuk diskutohet ajo gjë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ina Zhupa** – Jo, por është e rëndësishme.

**Flutura Aça** – Zonja Zhupa, e vendosëm atë gjë, e kemi prerë atë gjë.

**Ina Zhupa** – Jo, që ta kuptoni, se s'po e kuptoni.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Shumë dakord.

Në momentin kur ne biem dakord për këtë, vazhdon normalisht seanca.

Faleminderit!

**Flutura Aça** – Faleminderit!

Zonja Zhupa, ju e keni kërkuar personalisht disa herë zotin Gjinushi këtu. Për fat të mirë, sot ka ardhur për tjetër gjë, kështu që nuk do ta pyesim për Akademinë. Ndoshta, zoti Gjinushi, kur t'ju ftojme një herë tjetër, kemi nevojë të diskutojmë për gjëra që kanë të bëjnë me Akademinë. Ne këtu kemi kaluar miliona euro për projektet tuaja, e kemi bërë të dyja palët me shumë dashuri, me vota të plota. Kështu pra, duhet të kuptoni, kur ne ju kërkojmë për një lloj

dëgjese, e bëjmë për të mirën e punës, nuk e bëjmë se kemi kapriço. Të paktën, personalisht, nuk e kam këtë gjë, edhe zonja Zhupa, besoj ka të njëjtën gjë.

Kështu që, nëse do të kemi pyetje, sot do t'ju pyesim në lidhje vetëm me këtë projektligj.

Fjalën e ka zoti Beqiraj.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jua ka lënë ju?

Për procedurë?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nuk ka ardhur ende radha e pyetjeve. Kur të vijë radha për përgjigjet e pyetjeve, do të jetë fjala për ju.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nuk kemi pyetje.

**Skënder Gjinushi** - Më vjen keq!

A ka mundësi?

**Flutura Açka** – Urdhëroni!

**Skënder Gjinushi** - Së pari, duhet të rregulloni statusin e të ftuarit, se vihet në diskutim për çfarë jemi ftuar.

**Flutura Açka** – Ju lutem, zoti Gjinushi, pa cinizmin që keni shprehur nëpër televizione.

**Skënder Gjinushi** - Urdhëro?

**Flutura Açka** – Sepse më ka bërë përshtypje, ç'është e vërteta.

**Skënder Gjinushi** – A do më lini të flas?

Do të flas vetëm për projektligjin dhe çka lidhet me projektligjin. Është krejt normale që të bëjmë edhe një prezantim, jo paraqitje, se e paraqiti shumë mirë inicuesi, sepse ky është ligj i bërë me iniciativë deputetësh. Edhe ligji bazë i Akademisë së Shkencave është bërë me iniciativë deputetësh, nuk është bërë me iniciativë të Këshillit të Ministrave, për të respektuar faktin që Akademia e Shkencave është një organ autonom. Autonomia këto ka, nuk ka çudira, ka një shkallë të caktuar vetëfinancimi; ka të drejtën për t'u organizuar vetë; ka edhe që në ligjin bazë, së pari, dëgjohet ajo. Pra, nuk diskutojnë tjetër mbi projektligjin e Akademisë së Shkencave. Kur e kemi bërë atë ligj, në mirëkuptim edhe në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, jemi konsultuar dhe viston përfundimtare e ka dhënë Bashkimi i Akademive Europiane edhe profesionalisht, edhe nga ana shkencore, pra pikërisht për të realizuar një autonomi.

Projektligji që paraqitet para jush, nuk e di pse komplikohet kaq shumë, pasi është një nga propozimet më të thjeshta, që bëhen natyrshëm gjatë provës që kalon një ligj i ri. Pikërisht, së pari, është hapja e Akademisë më tej, sepse ne vumë disa kufij për anëtarët e jashtëm dhe ata të nderit. Anëtarë të jashtëm janë të gjithë shqiptarët e suksesshëm jashtë vendit, ndërsa anëtarë të nderit janë personalitetet e lidhura me shkencën shqiptare apo të huaj. Ne bëmë disa kufizime, të cilat dolën që janë të papërshtatshme, sepse ne tashmë kemi më shumë shqiptarë, patriotë tanë të suksesshëm jashtë vendit sesa brenda vendit, si dhe për arsye të nivelit të kërkimit shkencor në tërësi. Pra, rrjedhimisht, është rritur presioni, kërkesa, dëshira për të qenë anëtarë të jashtëm, të cilët nuk kanë asnjë efekt financiar, sepse nuk paguhen

**Flutura Açka** - Zoti Gjinushi, neve nuk na pengon fare kjo pikë që po diskutoni ju. Ju lutem!

**Skënder Gjinushi** - Kaq ishte, do të kaloj te tjetra.

**Flutura Açka** – E qartë, por ju do të flisni kur të kemi ndonjë pyetje konkrete.

**Skënder Gjinushi** - Jo, a ka mundësi?

**Flutura Açka** - Ju tani po merrni rolin e iniciuesit të këtij ligji dhe po shpjegoni cila është e mira e kësaj gjëje, apo jo?

**Skënder Gjinushi** - Jo, mbështes iniciuesit.

Po mirë, ju duhet të dini...

**Flutura Açka** - Ne nuk e kemi këtu kleçkën.

**Skënder Gjinushi** – A ka mundësi?

A doni t'i dini efektet?

**Flutura Açka** - Ne e kemi hallin këtu, zoti Gjinushi: brenda javës na kanë ardhur katër draftet të këtij projektligji. Cilin draft të marrim definitiv?

**Skënder Gjinushi** – A ka mundësi?

Të katër draftet nuk ndryshojnë asgjë.

**Flutura Açka** - Na kanë ardhur katër draftet dhe nuk dimë cili është definitiv, për të përcaktuar ne diskutimet.

**Skënder Gjinushi** – A ka mundësi të dëgjosh? Pse e humbët durimin?

**Flutura Açka** - Ju lutem, edhe ne...

*(Nuk dëgjohet)*

**Skënder Gjinushi** – ...dhe ky riformulim është normal. Me rastin e riformulimit, të bëhet në përshtatje me të gjitha standardet, që nga shkollat tona të larta. Nuk ka asgjëkund një mandat po, një jo. Ose ushtrohen 2 mandate rresht, ose nuk ushtrohen fare.

Gjithashtu, duhet kuptuar shumë mirë që ligji nuk zgjedh, ligji vetëm jep të drejtë, zgjedhjet i bën asambleja, si kudo, institucioni i ngarkuar.

Për sa u takon ndryshimeve financiare, nuk ka ndryshime financiar, përveç amendamentit që propozoi tani deputeti, të tjerat nuk janë ndryshime, përkundrazi. Çfarë janë? Ligji thotë: “Pagat, strukturën e administratës, - dhe administratë janë nga kancelari dhe poshtë, - e bën Kuvendi me propozim të asamblesë”. Pra, ligji nuk shprehet se kush i bën pagat e kryesisë dhe pagat e asaj që ne quajmë “drejtim shkencor”. Atëherë, me vullnet të mirë, ne e sollëm këtu gjithë strukturën, pra u fut praktika që edhe pagat e kryesisë t’i përcaktojë Kuvendi, se ka një boshllëk ligjor. Pra, ky boshllëk plotësohet, por nuk ka efekte financiare, tregon vetëm që tani Kuvendi përcakton edhe pagat e kryesisë, pra nuk e lë subjektive, edhe të administratës.

Më tej për punonjësit kërkimorë, thuhet se, citohet neni 19, do të bëhet sipas nenit 19. Kjo nuk është norme e re fare. Thuhet: “Do të bëhet sipas nenit 19”. Ç’lidhje ka me efektet financiare apo me mendimin e Ministrisë së Financave?!

**Flutura Aça** - Mund t’jua shpjegoj unë, zoti Gjinushi, nëse dëshironi.

**Skënder Gjinushi** – Këtu?

**Flutura Aça** - Po.

**Skënder Gjinushi** – Po. Cili është efekti financiar?

**Flutura Aça** - Përderisa preket një nen që lidhet me çështjet financiare, ne nuk kemi tagrin të vendosim për këtë gjë.

**Skënder Gjinushi** – Ku preket?

**Flutura Aça** - Pavarësisht riformulimit, çfarëdo gjëje që të jetë, ne nuk kemi tagër të vendosim për këtë gjë.

**Skënder Gjinushi** – Jo, është e shkruar. Rregullorja thotë: “Në qoftë se ka efekte financiare...

**Flutura Aça** – Sepse marrim përsipër të flasim një gjë për të cilën nuk kemi fare kompetencë, për çështje të kësaj natyre.

**Skënder Gjinushi** - Ju lutem, në qoftë se ka efekte financiare...

**Flutura Aça** – Pra, është në *domain*-in e Ministrisë së Financave, ose hakshe - hakshe është në *domain*-in e Kryeministrisë të na e thotë.

**Skënder Gjinushi** – Po, kur ka efekte.

**Flutura Aça** – Nuk e dimë këtë gjë.

**Skënder Gjinushi** - S'i nuk e di?

**Flutura Aça** – Ne nuk e themi dot, nuk jemi specialistë për këtë punë.

**Skënder Gjinushi** - Zonja kryetare,...

**Flutura Aça** – Ne nuk e themi dot, nuk kemi tagër ta themi këtë gjë, e përcakton Rregullorja, e përcakton ligji.

**Skënder Gjinushi** - Neni thotë: “Do të bëhet si te neni 19”.

A ka mundësi?

**Flutura Aça** – Në momentin kur preket një nen që ka lidhje me efektet financiare, qoftë edhe me efekt zero, ne nuk kemi të drejtë të japim definicione.

**Skënder Gjinushi** - Jo, nuk thotë kështu.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Në qoftë se ka efekte.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Pa ma bëj efektin.

**Flutura Aça** – Jo, s'ka rëndësi. Nuk e bëjmë dot ne, se nuk jemi specialistë.

**Skënder Gjinushi** - Zonja kryetare, kur thuhet...

**Flutura Aça** – Nëse unë shprehem për këtë gjë, unë bëj një lapsus.

**Skënder Gjinushi** - A ka mundësi?

**Flutura Aça** – Jo, ju lutem!

**Skënder Gjinushi** - Kur thuhet: “Pagat i cakton Kuvendi”, cili është efekti?

**Flutura Aça** – Megjithatë, zoti Gjinushi, debatin nuk e kemi me ju.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Skënder Gjinushi** – Po, ju i caktoni edhe sot!

**Flutura Aça** – Zoti Gjinushi, ne debatin nuk e kemi me ju.

**Skënder Gjinushi** - Zonja kryetare, doni të dëgjoni apo jo?

**Flutura Aça** – Fakti që zoti Beqiraj e ka deleguar mbrojtjen te ju, nuk është normale dhe për zotin Beqiraj. Ai e di vetë.

**Skënder Gjinushi** - Zonja kryetare, a ka mundësi?

**Flutura Aça** – Fjalën e ka zoti Beqiraj.

Ai duhet të mbrojë ligjin që ka sjellë.

**Skënder Gjinushi** - Këtu thuhet ajo ç'keni bërë, pra që i caktoni ju, Kuvendi, edhe që ju i keni. Çfarë ndryshon këtu?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Vetëm thuhet në ligj, se nuk thuhej.

**Flutura Aça** – Në rregull, të konkludojmë zoti Gjinushi, që të vazhdojë zoti Beqiraj, nëse ka gjë për të thënë.

**Skënder Gjinushi** - Kurse pika tjetër, thotë: “Bëhet sipas nenit 19”, pra nuk ka shtim norme.

**Flutura Aça** – Ju keni prekur nenin 19, nëse jam e saktë.

**Skënder Gjinushi** - Nenin 22.

**Flutura Aça** – Jo ju, sepse nuk është iniciativa juaj.

**Skënder Gjinushi** – Nuk është prekur neni 19.

**Flutura Aça** – Ju vetëm po e mbroni, sepse është iniciativa e zotit Beqiraj.

**Skënder Gjinushi** - Jo, unë e mbroj, sepse e kemi bërë së bashku.

**Flutura Aça** – Ai ka prekur një nen, madje shton edhe nenin 6/1, që është ekskluzivisht me fonde.

**Skënder Gjinushi** - Tani, neni 6/1 është amendament më vete.

**Flutura Aça** – E qartë, pra, por ka lidhje me fondet dhe duhet të shprehet ministria.

**Skënder Gjinushi** - Atëherë, neni 6/1 kërkon mendim, e tërheq. Dakord për nenin 6/1.

**Flutura Aça** – Madje edhe relatorja e mazhorancës e kishte këtë shqetësim dhe e kërkoi këtë gjë.

Po, zoti Beqiraj, urdhëroni!

Faleminderit, zoti Gjinushi!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Sapo ju urdhëroi, zoti Gjinushi, që ta hiqni nenin 6/1.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem, zoti Gjinushi!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*



Zonja Zhupa, ju lutem, jo me këtë ton!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zonja Zhupa, ju lutem!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti Gjinushi, ju lutem!

Ju lutem, vazhdojmë procedurën!

Zoti Gjinushi, ju lutem!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti Gjinushi, ju lutem, unë ju respektoj, ju jeni politikan i vjetër dhe e dini që ka rregulla.

**Ismet Beqiraj** - Më falni, të vazhdoj, apo jo? A ma keni dhënë fjalën?

**Flutura Açka** – Zoti Beqiraj, është fjala për ju.

Përqendrohni te procedura, sepse e keni kërkuar fjalën për procedurë.

**Ismet Beqiraj** - Po, për procedurë.

**Flutura Açka** – Faleminderit!

Zonja Zhupa, uluni që të vazhdojmë!

Nuk do të bëjmë debate këtu.

Ju lutem, zonja Zhupa, kur t'ju vijë radha!

Zoti Beqiraj, vazhdoni.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ismet Beqiraj** – Zonja Ina, unë jam shumë racional.

Lidhur me procedurën, zonja kryetare, edhe tek materiali parlamentar që keni, që ka projektligji dhe relacioni përkatës, është bashkangjitur edhe vendimi që është akt normativ, të cilin e ka marrë Kuvendi për pagat, për organigramën, për strukturën dhe të tjera. Për çfarë është futur ky këtu? Nuk kërkon legjitimitetin, që ne të kërkojmë të ndryshojmë këtë, por po themi që...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, pra, sepse është diskutuar edhe këtu në komision, sepse komisioni e miraton dhe ia përcjell seancës plenare.

**Flutura Açka** – Zoti Beqiraj, pse sillni arna në projektligjin tuaj?

**Ismet Beqiraj** – Të lutem, edhe një herë, se të është fiksuar arna.

**Flutura Aça** – Ngele duke vënë mballoma në projektligj.

Keni një javë fiks me këtë çështje. Përditë na del nga një mballomë e re.

**Ismet Beqiraj** – Të lutem, ta mbaroj!

Të lutem, më lër të flas!

Kryetare, mos më ndërhy, më lër të flas!

Te raporti i vlerësimit të të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore ne kemi thënë, jo në mënyrën siç interpretohet dhe hidhet në këtë tavolinë për të bërë zhurmë dhe për ta shtyrë në kohë këtë diskutim: “Projektligji nuk sjell si pasojë rritje të shpenzimeve buxhetore për Akademinë e Shkencave, as për institucionet e tjera”. Pse nuk sjell rritje? Sepse Akademia e Shkencave nuk vepron dhe nuk shkel rregullat dhe ligjet financiare, jashtë këtij vendimi që është akt normativ, ku ka edhe kryesinë, edhe sesionet shkencore, edhe kancelarinë që është administrata. Ky akt normativ e ka ndarë se kush është pjesa e administratës formale dhe kush është pjesa e kryesisë, që është jashtë administratës formale. Çfarë kërkojmë ne? Unë ngul këmbë përsëri: bëhet fjalë për nenin 6 dhe për nenin 6/1, që afekton ose prek nenin 22 dhe nenin 23. Pra, unë si nismëtar po them, e thashë edhe dje, e them prapë, duke u nisur nga sqarimet dhe nga diskutimi te Komisioni i Ligjeve: jam plotësisht dakord që kur të vijë neni 6, të shihet ky propozim edhe riformatimi që kemi bërë ne, sepse nuk është arnë. Ti me të drejtë mund të diskutosh dhe të thuash, kur të vish te neni 6: “Zoti nismëtar, për pagat e anëtarëve të kryesisë, për punonjësit, sipas tabelës 1 të bashkëlidhur në ligj, dua një mendim”. Atëherë, qoftë unë, qoftë zoti Petro, jemi tërhequr nga kjo, sigurisht edhe duke u konsultuar me palën e interesit, nga pika 6, ku thuhet: “Pagat e kryesisë janë sipas tabelës bashkëngjitur këtij ligji”.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, nuk e kam sjellë sot.

Të lutem!

Kur të vijë radha që të shqyrtohet, unë do të them që për këtë nen kam këtë mendim.

**Skënder Gjinushi** - A mund të bëj një saktësim?

**Flutura Aça** – Zoti Beqiraj, kur bëtë referimin tani, thatë, madje e lexuat edhe nenin 6.

**Ismet Beqiraj** – Pikërisht...

**Flutura Aça** – Të lutem, lexuat nenin 6, shtuat edhe nenin....

**Ismet Beqiraj** – Të lutem, mos më korrigjo!

*(Nuk dëgjohet)*

Unë gjatë referimit thashë: “Ne kemi edhe reflektime”.

**Flutura Açka** – Deri tani unë e dija që nuk është fare neni 6, sepse e keni tërhequr dje nenin 6. Sot erdhët...

**Ismet Beqiraj** – Si nuk është? Jo, e ke këtu.

Të lutem, neni 6 do të tërhiqet kur të shqyrtohet nen për nen.

**Flutura Açka** – E tërhoqët ju në komision.

**Ismet Beqiraj** – Jo, nuk e kam tërhequr.

**Skënder Gjinushi** - Zonja kryetare, a ka mundësi të bëj vetëm një sqarim?

Fillimisht ishte që i cakton Kuvendi, edhe lista bashkëngjitur me pagat e reja, meqenëse kanë ndryshuar për të gjithë. Meqenëse thatë që ka efekt, pagat u hoqën, por shtohet që Kuvendi cakton dhe pagat e kryesisë, nuk ia lë kryesisë që të vendosë vetë. Kaq.

Kur të vijë projektvendimi për pagat, atëherë pyetet ministria për efektin.

**Flutura Açka** – Zoti Gjinushi, ne nuk po flasim vetëm për pagat, ne po flasim edhe për pikën 6/1, për fondet e trashëguara. Këtë po them unë tani, që e shtuat sot. A e shtuat sot, zoti Beqiraj?

Ju lutem!

A e shtuat sot? Po apo jo?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po kur e shtuat, more zotëri, se unë nuk e kam?! Nuk e kam, të lutem shumë! Ju më detyroni mua të vij me një gjë që unë s’e kam parë. Si është e mundur? Dhe pastaj më intimidoni duke më thënë: “Po bëj sarkazëm këtu”!

Ju lutem, mos më ngarkoni faje që nuk i ka bërë, zotëri!

A e shtuat sot, zoti Beqiraj?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti Beqiraj, po flisni, por nuk po regjistrohëni. Më vjen keq që nuk po regjistrohëni. Ju duhet të regjistroni.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nuk po regjistrohëni, se nuk keni hapur mikrofonin. Është faji juaj, nuk është faji im.

**Ismet Beqiraj** – Pra, kur të shkojmë te neni 6, ne do t’i qëndrojmë strikt, se jemi tërhequr, apo nuk jemi tërhequr, pavarësisht mos....

*(Diskutime pa mikrofon)*

Keni fjalën për procedurë, por shumë shkurt.

**Ina Zhupa** – Jam dakord me zotin Ndreca që logjika parlamentare cakton që, pasi të mbarojë propozuesi, zoti Beqiraj, të kalojmë në relativitet. Jam dakord që të procedojmë, por ne duhej të kishim sqaruar që në fillim, dhe unë prandaj e kërkova fjalën, që ne mund të relatojmë, mund të diskutojmë, por nuk mund të votojmë, në rast se na mungojnë shkresat nga Këshilli i Ministrave. Dua të nënvizoj edhe këtë fakt, për ta mbyllur procedurën dhe për të kaluar, kur të ma jepni fjalën, për relativitet pas zonjës Buxheli: unë dhe bashkërelatorja tjetër, zonja Gjylameti, e Partisë Socialiste, që të mos e merrni fare politike, se e keni merak, jemi shprehur të dyja bashkë se kërkohet mendimi i Këshillit të Ministrave në cilësinë e autoritetit përgjegjës për hartimin dhe propozimin e ndryshimeve të ligjit të Akademisë së Shkencave. Këshilli i Ministrave ka në përbërjen e tij, siç jua thashë edhe një herë, Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Arsimit. Për shembull, zoti Beqiraj, si propozues, unë ashtu si edhe ju, kam propozuar një projektligj për trashëgiminë kulturore, nuk ka kosto financiare, nuk ka asnjë lidhje me koston financiare, nuk ka efekte fare, por jam e detyruar, komisioni është i detyruar, dhe ia ka dërguar Këshillit të Ministrave, që Ministria e Kulturës, që ka lidhje me administrimin e muzeve, të japë ide, a i pëlqen modeli im apo jo, sepse organi më i lartë qeverisës në këtë vend është Këshilli i Ministrave, e thotë Kushtetuta. Ne nuk e ndryshojmë dot Kushtetutën, sado dëshirë mund të kemi për interesa të një individi të caktuar. Ndërsa për sa i përket çështjes së diskutimit nën për...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Këshilli i Ministrave....

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nuk e prek fare. Ja t’jua sqaroj.

Këshilli i Ministrave duhet të shprehet...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Në Rregullore. Duhet të shprehet në lidhje me këto projektligje. Neni 82 i Kushtetutës: “Propozimi i ligjeve, kur janë projektligje joqeveritare, e bën të nevojshme të shoqërohet kurdoherë me raportim për çdo shpenzim në zbatim të tij.”

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nuk ka rëndësi. Edhe kur pakëson, edhe kur shton, nuk e dimë. Ne duhet të marrim vendim.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po nuk e dimë, sepse nuk e keni thënë ju!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Asnjë projektligj nuk miratohet pa marrë mendimin e Këshillit të Ministrave, i cili duhet të shprehet brenda 30 ditëve. Në qoftë se Këshilli i Ministrave nuk shprehet brenda afatit të mësipërm, atëherë projektligji kalon për shqyrtim sipas...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Për ta sqaruar dhe për ta mbyllur: unë jam dakord me propozimin e zotit Ndreca, që ne mund të vazhdojmë me atë draftrelatim, për arsye se mund të na vijjë edhe mendime të tjera nga Këshilli i Ministrave, por ne nuk mundemi dot pa qeverinë. E duam apo nuk e duam, Kushtetuta na e detyron.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Pra, në nenin 6, thotë raporti, shtohet edhe një pikë e veçantë në lidhje me trajtimin financiar të anëtarëve të kryesisë, të punonjësve e drejtuesve shkencorë joadministrativë, si dhe të atyre të njërive të kërkimit të studimit. E thotë relacioni i projektligjit tuaj. Kur ta ndryshoni këtë, nuk ia marrim mendimin.

Faleminderit!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Flutura Açka** – Urdhëroni, zonja Buxheli!

Zoti Beqiraj, mos debatoni tani, kur të bëjmë relacionin...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Të lutem, zonja Zhupa!

Kolegë të nderuar, a ka mundësi?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zonja Buxheli e ka fjalën për procedurë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti Beqiraj, më pas do ta keni ju fjalën.

**Lindita Buxheli** – Faleminderit, zonja kryetare!

Unë ju kërkoj ndjesë, sepse jemi duke miratuar në Komisionin e Shëndetësisë në të njëjtin orar, në prezencë të ministres Kushi, një projektligj shumë të rëndësishëm dhe do të kërkoj ndjesë që nuk isha kur relatoi përfaqësuesi i Ministrisë së Financave.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Në rregull, do të shpreh mendimin tim.

Dua të them që duhet të kemi më shumë respekt për të ftuarit.

Ne, përderisa e ftojmë në këtë komision, duhet të kemi shumë respekt edhe për figurën që ka zoti Gjinushi, si ish-Kryetar i Kuvendit.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Edhe unë ju vlerësoj për këtë, por nesër mund të jemi unë apo zonja Zhupi në pozicionin e atij dhe duhet t'i kurseni pak ironinë dhe nostalgjitë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nesër mund të jeni ju, zonja Ina, atje.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, për këtë ju vlerësoj, por një tërheqje vëmendjeje shumë miqësore si kolege, që të mos i përdorni këto dhe t'i kurseni herë tjetër karshi figurave.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Unë ju vlerësoj.

Unë do të thosha jam e paqartë dhe do t'ia bëj pyetje përfaqësuesit të Ministrisë së Financave: në dijeninë time, fondet e institucioneve buxhetore nuk trashëgohen në vitin pasardhës...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Të lutem!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Kam vetëm një pyetje.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem, shumë shkurt, mund të ma sqaroni vetëm këtë pikë!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Flutura Açka** – Për procedurë, zoti Beqiraj dhe, më pas, kalojmë te relatorja.

A është zonja Gjylameti për të paraqitur relacionin?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Do ta paraqesë kolegu Ndreca.

**Ismet Beqiraj** – Edhe një herë, zonja kryetare, në qoftë se duhet të shkojë puna mirë në komision, sepse ka ligje të diskutueshme, secili do të mbrojë krahun e tij politik dhe do të bëjë politikë nëpërmjet ligjeve, do t'ju lutem, të keni busull Rregulloren e veprimtarisë dhe diskutoni, ndiqni procedurat.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem, zonja kryetare, a ma dhatë fjalën? Pse më fyeni?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po më fyeni mua që po flas?!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem, zonja kryetare, më fyeni kur ma ndërprisni fjalën!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Le të kalojmë në atë që tha edhe kolegu Ndreca dhe të hyjmë në normalitetin e shqyrtimit dhe diskutimit të këtij projektligji dhe për nene të veçanta, për paragrafë të veçantë, që hanë diskutim, nëse keni korrigjime, bëni propozime. Mund të propozojmë edhe ne, si nismëtarë, edhe pala e interesit që është Akademia, prandaj është komisioni. Pas të gjithë debatit, finalizojini gjërat. Ju lutem, hyni në normalitet dhe normaliteti është: jepja fjalën relatorit të shprehet.

**Flutura Aça** – Meqenëse zonja Gjylameti nuk është, atëherë zonja Zhupa fjala për ju.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Do ta lexoni ju, zoti Ndreca?

Në rregull.

Në emër të zonjës Gjylameti, do ta lexojë zoti Ndreca.

**Eduard Ndreca** – Zonja kryetare, për procedurë radhën e vendosni ju, por, nëse keni dëshirë, mund të vazhdoni.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Më lejoni që të lexoj materialin që ka përgatitur relatorja e këtij projektligji, zonja Gjylameti!

Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 53/2019 "Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë"" është propozim i kolegëve deputetë, Ismet Beqiraj dhe Petro Koçi, mbështetur në nenin 81, pika 1 e Kushtetutës së Republikës. Ne jemi komision përgjegjës, bazuar në nenet 32 dhe 38 të Rregullores së Kuvendit. Projektligji "Për disa shtesa

dhe ndryshime në ligjin nr. 53/2019 “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”, i propozuar nga një grup deputetësh, është në përputhje me nenin 81, pika 1, dhe nenin 83, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Normalisht, ky projektligj është shoqëruar edhe me relacionin e nevojshme, sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit. Miratimi kërkon një shumicë të thjeshtë votash, edhe ky sipas përcaktimeve të nenit 78 të Kushtetues dhe nenit 55, pika 5 e Rregullores së Kuvendit.

Qëllimi i këtij projektligji është korrigjimi i bazave juridike të ligjit ekzistues nr. 53/2019 “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë” në lidhje me organizimin dhe funksionimin e këtij institucioni. Përmirësimet ligjore të propozuara kanë të bëjnë me ndërtimin dhe funksionimin e Akademisë së Shkencave në përshtatje me nevojat e zhvillimit të vendit, si dhe nevojën e rritjes së cilësisë, dobisë shoqërore praktike dhe integritetit të kërkimit shkencor. Këto ndryshime që propozohen, tentojnë të bëjnë disa plotësime dhe saktësime të nevojshme që kanë të bëjnë me përbërjen dhe detyrat e Asamblesë, organi i zgjedhur i Akademisë, dhe zgjedhjen e kryesisë, si organ ekzekutiv i saj, me vlefshmërinë dhe ndërprerjen e mandateve, si dhe me dispozitat që lidhen me strukturën e organike dhe nivelin e pagave për administratën e Akademisë (po mbetemi brenda asaj që diskutuam).

Ndryshimet e propozuara ndikojnë pozitivisht në aspektin e përmirësimit të funksionimit të institucionit të Akademisë së Shkencave në mbështetje të rritjes së cilësisë, dobisë shoqërore e të tjera. E thashë që projektligji është në përputhje me Kushtetutën. Nuk synon përfarim me ndonjë pjesë të legjislacionit të brendshëm të Bashkimit Europian. Nuk po ndalem, sepse i përmendi kolegu Beqiraj, te ndryshimet që ndodhin te nenet. Meqenëse jam në momentin e relatimit, zoti Beqiraj, a i keni reflektuar ndryshimet që vijnë nga Komisioni i Ligjeve për teknikë legjislative?

*(Ndërhyrje pa mikrofoni)*

Në rregull.

Patjetër, unë e vlerësoj këtë projektligj. Normalisht, në fund, kur ky projektligj të miratohet, vota ime do të jetë pro, por që të mos më mbetet merak nga Komisioni Ligjeve, duhet t’i them disa gjëra, se ndoshta edhe mund t’i reflektojmë disa gjëra në momentin e trajtimit nën për nen të këtij projektligji. Unë kam bërë disa sugjerime, ndoshta këto janë edhe përshtypjet e mia profesionale. Unë e thashë në fund, nëse grupi ynë kërkon që t’i qëndrojmë strikt variantit fillestar të propozuesve, patjetër që do të jem pro këtij varianti, por ajo që unë kam propozuar



edhe në Komisionin e Ligjeve, ka qenë heqja e kufizimit të anëtarëve të jashtëm, sepse kështu i keni përkufizuar. Unë mendoj se do të krijojë një kaos. Ju e keni pasur deri në 10 anëtarë të jashtëm dhe e keni hequr si numër. Ne patjetër që mund ta rrisim si numër, por unë besoj se duhet të ketë një kufizim të këtyre anëtarëve. Në logjikën time, krijon një lloj kaosi dhe patjetër që institucioni i Akademisë së Shkencave ka nevojë që të ketë një numër të caktuar, me të cilin të merret vesh, pastaj mbetet shtu ujë dhe shtu miell dhe mund të shkojë në një numër të pakufizuar.

Së dyti, me thënë të drejtën, personalisht te çështja e mandatave, ajo që unë kam kërkuar edhe në Komisionin e Ligjeve, është ...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ngaqë kam qenë ...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Në rregull, kur të kalojmë te pyetjet dhe diskutimet, do t'i shtoj.

Faleminderit!

**Flutura Aça** – Faleminderit, zoti Ndreca, për relacionin e zonjës Gjylameti!

Zonja Zhupa, për relacionin.

**Ina Zhupa** – Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar kolegë,

Si relatore e këtij projektligji, do të bazohem në versionin që zotërinjtë kanë depozituar për të bërë relacionin tim. Fillimisht dua të shprehem që ne duhej të kishim dëgjuar më shumë aktorë dhe faktorë që përfshihen në këtë ndryshim ligjor, pra të kishim mundësinë që të dëgjonim edhe Akademinë e Shkencave, edhe Ministrinë e Arsimit dhe Financave dhe të kishim mundësi të reflektonim për dëgjesat e bëra me akademikët dhe aktorët shtetërorë. Megjithatë, do t'i referohem këtij drafti.

Në relacionin e dy deputetëve iniciues të amendamenteve nuk jepen argumentet pse duhen këto ndryshime dhe çfarë objektivash do të arrihen me këto ndryshime, kryesisht ndryshimit të nenit 3, që thotë si më poshtë: “Në nenin 11 që lidhet me organet ekzekutive të Akademisë, pika 3 riformulohet si vijon: “Kryetari i Akademisë së Shkencave dhe anëtarët e kryesisë zgjidhen nga Asambleja me votim të fshehtë, të drejtpërdrejtë, me shumicën absolute të votave të vlefshme të anëtarëve të Asamblesë. Po në nenin 11, pika 4, riformulohet si bashkimi i pikës 8 dhe 9, duke shtuar në fillim të fjalisë së parë “kryetari dhe” dhe hiqet togfjalëshi “dhe jo

radhazi”; mandati i kryetarit dhe zëvendëskryetarit është 4 vjet, ndërsa ai i sekretarit shkencor të drejtuesve është 5 vjet. Gjithashtu, reformohet mosha kur ndërpritet mandati i kryetarit. Hiqet mosha mbi 75 vjeç. Kjo nuk u kuptua në asnjë moment të relatimit të të dy deputetëve iniciues, por ne sot kuptuam e dëgjuam nga kryetari i Akademisë së Shkencave, zoti Gjinushi, që ky nuk qenka propozim thjesht i dy deputetëve propozues, por qenka bashkëpropozim me Akademinë, ndërkohë që dje zoti Beqiraj tha se është një propozim vetëm i tyre dhe materialet ne i kemi marrë, duke ndjekur analizat vjetore të Akademisë. Zoti Apollon Baçe në një mbledhje të Akademisë së Shkencave e ka pyetur në mënyrë të drejtpërdrejtë zotin Skënder Gjinushi nëse ata janë duke u marrë me ndryshime ligjore dhe zoti Skënder Gjinushi e ka mohuar këtë fakt, ndërkohë këtu para 20 minutash pohoi...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, është relacioni im.

Pohoi se është pjesë e ndryshimeve ligjore. Pra, po ndalem për t’ia vënë në dukje komisionit të nderuar që na paraqitet një projektligji, i cili është depozituar nga dy deputetë dhe është shprehur nga deputeti iniciator, zoti Ismet Beqiraj, si iniciativë e tyre dhe gjatë diskutimit këtu pranohet që nuk është një iniciativë deputeti, por vjen si iniciativë e pakonsultuar me Asamblesë e Akademikëve, por vetëm, me sa duket, me kryetarin e Akademisë.

Tani dua të ndalem te ndryshimet që propozohen në mënyrën e ndërtimit të organeve drejtuese të Akademisë së Shkencave, pasi ato janë bërë pas kurrizit të Asamblesë dhe të akademikëve. Pra, është një ndërhyrje vertikale mbi komunitetin shkencor.

Objektivi që mendohet të arrihet që jo vetëm kryetari, por edhe 5 anëtarët e kryesisë të qëndrojnë në të njëjtat poste për 8 vjet apo 12 vjet, varet nga interpretimi, mungon. Çfarë objektivash kërkohen të arrihen kur propozojnë që kryetari të vazhdojë të qëndrojë në detyrë edhe pas moshës 75 vjeç, konkretisht edhe 8 vjet të tjerë, deri 83 vjeç? Kërkojmë t’i gjejmë objektivat në relacion për këtë ndryshim, por nuk i gjejmë këta objektiva. Nuk arrijmë dot të kuptojmë se si ligji për Akademinë e Shkencave kërkon që anëtari i Asamblesë që mbush moshën 75 vjeç, e ndërpret të qenit anëtar i Asamblesë, duke marrë titullin “Akademik emeritus”. Atij për shkak të moshës i hiqen disa detyrime thelbësore dhe disa të drejta, sepse legjislatori ka menduar që edhe mosha bën të vetën dhe duhet të kenë pak më shumë liri, por nuk kuptojmë se si ligji “mendon” që pas moshës 75 vjeç fuqitë dhe energjitë e akademikut si rregull dobësohen, atëherë si është e mundur që për iniciuesit e projektligjit një person, ndryshe nga të

tjerët, nuk ndikohet nga faktori moshë dhe mund të trajtohet ndryshe nga të tjerët? Sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të gjithë shtetasit shqiptarë janë të barabartë përpara ligjit ose të gjithë 75-vjeçarët mund të kenë detyrime dhe të jenë anëtarë të përhershëm të Akademisë së Shkencave në Asamblenë e Akademikëve ose asnjëri. Nuk lejon Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë që njëri të jetë më i veçantë se të tjerët dhe të marrë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Flutura Aça** – Ju lutem, zoti Beqiraj, mos ndërhyjni!

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Ina Zhupa** – ...dhe njëri të marrë më shumë kompetenca dhe të ketë detyrime, madje edhe të posaçme, që i burojnë nga qenia e tij kryetar i Akademisë, me detyrime shumë më specifike dhe ndoshta më të rënduara nga kolegët e tjerë, që nuk janë 75 vjeç. A mund të argumentojnë të dy deputetët bashkëpropozues që pse të gjithë akademikët e tjerë konsiderohen se u bien energjitë dhe nuk marrin dot detyra, duke përjashtuar vetëm njërin, pra për atë që do të jetë kryetar i Akademisë?! A mund të argumentojnë deputetët që kryetari i Akademisë së Shkencave, në rastin e heqjes së këtyre ndryshimeve, që do të jetë mbi 75 vjeç, do ta bëjë punën më mirë, që institucioni do të jetë më i zhdërvjellët apo që do t'i përgjigjet më mirë tri projekteve: “Fjalori i madh i gjuhës shqipe”, “Historia e shqiptarëve” dhe “Enciklopedia shqiptare”, duke pasur një mandat përtej moshës 75 vjeç? Ja, si shpreheni ju në projektligj: “Gjithashtu, ligji nuk e përfshin më kategorinë e akademikut të përhershëm, duke iu dhënë akademikëve mbi 75 vjeç statusin “Emeritus” dhe duke i çliruar ata nga disa detyrime institucionale të pjesëmarrjes në veprimtarinë e Akademisë”. Pra, ju e konsideroni si arritje të ligjit të vitit 2019, që akademikët mbi 75 vjeç të çlirohen nga disa të drejta dhe detyrime. Pikërisht për këtë, që ju e konsideroni si arritje në relacionin tuaj, keni bërë një ndryshim, duke arritur që të gjithë të tjerët të kufizohen dhe vetëm njëri prej tyre të mos kufizohet.

Në relacion thuhet se duhet të hiqet në ndërprerjen e mandateve moshë mbi 75 vjeç, që do të thotë se kryetari i zgjedhur mund të vazhdojë punën në krye të Akademisë së Shkencave edhe në moshën 76, 77, 78 apo 90 vjeç.

Sipas amendamenteve, e gjithë Kryesia mund të kërkojë aktualisht vazhdimësinë edhe në 3 mandate, duke e quajtur të konsumuar një mandat para këtyre ndryshimeve legjislative dhe dy mandate të tjera, sipas hyrjes së re në fuqi. Legjislatori është ndodhur përpara kësaj gjendjeje kur ka vendosur kufizimin e mandateve të kryetarëve të bashkive në vetëm 3 mandate dhe numërimi

i tyre nisi nga momenti i miratimit të ligjit dhe sot kemi kryetarë bashkish që kanë nga 5 mandate, sepse numërimi u ka nisur nga momenti i hyrjes në fuqi të ligjit.

Duke parë relacionin, shikon një listë me arritje, që ata i rendisin si suksese të Akademisë së Shkencave. Ajo që ne nuk kuptonim deri para gjysmë ore ishte se ku ishin gjetur dhe ku ishin marrë këto suksese. Pas afirmimit të kryetarit Gjinushi, që këto kanë qenë bashkëpropozime, mendoj se edhe këto suksese janë suksese që i mendon Kryesia për veten e saj dhe janë marrë si material i gatshëm nga zoti Gjinushi dhe nga anëtarët e Kryesisë. Kështu që, ajo që neve na është vënë në dispozicion ditën e djeshme në cilësinë e relatorëve, por edhe komisionit, ka qenë një shkresë që zoti Gjinushi e solli edhe sot në komision, që tregon për miratimin e anëtarëve të Asamblesë. Ajo që nuk tregohet është se bëhet fjalë për një vendim të datës 08.09.2022, pra pasi janë depozituar ndryshimet ligjore. Sipas asaj..

**Skënder Gjinushi** – Të paktën atë lexoje siç duhet.

**Ina Zhupa** – Vendim nr.50, i datës 08.09.2022...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Më falni, a mund ta mbaroj?

**Flutura Açka** – Zoti Gjinushi, nuk i bëni ju pyetjet.

**Ina Zhupa** – Jam në relacion për miratimin...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem!

Më datë 08.09.2022, pra rreth disa muaj më parë akademikët...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Në vendimin nr.50, e datës 08.09.2022, thuhet: “Asambleja e Akademisë së Shkencave përgjigjur kërkesës së Kryesisë, dërguar me postë elektronike për shprehje mendimi për disa amendamente të ligjit nr.53/2019 me relacion përkatës”, por ajo që nuk kuptohet është fakti se ky vendim i shtatorit të vitit 2022 nuk mund të kishte si draft propozimin e ligjit që është depozituar shumë më vonë nga deputetët këtu. Në asnjë moment Asambleja e Akademisë së Shkencave nuk ka diskutuar propozimin për ndryshimin e moshës së kryetarit të Akademisë dhe as propozimin për mandate joradhazi. I vetmi propozim që ka diskutuar Asambleja ka qenë në lidhje me hapjen me studiues të jashtëm, ka qenë edhe në lidhje me elemente të statusit të Akademisë së Shkencave. Ajo që është sjellë dje nga Asambleja, e firmosur, në fakt, vetëm nga kryetari dhe jo nga akademikët, është se ne jemi dakord me vendimin nr.50, të datës 08.09.2022. Ashtu siç unë e

argumentova, ata janë dakord me këtë vendim, por ky vendim nuk kishte si t'i kishte ndryshimet ligjore të reja dhe nuk është bërë një mbledhje Asambleje, ku të kishin mundësi akademikët që të njiheshin.

Zoti Fuga dje ishte në komision dhe parashitroi para nesh se si akademikët nuk kanë marrë një njoftim zyrtar dhe nuk ka pasur një mbledhje të Asamblesë së akademikëve për të shqyrtuar këtë projektligj.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Ajo që ndodh është se një kryetar i Akademisë së Shkencave qëndron në postin e tij pas moshës 75 vjeç dhe një anëtar i thjeshtë i Asamblesë së Akademisë pas kësaj moshe shndërrohet në “Emeritus”. Pra, nëse je anëtar i Asamblesë së Akademisë dhe je 74 vjeç dhe mbush 75 vjeç, atëherë shndërrohesh në “Emeritus”, por nëse je kryetar i Akademisë së Shkencave, je 74 dhe bëhesh 75 vjeç, atëherë nuk shndërrohesh në “Emeritus”. Pra, ti vazhdon të marrësh më shumë detyra se të tjerët duke qenë “Emeritus”, pra nuk je “Emeritus” i njëjtë me “Emeritus”-ët e tjerë, që nëse do, vjen dhe nëse nuk do, nuk vjen, por ke detyra të përcaktuara si kryetar i Akademisë së Shkencave.

Ligji “Për Akademinë e Shkencave”, në nenin 11 të tij, të titulluar “Zgjedhja e Kryesisë”, thotë: “Zgjedhja e Kryetarit i Akademisë bëhet nga anëtarët e Asamblesë...”. Pra, duhet të jesh anëtar i Asamblesë për t'u bërë kryetar i saj dhe që të jesh anëtar i Asamblesë duhet të jesh nën 75 vjeç. Çfarë parashikon ligji? Ligji në nenin 6 të tij, me titull “Asambleja”, parashikon: “Asambleja është trupa e shkencëtarëve dhe e kërkuesve, e cila përbëhet nga akademikë dhe akademikë të asociuar, të cilët do të quhen anëtarë të Asamblesë”. Pra, në Asamble bëjnë pjesë vetëm akademikët dhe akademikët e asociuar.

Më tej, neni 6 thekson: “Numri i akademikëve është deri në 30, ndërsa numri i akademikëve të asociuar është deri në 10”.

Për të kuptuar më mirë përkufizimet ligjore të anëtarëve të Asamblesë, neni 14 i ligjit, “Vlefshmëria” thotë: “Me zgjedhjen si anëtar i Asamblesë, personi fiton titullin “akademik” ose “akademik i asociuar”. Në këtë bashki, që përbën Asamblesë, ligji nuk ka përfshirë as anëtarët e nderit, as anëtarët korrespondentë, as anëtarët e jashtëm, as anëtarët “Emeritus”. Këta të fundit kanë një përcaktueshmëri tjetër ligjore.

Neni 6 i ligjit të Akademisë së Shkencave shprehet: “Anëtarët e Asamblesë që mbushin moshën 75 vjeç, marrin statusin e anëtarit “Emeritus””. Aq e qartë është kjo, sa ligji shprehet në

po atë nen: “Ata nuk përfshihen në llogaritjen e kufizimeve të pikës 1 të këtij neni”. Pra, janë përtej asaj bashkësisë së pikës 1 që janë 30 akademikë dhe 10 akademikë të asociuar.

Në këtë mënyrë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ata nuk përfshihen në llogaritjen e kufizimeve të nenit 1.

Në këtë mënyrë, sipas përcaktimeve ligjore, ne kemi anëtarë të Asamblesë me të drejta, detyra dhe kompetenca të plota: anëtarë nderi, anëtarë korrespondentë, anëtarë të jashtëm, si dhe anëtarë “Emeritus”, që, sipas përkufizimit bazë, përkufizohen si anëtarë të Akademisë, por nuk janë anëtarë me të drejta dhe detyrime të plota të Asamblesë. Fakti që quhen “anëtarë të Asamblesë” nuk ndryshon asgjë, sepse edhe anëtarët e nderit dhe anëtarët e jashtëm quhen “anëtarë”, por jo në kuptimin strikt të anëtarit të Asamblesë 30 plus 10.

Neni 14 e përforcon këtë me parashikimin financiar. Në pikën 3 të nenit 14 thuhet: “Titujt “akademik” dhe “akademik i asociuar” përfitojnë një shpërblim mujor të përhershëm për titull në masën e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave”. Kur kryetari i Akademisë mbush moshën 75 vjeç, sipas ligjit, kthehet automatikisht në “Emeritus”, pra nuk është anëtar i Asamblesë dhe ligji përcakton të përbërë në “akademikë” dhe “akademikë të asociuar”, i cili nuk ka të drejta dhe detyrime të plota në të. Atëherë, si mund të jetë kryetari tij?

Sipas ligjit kryetari i Akademisë së Shkencave jo vetëm që ka më shumë detyrime...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nuk jam te pyetjet, jam te relacioni.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo nuk ka asnjë lapsus.

Atëherë, ritheksoj se kryetari i Akademisë së Shkencave konsiderohet në organet drejtuese të Akademisë së Shkencave dhe ka detyrime të posaçme dhe të veçanta në krye të funksionit të tij, të cilat në rast se do t’ia trajtojnë në statusin “Emeritus”, i bie që të ketë statusin “do t’i bëj, nuk do t’i bëj”, sepse statusi “Emeritus” është i lirë që të kryejë ose të mos i kryejë detyrimet, siç i zgjedhin. A rrezikojmë të kemi nesër një kryetar që të jetë “Emeritus” dhe të thotë: “Dua ta kryej funksionin, nuk dua ta kryej funksionin”, sepse kështu ia detyron ligji? A arrijmë ne të përcaktojmë rolin...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nuk janë pyetje, është relacion.

**Flutura Aça** – Jo tani, ju lutem, se është në relacion.

**Ina Zhupa** – A arrijmë ne kështu të përcaktojmë rolin e sigurt të Akademisë së Shkencave dhe kryerjen e funksionit të kryetarit sipas ligjit? A krijojmë ne si komision një shteg ligjor, ku të gjithë akademikët nuk trajtohen në mënyrë të barabartë, sepse vetëm njëri midis tyre trajtohet në mënyrë të veçantë? A krijojmë ne kështu mënyrën se si kryetari i Akademisë, kur kalon moshën 75 vjeç, të mos i zbatojë të gjitha detyrimet që i kërkon ligji, pasi t'i referohet nenit që si “Emeritus” nëse do, vjen, nëse nuk do, nuk vjen, nëse do, i zbaton dhe nëse nuk do, nuk i zbaton detyrimet me të gjitha prerogativat që i lindin, duke qenë mbi 75 vjeç?!

Ligji nuk mund të krijojë këto kontradikta dhe të krijojë trajtim preferencial për një ndryshe nga të tjerët, sepse na e ndalon Kushtetuta e vendit, por na e ndalon edhe logjika ligjore administrative dhe normale. A mundet që kryetari i Akademisë, sipas nenin 13 të ligjit të Akademisë, të drejtojë dhe organizojë punën e Akademisë? A mundet ai që ta organizojë dhe ta drejtojë punën e Akademisë si “Emeritus”, duke qenë i padetyruar për t'i kryer këto funksione? A do t'i shkonte për shtat Akademisë së Shkencave dhe arritjes së objektivave me tre projektet madhore: “Fjalori i madh i gjuhës shqipe”, “Historia e shqiptarëve” dhe “Enciklopedia shqiptare”, në qoftë se organizmi dhe drejtimi i punës do të ishte në dëshirën e kryetarit, sipas statusit të tij “Emeritus”?

Nëse amendamentet e propozuara nga ju hyjnë në fuqi, ligji për Akademinë e Shkencave do të merrte një kundërthënie të brendshme. Kryetari i Akademisë do të ishte i detyruar nga ligji, sipas nenit 14, të drejtonte punën e Akademisë, ndërsa si “Emeritus” do të ishte i lirë, që nëse nuk do që të punojë, ai nuk punon; nëse nuk do që të shkojë në mbledhje, ai nuk shkon; nëse nuk do që të organizojë punën e Akademisë, ai nuk e organizon. Pra, keni arritur të ndërtoni një ligj me kontradiktë ligjore brenda dhe për këtë arsye ju nuk mund ta kaloni këtë ligj, sepse i njëjti ligj nuk mund të krijojë pabarazi midis akademikëve; i njëjti ligj nuk mund të privilegjojë njërin në krahasim me të ngjashmin e tij; i njëjti ligj nuk mund t'i japë detyra dhe funksione të ndryshme të njëjtit individ, kur një herë i ka me detyrim dhe më pas i ka me dëshirë. Në këtë pikë ju keni shkelur logjikën legjislative.

Amendamentet Koçi-Beqiraj nuk mbajnë parasysh nëse janë në përputhje dhe nëse vijnë në zbatim të shkronjës “a”, të nenit 2 të Rregullores së Kuvendit; shkronjës “b”, të nenit 2, të Rregullores së Kuvendit; nenit 94 të ligjit “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë”; nenit 95 të po këtij ligji; pikat 2, 3, 4 dhe 5 të Kodit të Sjelljes së

Deputetit; pikat e neneve 4, 8, 9, 11, 13 dhe 14 të ligjit “Për Akademinë e Shkencave”; nenin 18 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Të gjitha këto shkelje ligjore të Rregullores dhe të ligjeve janë vërejtur në këtë projektligj që ju keni sjellë.

Nisur nga një shembull i sjellë nga Akademia e Shkencave, duke thënë që mandatet radhazi vijnë edhe si rezultat i ligjit të arsimit të lartë, meqenëse rektorët e universiteteve kanë dy mandate, pse të mos e ketë edhe kryetari? Për këtë ne kemi parashikuar në legjislacion që, e para, nuk qëndron, sepse janë dy ligje të ndryshme; e dyta, nëse ju do të hynit në rregullimet e ligjit të arsimit të lartë, duhet ta dini se nuk zgjidhet dot rektori, në rast se shikohet që brenda mandatit të tij mund të arrijë moshën e pensionit. Në qoftë se doni atë traditë, jam shumë dakord që ta fusim atë traditë, pra ta shtojmë si amendament, që nuk zgjidhet dot kryetari në qoftë se gjatë mandatit të tij arrin moshën 75 vjeç, për të cilën duhet t’i ndërpritet mandati. Ky do të jetë një nga amendamentet e mia për këtë projektligj. Pra, në momentin që ju i referoheni ligjit të arsimit të lartë dhe i referoheni modelit të arsimit të lartë dhe përderisa ju keni një ligj të Akademisë së Shkencave, që krijon këtë kontradiktë, ju nuk mund të krahasoheni me ligje të tjera, që nuk e lejojnë këtë kontradiktë. Pra, ju kontradiktën e keni brenda ligjit të Akademisë së Shkencave. Në rast se ju do të keni një ligj tjetër, që do të rregullonte punën tuaj, atëherë do të shikonim nëse do të kishte kontradiktë apo jo.

I bëj me dije komisionit se kundërshtitë tona kanë marrë edhe një ekspertizë juridike të pavarur. Gjithashtu, i bëj me dije komisionit se relacioni që shoqëron amendamentet në fjalë nuk plotëson kërkesat dhe procedurat ligjëbërëse dhe për të tilla ky komision nuk mund ta marrë në shqyrtim.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Ju lutem, se di edhe unë të bëj zhurmuesin kur të flisni ju.

I bëjmë me dije komisionit se duke qenë se nuk kemi një politikë, e cila bazohet në vendimmarrje të ligjshme, ai nuk duhet të marrë këto vendime kontradiktore dhe të nxituara. Të gjithë si komision kemi mundësi që duke ia vënë në dukje relacionin dy propozuesve që ne njohim, atyre t’u jepet koha e nevojshme për t’i rregulluar këto kontradikta brenda ligjit dhe për të garantuar barazinë e të gjithëve para ligjit, siç e detyron Kushtetuta, dhe të sillni një ligj, i cili pranon konceptet juridike, pranon konceptin formal të formulimit të shqyrtimit të ligjit, nuk bie në kontradikta të brendshme dhe nuk shkel Kushtetutën e vendit. Ne nuk kemi asnjë arsye pse sot të kalojmë këtë projektligj.



Për ta përmbyllur, dua të shtoj se jam dakord me relatore, zonjën Gjylameti, që është edhe një herë e domosdoshme që në fund, para votimit ne ta arrijmë të kërkojmë mendimin e Këshillit të Ministrave në lidhje me vendimmarrjen që mendojnë ata për sa i përket këtij projektligji që kanë sjellë dy deputetët. Pa dyshim, ndoshta edhe trupa e Këshillit të Ministrave, nuk e kuptoj pse dy deputetët e kanë shqetësimin me Këshillin e Ministrave, mund t'i vërë në dukje dhe mund t'u kërkojë të njëjtat korrigjime të kontradiktave të brendshme të ligjit.

Për sa u përket argumenteve për funksionimin më të mirë të Akademisë së Shkencave, që mund të bëhet me zgjatje mandatesh apo me një mandat të dytë të personave të caktuar, ne vërejmë se nuk ka asnjë argumentim ligjor apo psikofizik pse duhet të ndodhë kjo gjë. Pretendimi i propozuesve se rizgjedhja fuqizon punën kërkimore shkencore dhe sjell më shumë produkt, nuk provohet me një ndryshim neni në ligj. Puna kërkimore nuk bëhet dhe as nuk komandohet nga drejtuesi i Akademisë së Shkencave, por nga burimet njerëzore që rekrutohen, cilësia e projekteve që ndërmerren e kështu me radhë.

Pra, nevoja për një mandat të dytë në drejtim për të fuqizuar punën kërkimore nuk legjitimohet për shkak se, sipas ligjit, kryetari i Akademisë dhe vetë Akademitë nuk janë të përfshira drejtpërdrejtë në punën kërkimore dhe u ndërpritet puna kërkimore po të mos i bëjnë mandatet radhazi. Në nenin 58 të Kushtetutës thuhet se nuk është e nevojshme që ne të garantojmë një mandat, dy radhazi, për të garantuar energji apo dinamikë të re të institucionit, përkundrazi, duke arritur të bëjnë rotacionin, për të cilin ka votuar zoti Beqiraj dhe ka qenë relator në vitin 2019, ku i njëjti kryetar nuk e mbante dot, ose të bënte rokadën kryetar-nënkryetar, kryetar dhe prapë nënkryetar, ne garantonim që të krijohej frymëmarrje, çlirim dhe të kishte mundësi të vendosej gjak i ri në krye të Akademisë, me projekte dhe me ide të reja, për të ndikuar në jetën akademike shqiptare.

Me këtë dua ta mbyll fjalën time. Më pas do t'i rezervoj vetes të drejtën e pyetjeve drejtuar zotit Skënder Gjinushit, kryetarit jolegjitim të Akademisë së Shkencave dhe dy propozuesve.

Faleminderit!

**Flutura Aça** – Faleminderit!

Vetëm një sekondë, zoti Koçi.

Zonja Zhupa, pyetjet do të jenë vetëm për këtë projektligj. Kur të jetë çështje për Akademinë, zoti Gjinushi, do të vijë enkas për Akademinë...

**Skënder Gjinushi** – Personalizime të mos bëhen më.

**Flutura Aça** - Ia tërhoqa vërejtjen.

Zonja Zhupa, ju lutem, duhet të përqendrohemi te çështjet tona!

*(Ndërhyrje pa diskutim)*

Zoti Koçi, a kishit ndonjë gjë?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem, zonja Zhupa, nuk është çështje që e zgjidhim ne, pra që do ta zgjidhim sot këtu.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti Gjinushi, ju lutem!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem, të mos debatojmë!

Zonja Zhupa, po diskutojmë një çështje tjetër.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem, zonja Zhupa, jemi duke folur për këtë projektligj...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti Gjinushi, edhe kjo që ju thatë është personale. Pra, edhe ju ratë në grackë. Mos bini në grackë. Ndoshta zonja Zhupa ju bëri të bini në grackë, por ju mos bini në atë grackë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jemi duke folur për këtë ligj, prandaj të merremi me ligjin.

Zoti Gjinushi, do të merremi me ligjin.

Zonja Zhupa, ju lutem, respektoni kolegët!

Zoti Koçi, para se t'i bëj disa pyetje zotit Beqiraj, a kishit ndonjë gjë për të shtuar?

Zonja Zhupa dhe zoti Gjinushi, po ju tërheq vërejtje. Herën e dytë nuk ju tërheq më vërejtje, por do t'ju tregoj derën të dyve.

Ju lutem, debati duhet të mbarojë këtu, në mënyrë që të vazhdojmë të procedojmë.

Zoti Beqiraj, besoj se kolegët kanë pyetje për ju. Personalisht kam disa pyetje, por në fillim dua të respektoj kolegët.

Zoti Ndreca.

**Eduard Ndreca** – Në fakt, mendimet që kam dhënë si relator te Komisioni i Ligjeve do t'i parashtrij këtu në formën e pyetjeve për zotin Beqiraj, që edhe unë të sqarohem më mirë në lidhje me kërkesat që kam shtruar këtu.

Zoti Beqiraj, kërkoj vëmendjen tuaj.

**Flutura Aça** – Zoti Beqiraj, siç e kemi lënë do të përgjigjeni pas çdo pyetjeje që ju bëjnë deputetët.

**Eduard Ndreca** – Pyetja e parë. Zoti Beqiraj, a thua do të ishte më mirë që të vihej një kufi te numri i anëtarëve të jashtëm? Normalisht, të mos jetë 10, pra aq i kufizuar sa ka qenë më parë, por të vihet një kufi.

Zoti Beqiraj, e morët pyetjen?

E dyta, në lidhje me mandatet. Në fakt, unë do të dëshiroja që institucioni i Akademisë së Shkencave të mos jetë i fokusuar aq shumë te zgjedhjet brenda këtij institucioni, por mbi të gjitha te puna parësore. Unë i vlerësoj, të paktën 3 projektet e mëdha që ky institucion ka nisur, mirëpo ndonjëherë duket që ethet e zgjedhjeve brenda institucionit shkëpusin vëmendjen nga projektet e mëdha. A mos mendoni se do të ishte më mirë që kryetari i Akademisë së Shkencave ose institucioni i Akademisë së Shkencave të trajtohet si këto institucionet e drejtësisë, institucionet e reja që ne kemi krijuar, me një mandat të gjatë, në mënyrë që puna e projekteve që nisen ose ethet e brendshme të mos e pengojnë rrugën për të prodhuar realisht shkencë?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, nuk e kam personalisht.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, pikërisht edhe të tjerët ndikojnë negativisht brenda institucionit, patjetër.

Unë do të kisha propozuar një mandat, për shembull, le të jetë mandati 7 vjet, sesa të kalojmë çdo 4 vjet në garë. Nuk duhet të harroni se do të vijë një moment kur ky institucion, ndoshta kur të mos jetë zoti Gjinushi, më falni, zoti Gjinushi, ata që do të jenë do t'i nënshtrohen garës së egër brenda vetes dhe natyrshëm do të ketë edhe divergjenca të mëdha brenda institucionit.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, e kemi sot, por ne po bëjmë një ligj për të ardhmen, jo vetëm për sot.

Pra, a mendoni kështu, zoti Beqiraj?

Pyetja e tretë është në lidhje me moshën. E hiqni kufirin e moshës 75 vjeç. Dakord, për këtë institucion le ta heqim moshën 75 vjeç, sepse është një institucion që është ajka e kësaj shoqërie dhe patjetër mund të qëndrojnë edhe më gjatë, por unë nuk e konsideroj të arsyeshme që të mos ketë një kufi moshe. Ata që e kalojnë këtë kufi, le të jenë akademikë, le të kenë tituj nderi

e të tjera, por jo të jenë me detyra brenda institucionit të Akademisë, kur kalon një kufi i caktuar moshe. Në konceptin tim, do të ishte mirë ta shikonit.

Pyetja e fundit që kam. Ne, pak kohë më parë, jemi njohur me një VKM që shkrin Qendrën e Studimeve Albanologjike dhe ia bashkon Akademisë së Shkencave. A mos do të kishte nevojë për ndryshime ligjore në momentin që ndodh kjo shkrimje? Nëse do të kishte nevojë, unë do të kisha propozuar që këto ndryshime ligjore të kishin ardhur të paktën brenda kësaj...

**Ismet Beqiraj** – Edhe këtë si pyetje e keni?

**Eduard Ndreca** – Po, si pyetje. Po ju pyes ju, zoti Beqiraj.

Për të qenë realist, unë e vlerësoj projektin që ka Akademia e Shkencave, si dhe vendimin e Këshillit të Ministrave në lidhje me Qendrën e Studimeve Albanologjike, patjetër, sepse mendje shumë të më larta sesa unë e kanë vendosur këtë. Sa i takon qëndrimin personal, do të isha kundër shkrimjes së Qendrës së Studimeve Albanologjike, pasi ne kemi nevojë për sa më shumë ngrehina, sepse duket sikur nxisin edhe një lloj konkurrence, edhe të prodhimit shkencor. Le të jetë kjo konkurrenca e prodhimit shkencor. Natyrshëm, ne mund të kishim ndërtuar një projekt që në të ardhmen ta shikonim edhe Qendrën e Studimeve Albanologjike se si do t'i shkonte puna, sepse sa më shumë ngrehina të prodhojnë shkencë, aq më mirë do të jetë.

Unë nuk e vë kurrë në dyshim se studimet albanologjike brenda Akademisë së Shkencave do të jenë në nivelin që kërkon ky vend, por do të kisha qenë për një lloj kontrolli. Le të jetë ky kontrolli i Akademisë së Shkencave, por jo një mbyllje e plotë e një institucioni, i cili, në fakt duhej të ishte parë me një sy tjetër.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Transferim?!

Po kjo shkrimje është.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Kjo është si pyetje, por më duhet të mendohem për përgjigjen.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti Beqiraj, me këtë shkrimje, a do të kishte nevojë për ndryshime ligjore brenda ligjit të Akademisë së Shkencave apo nuk ka nevojë?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, pra për këtë po e them. Kjo është në thelb pyetja që ju bëra në fillim, ndërsa sa i takon qëndrimin për Qendrën Albanologjike, është personal.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Këto ishin pyetjet e mia zoti Beqiraj.

**Flutura Açka** – Zoti Ndreca, faleminderit!

Zoti Beqiraj, fjala për ju.

**Ismet Beqiraj** – Edhe gjatë prezantimit të relacionit, duke parë reagimin e deputetëve, besoj se të gjithë kanë qenë të vëmendshëm, ndaj po bëhet gjithë ky debat i gjatë.

Njëra pyetje kishte të bënte me një kufizim të anëtarëve të jashtëm dhe për korrespondencën, ku ne themi “vetëm anëtarëve të jashtëm”. Koncepti është që ne, si nismëtarë, e argumentojmë, gjë për të cilën jemi shprehur edhe në Komisionin e Ligjeve. Synimi ka qenë që ne ta hapim këtë hapësirë më shumë. Madje, po t’ju nxjerr draftplatformën e kolegut, akademikut Fuga, ai kërkonte 60-80 veta më shumë, ku me gjithë kornizën e anëtarëve të Asamblesë, të cilët janë 30 plus 10, shkonte 130. Ne kemi një fenomen, të cilin duhet ta pranojmë, pra kemi një lëvizje të shumë intelektualëve edhe gjatë shkollimit, pra të atyre që kanë mbetur jashtë shtetit, kryesisht në vendet perëndimore, por edhe në Amerikë dhe në Kanada, të cilët janë të suksesshëm në studime dhe kërkime dhe ky është nder për ne. Jo më kot edhe në ligjin, ku ne nuk kemi ndërhyrë, është: “Anëtarë të jashtëm bëhen ata që janë anëtarë të akademive të këtyre vendeve”. Më konkretisht është marrë Shoqata e Akademikëve të vendeve perëndimore europiane ALLEA-s, që është futur. Përderisa një iks akademik, ju kërkoi ndjesë se nuk dua ta përmend emrin këtu, është një personalitet, i cili jeton dhe punon në Spanjë, pse ne të mos e kemi anëtar, bie fjala, ose në Gjermani dhe kudo?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Më falni!

Po e kufizua ne, sepse kjo është dysheme dhe tavan, kjo mbushet. Po ai që është anëtar i Akademisë...

**Flutura Açka** – Zoti Ndreca, ju mund ta diskutoni pastaj, prandaj lëreni ta mbaroj fjalën zoti Beqiraj!

**Ismet Beqiraj** - ...dhe këta nuk marrin as honorare, nuk janë të detyruar që të vijnë të votojnë...

**Skënder Gjinushi** – Nuk kanë votë.

**Ismet Beqiraj** - ...se nuk kanë votë, janë gati *ex officio*. Për ne shqyr që e japin atë kontribut dhe të vinë të na gdhendin ne këtu, po jua them shqip me një zhargon popullor, ku ta gjejmë këtë gjë.

Lidhur me pyetjen e dytë, për mandatet, a mendoni se do të ishte mandati i tyre? Me të drejtë, sepse me të drejtë gjithmonë debatohet, edhe relatorja, zonja Zhupa e tha, ju jeni me nismë personale, jo kjo apo jo. Jo, ne...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, nuk e kam për ju konkretisht, por do të doja ta sqaroja edhe publikisht. Sa i takon të drejtës për të bërë nismë ligjore në Kushtetutë parashikohet një njeri i vetëm, më shumë se një njeri, qeveria, si dhe 20 mijë zgjedhës për një çështje të caktuar. Edhe këtë ligj, për të cilin po flasim ne sot, pra sa u takon ndryshimeve (unë kam një botim të Akademisë së Shkencave, për reformën në Akademinë e Shkencave hap pas hapi, nga nga fillimi deri në fund janë mbi 51 akte nënligjore, urdhra të Ministrisë së Arsimit, të Akademisë së Shkencave dhe të grupeve të punës që janë ngritur për këtë punë; po ta lexoni edhe relacionin, personat që e kanë përgatitur, sepse në fund të çdo ligji thuhet: kush është angazhuar për ta përgatitur këtë projektligj, bashkëpunimi, sigurisht edhe indicia mbi bazën e shkresave që ne kemi këtu), mua nuk do të më vinte mendja po të mos e kishte bërë Akademia e Shkencave, Kryesia dhe Asambleja, që nga tetori apo kur i bie, ta shoh shkresën që të jem korrekt, që në shtator të vitit 2022, që unë e Petroja ta nxisnim këtë nismë, duan apo nuk duan akademikët. Pra, indicia dhe nxitja është bërë nga vetë ata si nevojë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

E di, por më falni edhe 1 minutë!

Lidhur me shtrirjen e mandateve kam parasysh, që e ka propozuar që në fillim grupi që është ngritur, i cili ka qenë një grup...

**Flutura Aça** – Zoti Beqiraj, a mund të bëj edhe një shtesë të vogël, brenda pyetjes, zoti deputet?

**Ismet Beqiraj** - ...lidhur me zgjatjen.

Në qoftë se do të më pyesni, atëherë ka qenë fryma që do të reformojmë Akademinë e Shkencave, edhe dje ju nuk ishit këtu...

**Eduard Ndreca** – Profesor, ju keni bërë realisht një rregullim serioz në çështjen e mandateve, ku e keni shmangur zgjedhjen një herë, pastaj do të bësh pushim, pastaj mund të

zgjidhesh pas dy herëve të tjera. Ky ka qenë një absurditet i madh brenda ligjit, realisht, prandaj ky rregullim është mëse i nevojshëm. Pyetja që shtroj unë është pyetje që u drejtohet ju, si nismëtar i këtij ligji. A mendoni se një mandat i gjatë krijon kushtet, jemi duke folur për Akademinë e Shkencave, nuk po flasim për një drejtor ndërmarrjeje kur do të na duhet t'ia shkurtojmë mandatet, a ku di unë?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ismet Beqiraj** – Unë kam pasur fatin dhe nderin të jem relator edhe i ligjit bazë dhe për këtë kam bashkëpunuar gjatë, jo vetëm unë, por të gjithë kolegët e nderuar...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Lidhur me zgjatjen e mandateve...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

...ka pasur...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Shiko, mandati edhe mund të ishte i gjatë. Po të më pyesni mua personalisht, mandatet e gjata krijojnë një stabilitet më të qartë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, se është respektuar vullneti i akademikëve...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Do të bëjmë reformim me mandate të kufizuara jo më shumë se 2, mbaroi filmi.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po ishte vullneti i akademikëve, çfarë t'ju them unë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

E kanë zgjidhur vetë, pra!

Po të më pyesni mua, unë jam në një linjë me ju, për stabilitet.

Por, po ju them edhe anën tjetër, modeli i institucioneve të drejtësisë ka lindur më poshtë, me mandate 7 dhe 9-vjeçare.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem, a mund t'ju kthej një përgjigje pyetjeve, që të mos zgjatem shumë?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Lidhur me moshën...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Edi, të lutem!

Unë e kuptoj shqetësimin, sepse siç jua thashë, edhe vetë, kur nis një projekt, ky projekt do të përfundojë për 5 ose 6 vjet, duke mbetur në mes, gjë, që nuk është korrekte.

Unë me mendimin tuaj jam, por ama prevalon vullneti i akademikëve.

Në lidhje me moshën, të mos jenë me detyra mbi moshën 75 vjeç.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Eduard Ndreca** – Jo, nuk e keni kuptuar pyetjen.

**Ismet Beqiraj** - Si?

**Flutura Açka** – Keni pyetje tjetër?

**Eduard Ndreca** – Jo, nuk kam pyetje tjetër.

**Flutura Açka** – Zoti Beqiraj, a mbaruat?

**Eduard Ndreca** – Jo, nuk e ka kuptuar një pyetje që i bëra.

**Flutura Açka** – Ju lutem, përsëriteni, zoti Ndreca!

**Eduard Ndreca** – Jam dakord që ju keni hequr moshën 75 vjeç, por a mendoni se duhet të vini një kufi moshe, pastaj pas këtij kufiri le të jetë anëtar nderi i Akademisë? Ose nëse është e parashikuar, ma sqaroni.

**Ismet Beqiraj** – Kjo është e parashikuar në dispozitat e tjera të projektligjit, kështu që mund ta lexoni.

Pyetja e fundit, a ka nevojë për ndryshime ligjore të tjera? Unë nuk them asnjëherë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Eduard Ndreca** – Në lidhje me QSHA-në....

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ismet Beqiraj** - Pra, lidhur me pyetjen e tretë që edhe të regjistrohet, kjo është parashikuar, është lënë në vullnetin, në tagrin e akademikëve që të angazhohen, dhe sa i përket pyetjes së dytë, është parashikuar angazhimi ose jo, në dispozitat ligjore.

Pyetja e fundit që keni në lidhje me ndryshimet e tjera ligjore, unë nuk them kurrë jo, por gjithçka është në dinamikë, kur do të lindë nevoja.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

E di, madje edhe unë jam, madje atë pyetje më duket sikur unë e kam materializuar dhe në nismë ligjore në fund.

**Flutura Açka**- Po, zoti Gjinushi.



**Skënder Gjinushi** – Duhet të jetë shumë e qartë që, e vetmja gjë që ndryshon për ASA-n është varësia. Pra, deri sot ASA, *de facto* varet nga Ministria e Arsimit, në mënyrë përjashtimore nga të gjitha institutet e tjera, sepse institutet duhet të jenë pjesë e shkollave të larta. Ky është ligji i arsimit të lartë, kurse ASA u hoq nga Akademia dhe mbeti as brenda shkollës së lartë, as pranë Akademisë. Sot ajo ka një bord administrativ, i cili kontrollohet, 5 i ka ministria , 4 i ka vetë ASA. I vetmi ndryshim është që ASA quhet pranë Akademisë së Shkencave dhe bordi administrativ do të përbëhet nga vetë drejtuesit e ASA-s dhe të Akademisë së Shkencave. Ky është ndryshimi.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Si, ku e pe? Unë do ta bëj, ti thua ku e pe!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po e qartë, ne, si institucion.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Pra, absolutisht dhe vendimi që do të dalë nga qeveria, sepse ASA-s i mungon një vendim qeverie. Është i vetmi institucion që nuk punon me vendim qeverie, se edhe vendimi i vitit 2007 është shuar dhe thotë që për dy vjet është periudhë tranzitore, pastaj duhet të përshtatemi me ligjin e arsimit të lartë, gjë që nuk ka ndodhur. Pra, ASA ka një problem ligjor të vetin, ka dhe një problem konceptual, që ne vlerësojmë se duke qenë pranë Akademisë, absolutisht do të jenë edhe më autonomë, edhe më efektivë, siç kanë qenë ndër vite.

Kurse sa i takon organizmit, absolutisht ASA vetëm do të zgjerohet, nuk do të ngushtohet, qoftë në kapacitete.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, patjetër. Emri iu vu Akademisë, sepse iku nga Akademia dhe këto ishin lojërat që u bënë atëherë. Edhe drejtori quhet rektor, drejtuesit e instituteve quhen dekanë. Ajo është një zgjidhje hibride, që të tërë duhet të uroni të gjendej një zgjidhje dhe vetë ASA ka qenë, ose duhet të bëhej shkollë e lartë, ose duhet të vijë pranë Akademisë së Shkencave. Kaq e thjeshtë është. Dhe tani, këto rregullimet në financim, saktësimet që janë kërkuar, janë pikërisht meqë bëheshin tashmë disa njësi që janë në ngritje e sipër, po do të kesh edhe institute, e kemi saktësuar edhe një herë që këto përcaktohen në akte që do të dalin, të cilat do t'i nxjerrë kryesisht Këshilli i Ministrave. Kështu që tani duhet të pyesësh Këshillin e Ministrave, a është dakord për të caktuar pagat. Po, ata i caktojnë pagat, kurse efektet janë kur t'i caktojnë, kur të vijë ASA-a pranë nesh

për shembull, atëherë do të shihet nëse do t'i rrisë apo do t'i ulë, apo do t'i ngrejë, ashtu siç do të caktoni edhe ju tonat. Dhe ne nuk urojmë që të jeni po aq bujarë sa për tuajat.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Edhe ligji i arsimit të lartë, institutet i quan njësi. Pra, njësi quhet çdo strukturë që është pjesë e një institucioni më të madh. Kështu që ASA, ose institutet e saj do të jenë po institute, por pranë Akademisë, me të vetmin ndryshim, dhe mund të lexoni, sepse ligji është bërë me kohë, është botuar nga ju, dhe thuhet qartë se janë autonome, dhe shkruhet me shumë delikatesë që ASA, institutet mbajnë marrëdhënie me kryesinë dhe Kryetarin. Nuk përdoret kurrë fjala “varësi”, se ne nuk jemi organ ekzekutiv.

Ajo që thoni ju, që të rriten kapacitetet, nuk është se kemi dhe ne institute dhe ata, dhe po i bashkojmë. Te ne nuk ka, është vetëm Asambleja që është një bord i shkencës. Nuk është pjesë aktive. Anëtarët e Akademisë janë aktivë pranë institutit ose pranë shkollës së lartë, kurse pranë nesh janë si akademikë, si bord.

**Ismet Beqiraj** - Në ligjin e ri të Akademisë së Shkencave, pikërisht kjo është pasur parasysh, shkrirja e instituteve në vendin tonë, si rasti konkret dhe i Akademisë të Studimeve Albanologjike. Prandaj është specifikuar. Akademia përfshin edhe disa struktura të ngritura në përbërje ose pranë saj. Kjo është një risi e atij ligji që përballet pa meritë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Flutura Açka** – Një pyetje zonja Buxheli, pastaj kam unë dy pyetje të vogla.

**Lindita Buxheli** – Unë e bëra pyetjen paraprakisht, sepse isha në dy komisione njëkohësisht; në dijeninë time, të gjitha institucionet buxhetore që realizojnë të ardhura, i mbyllin ose i shpenzojnë ato brenda vitit kalendarik. Këto institucione natyrisht realizojnë edhe të ardhura dytësore për shërbime të ndryshme që mund të kryejnë, por edhe kjo futet në projektbuxhet dhe përsëri realizohet brenda vitit kalendarik.

Dëgjova këtu për trashëgim të ardhurash, prandaj ia bëra pyetjen dhe Ministrisë së Financave. A ka ndonjë ligj specifik ose udhëzim të veçantë? Unë kam qenë 8 vjet drejtoreshë e Thesarit në Lushnjë dhe këtë pjesën e buxhetit e kam të konsumuar, e di, veç nëse ekziston një ligj apo udhëzim në veçanti për Akademinë e Shkencave për të trashëguar, sepse në dijeninë time realizohen brenda vitit kalendarik.

**Ismet Beqiraj** – Ekziston ligji për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë nr. 9936, që sqaron dhe pjesën e skadencës së fondeve buxhetore deri më datën 31

dhjetor të vitit buxhetor. Kështu që është ky ligj që trajton pjesën e mosmbartjes së fondeve vitin tjetër. Thënë kjo, buxheti që miratoni dhe ju si komision i nderuar është 3-vjeçar. Pra, buxhetohet për 3 vjet, jo vetëm për një vit.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, edhe projektet, sepse ka qenë edhe rëndësia që ka, që projektet të kenë dhe shtrirjen kohore të futur në ligjin vjetor të buxhetit që miratohet.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, ajo pastaj rinovohet me kalimin e kohës, sepse kapet një vit i ri gjithmonë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Skënder Gjinushi** – Duhet kuptuar që ky nuk është propozim që na erdhi ne kështu në mendje, kjo ka ardhur, sepse qeveria vetë ka krijuar një precedent. Me rastin e tri projekteve madhore dhe marrëveshjen e dy qeverive, me të Kosovës, është garantuar financimi 5-vjeçar i Enciklopedisë dhe atëherë që sugjerimi i qeverisë, që të shtojë, që në ligjin e Akademisë së Shkencave të vihet ky përjashtim, prandaj kërkohet ky përjashtimi. Tani, këtu korrektesa është kjo që Ministria e Financave, e cila, dhe formulimi është bërë bashkë me ta, pra dhe në konsultim dhe me deputetët që të shtohet një për mbajtjen e fondit për projektet. Megjithatë, nëse vlerësoni se mendimi nuk ka ardhur, miratohet një herë tjetër.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Më lejoni një sugjerim, por kjo është bërë, thashë, si praktikë, se është tashmë në vendim qeverie, pra është mendimi i qeverisë, është nisur me ta, në konsultim dhe me Ministrinë e Financave, ndërsa proceduralisht, me aq sa, meqë përmendët përvojën, kalon projektligji, ndërsa ky amendament kërkohet mendimi dhe po ta doni dhe me shkrim, dhe po ia dhanë viston e votoni, po nuk e dhanë, nuk e kaloni.

**Flutura Aça**- Faleminderit!

Doja vetë ta pyesja zotin Opre, meqenëse ra tani fjala, doja të dija, zoti Opre, çfarë mandati keni marrë, nga kush jeni ftuar dhe në emër të kujt keni ardhur për të raportuar sot, nëse kemi ndonjë pyetje?

A e di, zoti Opre, që të paraqitesh në këtë komision ne na duhen gjërat me shkrim, sepse është përgjegjësi për ne. Këto dy gjëra kisha për ju. Pastaj do të flas me zotin Beqiraj.

**Gentjan Opre** - Jam i njoftuar nga Ministria e Financave që të vij këtu në këtë komision.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Flutura Açka-** Zoti Opre, ne kemi vendosur dje në komision që t'u dërgohet shkresa me shkrim sot, mundësisht dje, mund të ketë shkuar edhe sot. Nuk e di kur ka shkuar shkresa, do të thotë që ju duhet t'i përgjigjeshit asaj shkrese, që është vendosur në këtë komision dje. Nuk e kuptoj kush ju ka ftuar ju sot këtu. Nuk kam ndonjë gjë, se ju jeni djalë shembullor në të gjitha pikëpamjet, por nuk e di kush ju ka ftuar, sepse ky komision ka marrë këtë vendim dje, unanimit, ka qenë një vendim i këtij komisioni për dje.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Të vazhdojmë se jam e qartë.

Zonja Zhupa, do të bëj nja dy pyetje unë dhe pastaj do të vazhdoni ju.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Unë pyetje do të bëj, se ju folët. Më lejoni mua dy pyetje të vogla.

Zoti Beqiraj, a mund të bëj pyetjet unë?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo nuk do të përgjigjeni, se zoti Opre do të përgjigjet vetë, nuk ka nevojë për asnjë lloj ndërhyrjeje.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nuk e di. Mos më pyesni mua për gjëra që nuk i di, i di sa dini ju.

Nuk di asgjë më shumë se kaq.

Zoti Beqiraj dhe zoti Koçi, ju e dini se ju jeni njerëz politikë?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Pra, të mbaroj unë pyetjen, se e kam në kuptimin pozitiv. Nuk kam asnjë lloj ironie. Unë thjesht kam një pyetje, madje kam pyetje shumë të thjeshta, si për klasë të parë i kam.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Me ju, shaka kam bërë dhe bëj prapë, se ju jeni djalë që i mbani shakatë, por, nëse e kam tepruar, kërkoj ndjesë, vetëm në kuadrin e shakasë. Ironi me ju, kurrë nuk do t'ia lejoja vetes të bëja.

Megjithatë, ju dhe zoti Koçi jeni njerëz politikë. Zoti Gjinushi, se e gjithë çështja është aty. Zoti Gjinushi ka qenë një njeri politik të gjithë jetën e tij, të paktën unë kam qenë fëmijë kur e kam parë nëpër ekrane, në njëfarë mënyre, ai është pjekur, ne jemi rritur bashkë, kështu që është njeri ekskluzivisht politik. Unë do të doja të dija: a keni ju njohje personale me zotin

Gjinushi, miqësi personale me zotin Gjinushi? Jua thashë, janë pyetje për klasë të parë. Mos u shqetësoni, zoti Gjinushi është i ftuar.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po prit të mbaroj pyetjet!

A keni ju njohuri për cv-në e zotit Gjinushi, që është njeri politik? Ka qenë të gjithë jetën njeri politik. Dhe a e shihni ju, nëse keni miqësi personale me të, si njeri politik, që sillni një projektligj për një njeri politik pak a shumë, a shihni ju një konflikt interesi në propozimin tuaj?

Ju dje gjatë referimit tuaj keni thënë që ky është një projektligj i iniciuar prej dy deputetëve, prej jush, si anëtar komisioni, dhe zotit Koçi, ndërsa sot rezultoi se në fakt jeni bashkinicues me Akademinë e Shkencave, siç e keni deklaruar ju sot, është e regjistruar.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Pyetje tjetër, tani ju merrini bashkë ose merreni si të doni, pra, ju duket se jeni bashkinicues përderisa e keni ftuar ju. Ju keni më shumë fuqi se ne këtu, është çështja juaj. Atëherë, a shihni ju në këtë gjë konflikt interesi?

Ju sollët një draft paraprak, që e keni depozituar këtu diku nga janari i vitit 2023, nëse jam e saktë, pastaj e keni ndryshuar gjatë kohës që ne kemi punuar ligjin këtu, e keni ndryshuar prapë dje, sot erdhët me ndryshime të tjera. Ne duam ta dimë dhe duam ta dimë me shkrim, se kanë punuar njerëzit. Dhe të paktën unë kështu e di, që njerëzit duhet të jenë seriozë në gjërat që bëjnë, cili është drafti përfundimtar? A mund ta dorëzoni draftin përfundimtar, që ne të punojmë me atë draft përfundimtar këtu dhe të mos hallakatemi me ditë dhe me orë që kemi, këtu bashkë?!

Zoti Beqiraj, në një shkresë që na ka ardhur pasi ne bëmë ftesën, ftesë shumë zemërgjerë dhe me asnjë lloj prapavije politike, siç kemi bërë disa herë, edhe zotin Gjinushi kemi dashur ta kishim këtu personalisht, nuk kam asnjë lloj tendence për ta lënduar në njëfarë mënyre me ironi, ne thjesht bëjmë detyrën, pasi kanë qenë projekte të mëdha dhe ne kemi pasur nevojë të dimë se çfarë bëhet me projektin. E kemi bërë dëgjuesën me akademikë të nderuar dhe kemi qenë shumë të kënaqur nga ajo dëgjese, megjithëse u prish në fund për arsye që unë nuk i kuptoj dot. Para disa ditësh, në datën 7 korrik na ka ardhur një shkresë që është depozituar po me 7 korrik këtu, shpejt e shpejt, ndonjëherë kur do shteti të funksionojë funksionon shumë shpejt, ku ne na dërgohet një relacion që Asambleja e Akademisë së Shkencave është dakord me variantin përfundimtar, i cili, në fakt, nuk është përfundimtar sot, sot ende nuk është përfundimtar. Jam

dakord me një variant përfundimtar, që nga ai momenti i datës 7 korrik ka ndryshuar disa herë prapë dhe nuk është përfundimtar, por megjithatë po e marr të mirëqenë, dhe aty flitet për të gjitha pikat e atij projektligji që keni ju, kur në fakt anëtarët e Asamblesë janë njohur dhe kanë vënë firma në një shkresë tjetër, pa protokoll, ku i referohet vetëm një pike te vogël të këtij projektligji, që ka të bëjë me hapjen e mëtejshme të studiuesve shqiptarë jashtë vendit, unë po e lexoj siç është këtu. Në fakt, hapjen e mëtejshme të mundësive, po nuk ka rëndësi, se e ka shkruar sekretarja dhe mund të bëjë një lapsus dhe janë gjëra normale. Pra, akademikët nuk janë të informuar, në fakt, fare për projektligjin, por kanë firmosur në një gjë që është shumë e shkurtër dhe nuk është thelbi i këtij ligji. Pra, e keni dijeninë e kësaj shkrese? A e dini që akademikët kanë firmosur një gjë krejt tjetër nga varianti juaj dhe nuk kanë dijeni fare, sipas kësaj shkrese?! Unë nuk gjej dot fare. Zoti Gjinushi, pyetjet i bëj unë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti Beqiraj do të japë përgjigje. Për mua po. Unë jam në komision dhe unë po them se varianti me të cilin janë informuar akademikët e nderuar, disa prej të cilëve i kam miq dhe i nderoj jashtëzakonisht...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, e kam këtu. Nuk është puna kalamaj, nuk ka lidhje me kalamaj fare, ka lidhje me të drejtën e informimit.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Kanë firmosur miqtë e mi të nderuar, një pjesë e tyre janë miqtë e mi të nderuar...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Edhe ato i kam miq, në fakt atë e kam më pak mik se të gjithë bashkë, ja po jua them me sinqeritet këtë gjë. Një kafe nuk e kam pirë ende dhe kam zor që nuk kam pirë ende një kafe, jam njohur vetëm me letrat e tij dhe kaq.

Zoti Beqiraj, a keni dijeni që ka një konflikt mes asaj që keni marrë ju dhe asaj që janë të informuar akademikët e nderuar?

Zoti Gjinushi, unë po pyes zotin Beqiraj, ju lutem!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Unë pyes në bazë të kësaj dhe për mua nuk dua të hyj shumë në thellësi, por për mua ka një gjë tinëzare, në sytë e mi.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ja pra, te konflikti që kanë këto dy shkresa. Ne na ka ardhur një shkresë tjetër, akademikëve u ka shkuar shkresë tjetër.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

A mendoni ju që Akademia ka nevojë ndonjëherë që të mos bëjë rokadë, por rotacion, që djemve të rinj t'iu jepet mundësia, që të mos na ikin, se po na ikin djemtë e rinj, dhe unë nuk kam asgjë me zotin Gjinushi, që është njeri i nderuar për mua, shumë i nderuar, por ka edhe momente që ne duhet të mendojmë edhe kështu, patriotikisht, po e them në mënyrë më të thjeshtuar, që të mos bëjmë rokadë, por rotacion, sepse projektligji që propozoni ju na çon te rokada dhe nuk na çon fare te rotacioni. Dhe më vjen keq që një pjesë e institucioneve kulturore janë ende, nuk vë në dyshim moshën se nuk jam diskriminuese, unë e para jam në një moshë të tillë, që dikush tjetër më i ri se unë mund të më thotë “zonjë, më liro vendin”, me të drejtë, kështu që nuk i gjykoj fare njerëzit nga mosha, por unë e di që njerëz të rinj me pretendime, nuk mund të hyjnë në këtë rreth të mbyllur. Po ju them një rast, për shembull, biblioteka...

Mirë se erdhe, zoti ministër!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ende jo.

Nuk kam mbaruar ende unë, po jap shembullin e Bibliotekës Kombëtare, punojnë gati 10-15 djem të talentuar. I drejton një njeri që do të bënte mirë të studionte diku, sepse është studiues; ne kemi nevojë për mendjen e tij, nuk kemi nevojë për shkresat që firmos ai, por është zgjedhje e tij. Në këtë sens e kisha, nuk e kisha për të fyer askënd.

Unë vetë, që siç jua thashë dje në komision, do ta votoja, siç kam votuar çdo gjë për Akademinë e Shkencave, siç kam votuar për Arkivin, siç kam votuar edhe për të tjera institucione të rëndësishme të këtij shteti, që ka nevojë edhe për qasjen tonë, për votën tonë. Do ta votoja edhe këtë, sikur ju ta sillnit në komision me datën 1 dhjetor, që unë të kuptoj që ju e keni për parime, se nuk dua të perceptoj këtë konflikt interesi që keni ju personalisht. Nëse ju do ta sillnit me parime, me datën 1 dhjetor, atëherë unë do t'jua votoja vetë e para.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, sepse e ka lidhur zoti Beqiraj, prandaj, nuk e kam lidhur unë. Ma ka imponuar zoti Beqiraj, ma thotë me të madhe.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti Gjinushi, ju lutem, të mbaroj unë! Zoti Beqiraj ka shkelur çdo procedurë të këtij parlamenti, me miq, se këtu bëhen punët me miq. Grupi Parlamentar i PD-së ka depozituar dy ligje shumë të rëndësishme për këtë shoqëri, e kemi diskutuar edhe këtu, dhe zoti Beqiraj as e ka marrë mundimin, si pjesë e këtij parlamenti, e këtij grupi dhe e këtij komisioni, që t'i vërë në vijë, dhe për ligjin për ju personalisht, ka vrapuar, ka tërhequr njerëz prej xhakete për ta kaluar shumë shpejt dhe Komisioni i Ligjeve ka shkelur radhën.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, e kam me zotin Beqiraj. Ka shkelur çdo rregullore, ka kapërcyer çdo rregull normal...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo ju, Komisioni i Ligjeve, për t'jua bërë juve qokën. Me keqardhje po ju them se ju keni ardhur me qokë, se e keni filluar qokën që ditën kur e keni depozituar.

Tani kam edhe nja dy gjëra të tjera, që kanë lidhje me procedurën.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Merreni si të doni, mund ta merrni edhe si pyetje, se duhet të ktheni një përgjigje. A keni ndërhyrë ju te Komisioni i Ligjeve, se mua më kanë ardhur zonjat e stafit të këtij parlamenti dhe më kanë pyetur: “Zonjë e nderuar, pse po e vononi këtë ligj?”, dhe unë u kam thënë: “Nuk po e vonoj unë, se ligjet kanë radhë. Janë edhe dy ligje të tjera që nuk më kanë ardhur”; më thanë: “Atëherë po shkojmë te Komisioni i Ligjeve”. Merrini tabulatet dhe verifikojeni po të doni. Unë jam ndjerë nën presion për ta përshpejtuar këtë ligj dhe kanë mbetur ligje të tjera, që kanë dështuar edhe për shkak të dobësive tuaja, zoti Beqiraj, se nuk keni dashur t'i kaloni këtu.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, se është anëtar i komisionit dhe është pjesë e punës sime.

Unë ngre shqetësim: përse ju, zoti Beqiraj, keni kapërcyer me ndërhyrjet tuaja politike radhën e ligjeve të këtij komisioni, pra radhën e punës së komisionit?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Është pyetja ime.

Zoti Beqiraj, ju thoni që projektligji juaj përputhet me nenin 58, pika 1, nenin 59, pika 1, shkronja “g”, të Kushtetutës, që ju i dini, por po të doni jua citoj. Unë nuk e kuptoj fare se çfarë lidhjeje ka projektligji juaj me këto dy pika të Kushtetutës. Nuk ka në botë lidhje! Ma shpjegoni ju se çfarë lidhjeje ka.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*



Ja, pra, ju thoni në relacionin tuaj se projektligji që keni propozuar ka lidhje me nenet 58, pika 1, dhe 59, pika 1, shkronja “g”, të Kushtetutës. Unë dua të di: çfarë lidhjeje ka, se unë nuk gjej ndonjë lidhje konkrete?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju e keni në relacionin tuaj, se me relacionin tuaj kam punuar.

Ju thoni, po jua citoj saktësisht: “Përmirësimet ligjore të propozuara kanë të bëjnë me ndërtimin dhe funksionimin e Akademisë së Shkencave në përshtatje me nevojat e zhvillimit të vendit, si dhe nevojën e rritjes së cilësisë, dobisë shoqërore praktike dhe integritetit të kërkimit shkencor”. Pastaj vazhdoni me diçka tjetër: “Ndryshimet e propozuara ndikojnë pozitivisht në aspektin e përmirësimit të funksionimit të institucionit të Akademisë, në mbështetje të rritjes së cilësisë, dobisë shoqërore praktike dhe integritetit të kërkimit shkencor në vend”. Këto më duken slogane kaq të konsumuara dhe janë vetëm për të mbushur faqe, për të na bindur, në fakt...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Për mua ka rëndësi shumë. Zoti Gjinushi, ju jeni i ftuar dhe për mua nuk është e përshtatshme ndërhyrja juaj.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

E kam me zotin Beqiraj, dhe ai mban përgjegjësi në raport me mua, nuk është për ju, unë nuk po ju kritikoj ju. Ju lutem, ndërhyrja juaj më duket e pavend! Nëse ju bezdis retorika ime, mund të largoheni. Unë po i bëj pyetje zotit Beqiraj dhe ai duhet të më kthejë përgjigje. Kaq! Më vjen keq, por është e tepruar, jua them sinqerisht. Ju folët disa herë dhe unë nuk ju ndërhyra fare, megjithëse e keni tepruar në ndonjë rast.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti Beqiraj, e kam me ju.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, edhe atë do ta pyes, se e kam detyrë të jem transparente, sepse nesër apo pasnesër dikush mund të kërkojë komision hetimor, dikush mund ta çojë në Gjykatë Kushtetuese...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nuk e di për çfarë, nuk merrem fare me këtë gjë! Unë po them se duhet të jem transparente, në mënyrë që gjithçka që regjistrohet, të jetë e saktë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Të lutem, tani!

Zoti Beqiraj, ju thoni...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem, mos hyni në gjëra personale!

Ju thoni që projektligji që sillni ka synim unifikimin dhe partneritetin me vendet e BE-së, të rajonit dhe standardet e praktikave më të mira europiane, si dhe parimet e veprimtarisë europiane. Nuk e di: cilit model evropian i jeni referuar ju konkretisht? Dua të di me cilin model funksiononi ju në hartimin e këtij projektligji? Dua të di se cili është modeli i punës suaj.

Pak a shumë këto kisha.

Faleminderit!

Mund të vazhdoni!

Kam edhe shumë të tjera, por dua t'ua lë fjalën kolegëve të tjerë.

**Ismet Beqiraj** – Bëjini, se mos ju mbetet merak ndonjë.

**Flutura Açka** – Zoti Beqiraj, me çfarë jam marrë unë? Lexoni edhe një herë pyetjet e mia, pasi të mbarojë regjistrimi, se nuk kam fyer njeri. Nuk e kam në natyrë të fyej njeri.

Ju lutem, fjala për ju!

**Ismet Beqiraj** – E para, është hera e parë në praktikën e shqyrtimeve...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem!

**Flutura Açka** – Mos i merr pyetjet e mia fare! Vazhdoni, se nuk e kam problem fare!  
Nuk dua përgjigje.

Zonja Zhupa, vazhdoni me pyetjet.

**Ismet Beqiraj** – Do t'i kesh, se unë të dëgjova dhe je e detyruar.

**Flutura Açka** – Nuk dua përgjigje.

**Ismet Beqiraj** – Ju nuk e dini se çfarë do të them.

**Flutura Açka** – Asnjë përgjigje nuk dua nga ju.

**Ismet Beqiraj** – Pse nuk do përgjigje?

**Flutura Açka** – Nuk dua.

**Ismet Beqiraj** – Si të duash, nëse nuk ke bërë pyetje. Por në vend që të merresh me thelbin e gjësë, merresh me pamjen.

**Flutura Açka** – Pyetjet e mia ishin të drejtpërdrejta, nuk kishin asnjë prapavijë, asnjë hile.

**Ismet Beqiraj** – E kanë prapavijën, kur ti arrin dhe më bën...

**Flutura Açka** – Zotëri, pse ky ligj ka ardhur me procedurë të përshpejtuar, kur ligjet për njerëzit që janë në varr nuk kanë ardhur ende këtu dhe askush nuk mban përgjegjësi në këtë parlament?

**Ismet Beqiraj** – Ta them unë.

**Flutura Açka** - Nuk dua përgjigje prej teje.

Zonja Zhupa, keni fjalën.

**Ismet Beqiraj** – Nuk më imponohesh dot, se më ke bërë pyetje dhe unë do të përgjigjem. Të lutem, unë i them për komisionin dhe për procedurë dhe jo për tekat e një individi!

**Flutura Açka** – Nuk dua fare përgjigje.

**Ismet Beqiraj**– Nuk ma heq dot fjalën për përgjigje.

**Flutura Açka** – Nuk do ta prish mbledhjen. I quaj të mirëqena dhe i tërheq pyetjet e mia, meqë ju bezdisën.

Zonja Zhupa, merrni fjalën!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nuk më duhen fare. Unë këto fjalë i kam thënë edhe në Kuvend, ia kam thënë edhe zonjës Kryetare, që nuk është e ndershme që ligje që kanë ardhur një vit më parë, nuk kanë kaluar në komisione; fyhen, poshtërohen dhe turpërohen në komisione bashkë me njerëzit që janë pas atyre ligjeve.

*(Zoti Ismet Beqiraj flet pa mikrofon)*

Zoti Beqiraj, i tërheq pyetjet e mia, nuk më duhen përgjigjet fare!

**Ina Zhupa** – Faleminderit, kryetare!

*(Zoti Ismet Beqiraj flet pa mikrofon)*

**Flutura Açka** – Ju jeni njeri politik, po ashtu edhe zoti Gjinushi. A shikoni konfliktin e interesit? Pyetja është e thjeshtë fare.

Zonja Zhupa, vijoni me pyetjet!

*(Zoti Ismet Beqiraj flet pa mikrofon)*

Ju u bezdisët dhe më fyet, ndaj nuk më duhen fare përgjigjet tuaja, se zëre se i di.

*(Zoti Ismet Beqiraj flet pa mikrofon)*

Zoti Beqiraj, i tërheq pyetjet e mia, se nuk më duhen përgjigjet fare. A e dini pse nuk dua përgjigje prej jush? Sepse përgjigjet m'i ka dhënë zoti Gjinushi gjatë kohës kur unë bëja pyetje, pra i mora përgjigjet, ndaj nuk ka nevojë. Më vjen keq! Nuk u përgjigjet ju, por zoti Gjinushi.

*(Zoti Ismet Beqiraj flet pa mikrofon)*

Madje të fola me shumë respekt. Lexojeni se çfarë kam thënë me gojë! Ju kam respektuar shumë, edhe zotin Gjinushi. Kur të bëhet zbardhja, lexojeni!

*(Zoti Ismet Beqiraj flet pa mikrofon)*

Po, sepse keni përshpejtuar ligjin dhe unë përgjigjet i mora nga zoti Gjinushi.

*(Zoti Ismet Beqiraj flet pa mikrofon)*

Atë e vendos unë, dhe i tërheq pyetjet, se i mora përgjigjet.

Zonja Zhupa, ju lutem!

**Ina Zhupa** – Faleminderit, kryetare!

Nisur nga fakti që gjatë gjithë kohës ju bënit pyetje dhe unë lexoja relacionin, personi që fliste, donte të kthente përgjigje dhe të merrte pjesë ishte zoti Gjinushi, atëherë unë po ia plotësoj dëshirën dhe do t'i bëj pyetjet për zotin Gjinushi, që të mos lodhet duke sugjeruar zotin Beqiraj.

**Flutura Açka** – Zonja Zhupa, vetëm pyetje për projektligjin.

**Ina Zhupa** – Patjetër, vetëm pyetje për projektligjin, se zotin Gjinushin e kemi ftuar edhe herë të tjera për pyetje për veprimtarinë e Akademisë dhe nuk ka ardhur, por kur vjen puna për mandatin e vet, vjen, dhe shyqyr që erdhi! Do t'i bëj pyetje vetëm për projektligjin, nuk do ta pyes për albanologjinë, pavarësisht se zoti Gjinushi foli 7 minuta për albanologjinë dhe tha edhe një herë në këtë komision që po bëjmë këtë e po bëjmë atë, sikur ishte Ministria e Arsimit që do të bënte ligjin dhe VKM-të dhe çfarë thotë Akademia duhet të bëhet, siç tha edhe herën e parë, kur e vendosi ai të mbyllet dhe u mbyll Akademia e Studimeve Albanologjike. Megjithatë, nuk do të dal jashtë teme.

Zoti Gjinushi, si bashkëpunues, a mund të na thoni kur ka nisur ky projektligj i ri me zotin Beqiraj dhe zotin Koçi? Daton nga mbledhja që ju sillni këtu, e datës 08.09.2022, apo më parë?

Zoti Gjinushi, a e keni mbledhur ju asamblenë e Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë për t'i vënë në dispozicion dhe për të diskutuar ndryshimet që lidhen me mandatin e kryesisë dhe tuajin, si dhe ndryshimet që lidhen me moshën mbi 75 vjeç? Apo janë diskutuar vetëm çështje të tjera, që lidhen me diskutimet e datës 08.09.2022?

Në letrën e sjellë dhe të firmosur nga ju, si kryetar, në komision, në datën 7 korrik, thuhet se menjëherë pas ftesës suaj, iu drejtuat tërë anëtarësisë për t'u shprehur në lidhje me ndryshimet dhe ata u shprehën me shkrim. Në këtë kohë të shkurtër, disa nga këta anëtarë që kanë firmosur këtu nuk janë fare në Shqipëri, dhe një pjesë janë “*Emeritus*”, që kanë firmosur dhe e kanë rritur numrin në mënyrë fiktive. A keni bërë ju një diskutim në asamble për këto ndryshime ligjore? Si ka kaluar kjo shkresë? Si janë marrë këto firma në të njëjtën shkresë?

Ju kërkoni që të jeni kryetar edhe pas moshës 75 vjeç. Po 75-vjeçarëve të tjerë akademikë pse u privohet kjo e drejtë? Ju pas moshës 75 vjeç do të jeni akademik “*Emeritus*” apo kryetar i akademisë, apo të dyja bashkë, dhe kur të doni do ta zbatoni ligjin e Akademisë, e kur të mos doni nuk do ta zbatoni? Do të silleni “*Emeritus*”, pra do të vishni një herë pelerinën e kryetarit, kur t'ju dojë qejfi, dhe kur të mos ju dojë, do të vishni pelerinën e “*Emeritus*” dhe do ta zhvishni veten nga disa detyrime?

Zoti Beqiraj, a do të hyjnë në fuqi këto ndryshime tani, apo do të presim zgjedhjet e reja? Pse me kaq urgjencë?

Ju thoni, zoti Gjinushi, se projektligji i sjellë këtu është konsultuar më parë me Akademinë. Në mbledhjen e Akademisë, sipas procesverbalit të datës 08.09.2022, akademiku Apollon Baçe ju ka pyetur...

Në datën kur keni pasur mbledhjen.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Unë e di, se akademiku Apollon Baçe e ka deklaruar publikisht dhe akademiku Artan Fuga e ka thënë dje.

Akademiku Apollon Baçe ju ka pyetur nëse jeni i përfshirë në ndryshimet e ligjit dhe nëse keni dijeni për këto ndryshime. Përgjigjja juaj ka qenë: “Jo, është një iniciativë e deputetëve; nuk kemi asgjë ne, si Akademi”, sepse, sipas rregullores dhe statutit të Akademisë, këto duhet të ishin diskutuar. Nëse do të ishin tuajat, siç e thatë pak më parë, atëherë duhet të ishin diskutuar, jo vetëm firmosur, për të marrë mendimet e akademikëve, siç e kërkon statuti i asamblesë, jo i kryesisë, që në këtë rast duhet sqaruar. A ndieni ju se keni një konflikt interesi, se jeni këtu si kryetar i Akademisë së Shkencave, keni firmosur bashkë me anëtarët e kryesisë dhe prekeni drejtpërdrejt nga ky ligj, nga i cili varet mandati juaj i dytë dhe të qenit kryetar? A jeni në konflikt interesi, se jeni duke dhënë një opinion në emër të Akademisë, kur flitet për mandatin tuaj personal? A do të duhej që, për hir të institucionit, të ishin deleguar minimalisht 2 anëtarë të

tjerë të asamblesë së Akademisë, që nuk kanë konflikt interesi me mandatin dhe të vinin këtu e të shprehnin mendimin në emër të asamblesë? Nuk ka njeri që të mendojë që kryetari i Akademisë, atij që i jepet mundësia, që edhe pse kalon moshën 75 vjeç të mbajë mandatin, të marrë edhe një mandat të dytë dhe të thotë këtu: “Unë nuk jam dakord”, se nuk e lejon logjika. Duke qenë në konflikt interesi, a mendoni se është e papërshtatshme prania juaj sot këtu dhe ky komision nuk duhet t’i marrë parasysh sugjerimet tuaja, për shkak se jeni në situatë të konfliktit të interesit? Jemi duke folur për një ligj që prek drejtpërdrejt interesat tuaja për t’u rizgjedhur për një mandat të dytë edhe pas moshës 75 vjeç. A mendoni se është e ligjshme dhe e moralshme, mbi të gjitha, që ju të firmosni dhe të sillni edhe emrin tuaj 2 herë, një herë këtu si kryetar dhe një herë si anëtar, duke thënë: “Jam dakord të më jepet një mandat i dytë.”? A është kjo përsëri një shkelje dhe një konflikt interesi?

Pashë që janë plot 9 politikanë që kanë firmosur, të cilët janë pjesë e Akademisë së Shkencave. Është edhe një raportim i BIRN-it se si Akademia e Shkencave po zgjerohet me ish-politikanë, të cilët kanë bashkëpunuar me ju në vitet kur keni qenë edhe Kryetar i Kuvendit. Megjithatë, pak rëndësi ka, se për aq kohë sa janë akademikë, i respektojmë si të tillë.

Zoti Gjinushi, duke qenë se ju jeni ithtar i bashkimit me albanologjinë, zotërinjtë që do të vijjnë atje, që do të kenë tituj të ndryshëm nga ju, se do të jenë profesorë, profesorë të asociuar, nuk do të jenë akademikë të asociuar, a do të bëhen një trupë e barabartë me trupën tuaj, apo ata do të jenë vartësit tuaj, meqë kanë tituj më pak se ju? Kjo lidhet me këtë projektligj, dhe dua të di: a do të jenë ata pjesë e trupës zgjedhore për drejtimin e Akademisë së Shkencave? Përderisa ata do të bëhen pjesë e Akademisë së Shkencave, nuk mund të trajtohen si të pabarabartë dhe të mos votojnë për kryetarin e tyre të ardhshëm. Pra, ose do të jenë anëtarë të Akademisë së Shkencave me të gjitha të drejtat dhe detyrimet, ose do të jenë vartësit tuaj dhe nuk do të kenë ato të drejta dhe detyrime që kanë akademikët e tjerë. Këtu kemi edhe një kontradiktë të thellë me atë që pritet të ndodhë dhe që është proklamuar, se pak më parë ju thatë: “Ata do të jenë të barabartë me të gjithë ne dhe nuk do të vihen në lidhje vartësie”, pra poshtë jush apo nën shërbimin tuaj. A duhet që fillimisht të ndodhin ndryshimet ligjore dhe VKM-të, që lidhen me integrimin e kësaj trupe të re të albanologjisë brenda jush dhe më pas të vendosim procedurat e zgjedhjeve të organeve, të cilat mund të zgjerohen, mund të jenë të tjera, mund të shtohen borde, të cilat edhe ato do të kenë nevojë për rregullim ligjor në lidhje me procedurat se si zgjidhen? Pra, pse të bëjmë sot një ndryshim ligjor se si zgjidhet kryetari dhe kryesia, kur ne nesër, për

gjashtë muaj e caktonte VKM-ja, do të kemi një trupë të re që do të integrohet atje, e cila mund të ketë prerogativa të reja edhe ligjore, edhe në VKM për t'u përfshirë në kryesi, për të qenë kryetar, për të qenë pjesë e Asamblesë e të tjera? Pra, pse duhet ta bëjmë ne këtë, kur na presin disa ndryshime shumë më të mëdha në lidhje edhe me difuzionin e albanologjisë brenda jush? A është kjo normale në një logjikë ekonomi kohe, legjislative, por edhe në logjikë të zhvillimeve që do të ndodhin brenda Akademisë së Shkencave? A keni ju si kryetar në detyrë ...

Pavarësisht se, ju njoh apo jo unë, ju jeni kryetar në detyrë dhe paguheni për këtë punë. Kam marrë vesh që merrni vetëm honoraret, jo rrogën, sepse merrni pensionin, por ...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, pensionistët do të jenë të nderuar të drejtojnë derisa të vdesin.

Zoti Gjinushi, meqenëse ju mendoni që një mandat i dytë juaji radhazi do ta fuqizojë Akademinë e Shkencave, a është normale që ju, pa pasur asnjë ekspertizë në pjesën e gjuhësisë, dhe nuk ia keni idenë gjuhësisë, pasi publikisht keni cituar autorë që nuk ekzistojnë, ta vendosni veten në krye të projektit të Fjalorit, duke na vendosur edhe ne në dyshimin e arsyeshëm se çfarë po bëhet me paratë e shqiptarëve, duke u vendosur në krye të këtyre projekteve dhe kërkuar tani edhe një mandat të dytë, që të qëndroni edhe më gjatë, se mos ju cenohet ky pozicion në krye të këtyre tri projekteve të mëdha? Nuk mendoni ju se brenda Akademisë së Shkencave ka njerëz me kompetenca në gjuhësi, të cilët mund të ishin drejtues të këtyre projekteve të mëdha, në këtë rast edhe të Fjalorit? Në këtë mënyrë edhe ndërprerja e mandatit tuaj, nuk do ta cenonte vazhdimësinë normale të këtyre projekteve?!

Pra, pse në relacion e lidhni mbarimin e mandatit tuaj dhe pamundësinë për të zgjedhur një të dytë, siç bëri edhe zoti Beqiraj, me nevojën që këto tri projekte të mëdha të ecin përpara? Ju nuk keni asnjë fushë ekspertize që lidhet me historinë, me gjuhësinë apo me enciklopedinë. Në dijeninë time, ju jeni matematikan. Ashtu siç kanë zbuluar edhe emisionet investigative, nuk ka as edhe një monografi të botuar nga ju, por kjo është çështja juaj dhe e Akademisë. Çfarë humbasim ne nëse vendosen njerëz të përshtatshëm në krye të këtyre projekteve, të vazhdojnë projektet dhe ju të merrni një mandat të dytë, siç e kërkon ligji, jo radhazi, pasi ta gëzojë një nga akademikët e nderuar që do të konkurrojnë dhe do të votohet nga asambleja?

Për ta mbyllur, zoti Gjinushi, në disa intervista televizive ju keni thënë se nuk e keni ndarë mendjen për një mandat të dytë. Për aq kohë sa nuk e keni ndarë mendjen për mandat të

dytë, nuk mendoj se shqyrtimi i ligjit duhet të bëhet me shpejtësi, sepse zgjedhjet janë shpejt, shikojmë kush do të zgjidhet kryetar dhe, më pas, të vazhdojmë me procedurën legislative.

Shumë faleminderit!

**Flutura Aça** - Shumë faleminderit, zonja Zhupa!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Skënder Gjinushi** – Do të përpiqem.

**Flutura Aça** - Zonja Zhupa, për zotin Gjinushi i kishit pyetjet?

Fjala për ju, zoti Gjinushi.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Do të flisni ju përpara zotit Gjinushi?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti Gjinushi, a mund të mbarojë zoti Beqiraj dhe pastaj vazhdoni ju?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Patjetër.

Fjala për zotin Beqiraj.

**Ismet Beqiraj** – Ina, ...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Më fal! Ke të drejtë.

Zonja Ina!

E nderuar kolege!

Më bëtë një pyetje tek e cila nuk më vinte mendja kurrë: “projektligji do të hyjë në fuqi tani apo pas zgjedhjeve?”.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Unë do ta quaja pyetje retorike ose provokuese.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Të lutem! Çdo ndryshim ligjor hyn në fuqi sipas procedurave që parashikohen, që ka ligji, të cilat janë standarde për të gjitha ligjet, nuk janë vetëm për këtë, dhe mos kërko të të kthej unë përgjigje, duke thënë as për 1 ditë, as për 100 ditë, as për 365 ditë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Më fal! Për këtë gjë është një nen në fund të projektligjit, që do ta miratojë komisioni.

Kaq!



*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Flutura Aça** - Zoti Beqiraj, mbylleni pak mikrofonin!

**Ina Zhupa** - Ju lutem, nuk ishte pyetje retorike. Ka ndodhur dhe ndodh që vihet një dispozitë tranzitore, ku shkruhet që hyrja në fuqi do të jetë pas 6 muajve, 3 muajve apo pas...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Pra, ju mund të thoni që do të hyjë menjëherë, por jo të më thoni se është retorike dhe nuk ekziston, sepse nuk është pyetje retorike, por ekziston dhe është praktikë parlamentare.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti Beqiraj, në qoftë se ju më mbështesni, ne e votojmë bashkërisht me dispozitë tranzitore që hyn në fuqi pas 6 muajve dhe e zgjidhim këtë çështje.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Skënder Gjinushi** – Së pari, për kompetencën sa e njohin gjuhën, nuk ka rëndësi sa e njeh, por si e përdor, veçanërisht për anën etike, dhe ta përdorësh atë duke e ditur mirë çfarë vendi zë dhe me kë ke të bësh. Për sa i përket aludimit që bëtë për botimet, ndonëse nuk e kam thënë ndonjëherë, po e them sot: nuk e ndjej veten inferior ndaj kurrkujt, qoftë anëtar Akademie, qoftë çfarëdo, për veprimtarinë si matematikan, i krahasuar me të gjitha standardet. Jo vetëm që nuk mund të japësh mend ti, por as ata që mund të ...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Meqë je një.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Për hir të moshës lejohet.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po mirë, ju atëherë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

E thashë për ta evituar, se duke përdorur përemrin “ju” mund të nënkuptonte “të gjithë”.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Pak vështirë e kam.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

A ka mundësi tani, se nuk të ndërpreva?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Flisni për konflikt interesi, duke u nisur se vjen nga politika. Po veten dikush a e pyet mos ka konflikt interesi, meqë kemi qenë kundërshtarë politikë? Pra, që të gjithë jemi në konflikt interesi, nëse marrim për bazë marrëdhëniet e kaluara politike.

E treta, ...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

A ka mundësi?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zonja kryetare, a ka mundësi?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Flutura Aça** - Ju lutem, zonja Zhupa!

**Skënder Gjinushi** – Zonjë, nuk ka lidhje me ty.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Flutura Aça** - Nëse ka qenë e paqartë, duhet ta përsërisni pyetjen.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Skënder Gjinushi** - Zonjë, u tha nga kryetarja. A ka mundësi, zonja kryetare?

**Flutura Aça** - Një sekondë! Vetëm një ndërhyrje të vogël kam.

**Skënder Gjinushi** - Nëse këtu komandon një njeri, vazhdoni.

**Flutura Aça** - Zoti Opre, dëshironi të largoheni? Mos u vini në siklet, sepse neve na duhen letrat me shkrim.

**Skënder Gjinushi** - Është e drejta ime, se u tha gjatë gjithë kohës ...

**Flutura Aça** - Duhet t'ju vijë ose ju ka ardhur shkresa dhe neve na duhet përgjigje me shkrim.

Faleminderit!

**Skënder Gjinushi** – Zonja kryetare, a ka mundësi?

E dyta, për sa i përket konfliktit të interesit, vetëm një deputet nuk mund të thotë: “a duhet të shprehesh edhe ti për të, nëse je pjesë e një organi”, se deputeti është gjatë gjithë ditës në konflikt interesi, sepse ligjet prekin të drejtat e të gjithë qytetarëve dhe Kryetari i Kuvendit, nuk duhet të firmosë kur dërgon ligjet për dekretim, sepse është në konflikt interesi, duke qenë se mund të ketë votuar për ligjin. Pra, organet kolegjiale nuk kanë konflikt interesi, kur titullari i institucionit përfaqëson dhe përcjell mendimin e institucionit. Bile, është i detyruar ta bëjë një gjë të tillë.

Kryetari i Akademisë nuk është kryetar apo drejtues projektsh. Nuk ka asnjë lidhje. Është një konfondim i qëllimshëm që bëhet, sigurisht ndoshta edhe nga padija, mosnjohja, por Akademia e Shkencave ka një sërë projektsh që tashmë janë në zgjerim, nesër do të ketë institutet, madje, Kryetari i Akademisë nuk është as kryetar dhe as drejtues instituti. Prandaj, nuk mund të konfondohen dhe ngatërrohen asambleja me trupën e profesorëve të instituteve. Institutet do të kenë këshillat e tyre shkencore, siç i kanë, do të kenë bordet e tyre, do të kenë profesoratin e tyre dhe ata marrin vendime për veprimtarinë e vet, kurse Asambleja është institucion i njohur nga ligji dhe ligji nuk lejon që të luajnë rolin e anëtarëve të Asamblesë punonjësit e institutit, qofshin kërkimor, qofshin profesorë e të tjera. E marrin këtë të drejtë, vetëm në qoftë se zgjidhen anëtarë.

Kështu që, për sa u takon pranimeve të reja, nuk e di kush e ka bërë investigimin, por në Akademinë e Shkencave nuk është bërë kurrë ndonjë përzgjedhje mbi baza politike. Po, ndoshta është bërë një në vitet 2007-2008. Forma ka qenë politike, sepse u ngrit komision qeveritar dhe jo asambleja për përzgjedhjen e anëtarëve të rinj. Që të jeni të qetë, shumica dërrmuese e anëtarëve ekzistues janë zgjedhur përpara reformës, vetëm 16 persona janë anëtarë të rinj.

Midis tyre ka nga të gjithë krahët politikë, por asnjëri nuk është kundërshtuar dhe konkurruar për aftësitë e tij profesionale. Pra, nuk do të përmend emra, por këdo të marrësh nga ata, nuk ka një të dytë që të pretendojë që u zgjodh ky, ndonëse unë jam më i zoti apo ndonjë tjetër. Gara ka qenë e lirë, procesi zgjat mbi 6 muaj dhe shprehen edhe senatet. Të gjithë senatet e universiteteve janë shprehur unanim, madje edhe kanë përgëzuar për çdo pranim të ri që ka bërë Akademia e Shkencave.

Bashkëpunimi me relatorin, deputet Ismetin dhe zotin Petro, ka nisur që kur u bë projektligji herën e parë, sepse ligji bazë është bërë përsëri me iniciativë deputetësh. Ky ka qenë një tolerim i qeverisë, e cila pranoi ta heqë kontrollin në kuptimin e drejtpërdrejtë dhe nisma kaloi në nivel Kuvendi. Deputeti ka qenë relator dhe është e qartë që Akademia duhej t'i drejtohej së pari atij, kur ndjeu nevojën për disa përmirësime. Edhe institucionalisht, por dhe me kryetarin e grupit është diskutuar për nevojën e disa ndryshimeve.

Kemi thënë, në atë që citohet këtu, që nuk është formulimi ynë, të cilin ne nuk e ndryshojmë, që arsyeja e parë për të cilën u ndërmor ky ndryshim ishte hapja, ajo që ka lidhje me anëtarët e jashtëm dhe të nderit, dhe, e dyta, ka qenë një konfondim që krijohet midis termave “të jashtëm” dhe “korrespondent”, që është pak e lodhshme nëse do ta shpjegoj këtu, sepse përpara

ligjit kishim edhe anëtarë akademie, që punojnë jashtë, por që zgjidheshin të rregullt. Tani nuk mund të zgjidhesh anëtar asambleje i rregullt, nëse punon jashtë. Atëherë, u detyruam të fusim statusin e korrespondentit, mirëpo kjo vetëm na ngatërron, sepse krijon një ngarkesë të madhe me gjithë këto statuse. Kështu që, kjo ka qenë arsyeja.

“Neni më i debatueshëm” absolutisht kishte nevojën e riformulimit. Ky nen është mbartur nga ligji i mëparshëm. Që të vërtetoni se nuk është formulimi ynë, aty ka një paragraf të dytë, ku thuhet se kryetari zgjidhet me votë të fshehtë me shumicën e të gjithë anëtarëve, kurse në raundin e dytë zgjidhet me të gjithë të pranishmit. Pra, kundërshton zgjedhjen absolute. Ky nuk është formulimi ynë. Për arsye teknike, ky nen doli i tillë, sepse u mbart nga ligji i mëparshëm. Ju e dini që në ligj ndërhyhet deri në çastet e fundit për rregullime të këtij karakteri.

Kështu që, ky ndryshim duhej. Këtë ne e kemi lënë të lirë në kuptimin që nuk diktonim se si do ta riformulonin dy deputetët nismëtarë. Në këtë aspekt, nisma është e tyrja.

A është vënë në dijeni asambleja? Absolutisht po, sepse ky është vendimi i asamblesë. Unë nuk e kuptoj si mund të pyesësh nëse është pyetur asambleja, ndërkohë që ky është vendimi i asamblesë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po. U pyet një herë. The më përpara. Pra, vendimi është i asamblesë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

A ka mundësi?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zonjë, asambleja ka miratuar projektligjin.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ja ku e ke.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Dëgjoje, se nuk do ta kuptosh përsëri.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Projektligji thotë: “Nëse ka ndonjë ndryshim esencial ...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

A ka mundësi? Pra, ai që ka kaluar në asamble ...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Dëgjo këtu, se nuk të sqarojnë dot ata që janë vetë të paqartë.

Pra, këtu asambleja thotë:

1. Hiqet numri për të jashtëm dhe të nderit.
2. Riformulohet neni 11, pikat 9 dhe 10.

Nuk është riformulimi, sepse është lënë në zgjedhjet për riformulimin.

Riformulimi është bërë dhe kemi rënë dakord dhe është normale që në riformulim do të hiqej togfjalëshi pa sens “jo radhazi”.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Pa sens është.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Për ty duhet të jetë më shumë, sepse nëse i trembesh se me dy mandate radhazi shkon deri në moshën 80 vjeç, me jo radhazi shkon deri në moshën 89 vjeç ose 85.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po the që ka të drejtë të rizgjidhet, ai përjashtohet nga përjashtimi.

Duhet të mësosh një gjë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

A ka mundësi?

**Flutura Açka** - Zonja Zhupa, lejoje zotin Gjinushi të mbarojë fjalën e tij!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Skënder Gjinushi** - A ka mundësi?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Flutura Açka** - Zonja Zhupa, ju lutem, lejoje zotin Gjinushi të mbarojë!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Skënder Gjinushi** – E para, ajo është mënyrë zgjedhjeje. Ne e propozojmë dhe të gjithë e mbështesim për mandatet duke hequr shprehjen “jo radhazi”.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Një minutë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, nuk janë bashkë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ti e bërë paketë, sepse ti thua që pas 6 muajve e votoj dhe ikën e gjithë kontradikta që ka ligji.

**Flutura Aça** - E thashë unë, zoti Gjinushi. Në përgjigjen tuaj ishin disa ironi që kishin lidhje me mua, por nuk ka problem. Unë nuk shqetësohem, sepse i kam mbaruar në letërsi ironitë.

**Skënder Gjinushi** - E tha kjo, ndaj mos e mbro.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

A ka mundësi të ...?

E para, është e drejta e gjithkujt të propozojë? E dyta, themi se është absurde, sepse nuk ka asnjë ligj të dytë që thotë “jo radhazi”, pra lejon dy mandate, por jo radhazi.

Është ajo që tha edhe zoti Ndreca.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Është i mbartur nga ligji i vjetër dhe u bë pikërisht nga presioni politik i asaj kohe.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zonjë, nuk do të thotë gjë. Po themi që është e mbartur nga ligji i vjetër.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zonjë, ne nuk kemi bionde në Akademi.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

A ta mbaroj?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zonja kryetare, a mund ta mbaroj?

**Flutura Aça** – Zonja Zhupa, ju lutem ta mbarojë zoti Gjinushi dhe pastaj mund të bëni tjetër pyetje nëse keni.

**Skënder Gjinushi** – Kjo është praktikë e të gjithëve. Amendamentet bëhen pikërisht për të bërë korrigjime.

Nuk është me emër, sepse u tha disa herë dhe e thoni disa herë, jo për një, jo për dy. Heqja e pengesës është për të gjithë, sepse 75, 74 apo 73 vjeç do të mbushin të gjithë. Sot janë 20 akademikë që përfitojnë nga kjo e drejtë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Se duam ne.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo disa, por gjithkush...

Zonjë, kriteret ligjore janë njëloj.

**Flutura Aça** – Lejojeni të mbarojë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Skënder Gjinushi** - Zonjë, a ka mundësi?

**Flutura Aça** - Ju lutem, zonja Zhupa!

Konkludoni, zoti Gjinushi!

**Skënder Gjinushi** - Mbi moshën 75 vjeç është vënë pikërisht për të hapur vendet. Pra, është një tolerancë edhe e politikës, që vërtet ka një numër 10 me 30, por mbi 75 vjeç nuk futen te ky numër, pra për t'i dhënë frymëmarrje një rinovimi të Akademisë, duke u hapur rrugën brezave të rinj e të tjera.

I vetmi kufizim është për mospjesëmarrje, nëse nuk marrin pjesë dhe nuk ndikojnë në kuorum. Ju e dini si vuani për të krijuar kuorumin dhe kuptohet se...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Një minutë!

Mëso një gjë tjetër, sepse je deputete: kur ka një normë në ligj dhe ka një përjashtuese të veçantë, vepron e veçanta. Kur thuhet se do të zgjidhet kryetari dhe çfarë detyrash ka, ai i ushtron ato, nuk e përjashton dot ky neni i përgjithshëm.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo ndryshe, por kushdo të jetë.

Kushdo të jetë, sepse akademitë e tjera nuk kanë kufizim moshe.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

E para, nuk kanë kufizim.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zonjë, një minutë!

Për kufizimin thuhet se 75 vjeç e lart nuk mund të kandidosh. Pse t'i heqin edhe nën 75 vjeç? Se do ti?

**Ina Zhupa** – Zoti Gjinushi, përderisa në moshën 75 vjeç e lart nuk kandidon, pse 75 vjeç e lart je kryetar?

**Skënder Gjinushi** – Po, sepse kandidon 72 vjeç dhe e mbyll 76 vjeç. Nuk ia pret që në moshën 72 vjeç. Kjo është.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Dëgjo! Pse të është tiposur ty një individ...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ku është ligji?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

A thatë se nuk merren?!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

E keni përpara mendimin e akademikëve, shkresën e firmosur. Nuk thuhet në një pikë, thuhet në të tria pikat, sepse...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zonjë, më dëgjoni!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

A ka mundësi?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Kërkuat të vinte e gjithë Asambleja.

Nëse do të vinte e gjithë Asambleja dhe nëse do të vepronte si një nga anëtarët, ju nuk do të mbaroni për shekuj. E kuptoni?

**Flutura Aça** – Zoti Gjinushi, mund të bëj një ndërhyrje?

**Skënder Gjinushi** – Absolutisht nuk mund të...

**Flutura Aça** – Zoti Gjinushi, mund të bëj një ndërhyrje, meqenëse po flisje për asamblenë?

**Skënder Gjinushi** – Po.

**Flutura Aça** – Përpara se të bëhej raportimi juaj për vitin 2022, unë zhvillova takime me disa akademikë, të cilën më shprehën shqetësime për Akademinë.

**Skënder Gjinushi** – Akademikët?

**Flutura Aça** – Unë shpresova që ata njerëz do t'i ngrinin shqetësimet në mbledhje, por nuk i ngritën.

**Skënder Gjinushi** – Kush ishin ata?

**Flutura Aça** – Është konfidenciale.

**Gjinushi** – Akademikët që ishin këtu?

**Flutura Aça** – Po, akademikët.

**Skënder Gjinushi** – Çfarë shqetësimesh?



**Flutura Aça** – Shqetësimet e tyre për Akademinë, për mbarëvajtjen, për çështje detyrash.

**Skënder Gjinushi** – Kush janë?

**Flutura Aça** – Ju lutem!

**Skënder Gjinushi** – Ishin këtu?

**Flutura Aça** – Ndaj unë i vë në dyshim firmat.

**Skënder Gjinushi** – Kush?

**Flutura Aça** - A janë informuar siç duhet?

**Skënder Gjinushi** – Atëherë...

**Flutura Aça** – Flas për çështjen e firmave.

**Skënder Gjinushi** – Atëherë, ja ku e keni vërtetimin që janë informuar siç duhet! Keni edhe mendimin e Apollon Baçes, i cili ka abstenuar. Ju e dini shumë mirë që ishte i mirinformuar dhe bëhet fjalë për mandatet, e ka marrë vesh edhe i gjithë opinionioni publik, por abstenoj dhe tha: “U shpreha një herë për “jo” dhe tani do të abstenoj”. Ai është shprehur ndër të fundit, për arsye kontaktesh, ndërsa të gjithë të tjerët, në mënyrë absolute... Ndaj fleta shoqëruese është me përgjegjësi të plotë për të tria pikat: hapjen e Akademisë, çështjen e mandateve dhe mbartjen e fondeve. Tri gjëra janë. Ju e dini shumë mirë që ligjet, së pari, pranohen në parim dhe të tjerat mbeten në përgjegjësinë e deputetëve. Këtu thuhet: “Pajtohem plotësisht me të dhe e gjejmë në përputhje në parim”. Më thoni se cili parim nga varianti i parë është cenuar në variantin e dytë, të cilin e keni përpara? Asnjë parim. Është shtuar vetëm mbartja e fondeve.

E njëjta gjë është edhe për mandatet, edhe për hapjen e numrave.

Çfarë mashtrimi u është bërë akademikëve këtu?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, e them unë.

Në të kundërt, nëse nuk do të jenë të qartë për çfarë kanë firmosur, është një formë mashtrimi.

Këto praktika...

**Flutura Aça** – Zoti Gjinushi, ky është interpretimi juaj. Unë thashë faktin, u mora me analizën e faktit.

**Skënder Gjinushi** – Ky është fakti.

**Flutura Aça** – Interpretimi është juaji. Unë nuk interpretova asgjë.

**Skënder Gjinushi** – Jo, tani...

**Flutura Aça** – Unë ju thashë se përse ka përplasje.

**Skënder Gjinushi** – Ju bëra sqarimin.

**Flutura Aça** – Ju thoni se është manipulim.

**Skënder Gjinushi** – Përderisa vihet në dyshim, po e sqaroj. Ja ku janë të gjitha. Ju e dini shumë mirë që janë njerëz me integritet, me personalitet, me kapacitet intelektual për të kuptuar jo vetëm këtë projektligj. Nëse doni dhe korrespondencën, keni shqetësuar edhe zotin Kadare. Doni ta merrni edhe tekstin se çfarë i është thënë, se cilat janë ndryshimet? I kemi thënë: “Këto janë ndryshimet. A je dakord me secilin prej tyre”? Përgjigjja ka qenë: “Jam për të tria”.

**Flutura Aça** – Një shprehje norvegjeze, zoti Gjinushi, thotë: “*It matters seeing in the middle of his back*”.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Skënder Gjinushi** – E vërteta është që nuk bëhet debat pa i lexuar gjërat siç janë.

Anëtarët “Emeritus” janë anëtarë asambleje gjithë ditën e gjithë natën.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, sepse qejfi është për të ardhur në mbledhje. Kur nuk vjen, nuk cenon kuorumin, është shumë e thjeshtë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Dakord, por kanë rastisur që janë me më shumë qejf dhe me më shumë përgjegjësi se disa...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Edhe këtu, edhe te ne, por sidomos këtu.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Qejfi dhe përgjegjësia nuk lidhen me moshën. Përkundrazi, sidomos përgjegjësia vjen gjithmonë duke u rritur.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Edhe qejfi, por kur ke mundësi. Nëse rinia do të mundte, edhe pleqëria...

**Flutura Aça** – Ju lutem, të mos e ulim gradacionin e mençurisë këtu, sepse ju ndikon në gradacione të tjera!

Kush ka pyetje?

Po, zonja Zhupa.

**Ina Zhupa** – Zoti Gjinushi, nuk iu përgjigjët pyetjeve të mia.

**Skënder Gjinushi** – Unë?!

**Ina Zhupa** – Ju pyeta gjerë e gjatë për modalitetet e zgjedhjes së kryetarit nga shkrirja e Albanologjisë, për kompetencat. Si do të ndërhyjnë? A do të votohen? A do të jenë pjesë e trupës që zgjedh kryetarin e Akademisë apo nuk do të jenë pjesë e Akademisë së Shkencave dhe kemi thënë kot se janë pjesë?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem, mund të më ktheni përgjigje, që ta dinë edhe anëtarët me çfarë statusi do të vijnë, sepse ata kanë grada të tjera?

**Skënder Gjinushi** – Ata do të jenë më autonomë. Institutet pranë Akademisë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nuk ka se si të jenë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ata do të zgjedhin drejtuesit e vet.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zonjë, kryetari i Akademisë nuk është drejtues i instituteve. E vetmja gjë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, grupi i instituteve vetëqeveriset.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, por nuk i komandon Asambleja.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ti do që t'i urdhërojmë ne?

**Ina Zhupa** – Jo, unë dua të jenë trupë e barabartë...

**Skënder Gjinushi** – Si “e barabartë”? Anëtarë asambleje? Si bëhen anëtarë?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Siç kanë bërë? !

Ju harroni se Akademia e Shkencave është krijuar si bashkim institutesh në vitin '72. U bashkuan 15 institute. Po të pyesësh këdo nga ish-anëtarët, edhe ata që janë atje, se çfarë varësie kishin nga Akademia, do të thonë: “Ne ishim vetë Akademia”, sepse ajo është trupa kryesore aktive. Ata paguhen për kërkimin, kanë këshillin e vet, kanë senat e të tjera. Për koordinimin e buxhetit qendror apo kur miratohet plani vjetor, në analiza vjetore do të jemi bashkë, siç i ftojme

edhe tani. Kaq. Për projekte të mëdha do të koordinohet shumë më lehtë sesa kur ishim veç e veç. Kaq është ndryshimi.

**Flutura Aça** – Faleminderit, zoti Gjinushi!

Po, zonja Zhupa.

**Ina Zhupa** – Nuk kam pyetje për zotin Gjinushi, por thjesht për rekord dua të them se e dëgjuat, besoj, që Albanologjinë do ta ulin në nivel instituti.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Besoj se e dëgjuat që, për pjesën e konfliktit të interesit, unë nuk e pyeta: “A ke konflikt interesi, sepse ke qenë ish-Kryetar i Kuvendit”, por e pyeta: “A ke konflikt interesi, sepse flitet për mandatin tënd të dytë?”. Nuk na tha nëse do të konkurrojë për një mandat tjetër të dytë, siç unë e pyeta, nuk na tha se si do të cenohej vijueshmëria e tri projekteve të mëdha, nëse mandatet nuk do të ishin radhazi, por përkundrazi, na tha se nuk ka lidhje me projektet, kështu që mund të mos bëhen radhazi, pasi nuk u cenuaka vijueshmëria e projekteve të mëdha, mund ta drejtojë një tjetër me shumë sukses.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Për ta mbyllur, nuk na ktheu përgjigje: a po bëhet ky ligj me porosi posaçërisht për zotin Gjinushi dhe çfarë kontributesh të jashtëzakonshme mund të na japë një 78-vjeçar?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Unë nuk i dua më këto përgjigje.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

E kishe rastin...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Patjetër, sepse ju e kishit rastin për t’u kthyer përgjigje pyetjeve.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Unë nuk ju interpretova ju, por thashë se pyetjet e mia nuk morën përgjigje. Në respekt të kohës së kolegëve, unë nuk i dua më përgjigjet.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju e kishit kohën tuaj për të dhënë përgjigje, por nuk i dhatë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Në fund, çdo njeri e di se ky është një ligj për Skënder Gjinushin, meqë mbush moshën 75 vjeç në mandatin e dytë.

**Flutura Aça** – Zonja Zhupa, të konkludojmë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ina Zhupa** – Kundërshtimi im...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Flutura Aça** – Zoti Gjinushi, mos flisni pa mikrofon, sepse nuk regjistroheni!

**Ina Zhupa** – Është e kundërligjshme...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Flutura Aça** – Zoti Gjinushi, po flisni pa mikrofon.

**Ina Zhupa** -...të trajtoheni ndryshe nga 75-vjeçarët e tjerë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Flutura Aça** – Zoti Gjinushi, ju lutem!

Zonja Zhupa, konkludoni!

**Ina Zhupa** – Fakti që një zotëri mbajti një parti për 30 vjet, tani do të mbajë 30 vjet Akademinë e Shkencave, tregon edhe një herë për demokratizimin në këtë vend.

Faleminderit!

**Flutura Aça** – Faleminderit!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem, zoti Gjinushi!

*(Diskutime pa mikrofon)*

A ka pyetje të tjera nga kolegët?

**Skënder Gjinushi** – Tani keni kryetar, por nuk keni parti. Jeni bërë bashkësi kryetarësh dhe...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Flutura Aça** – Ju lutem, zoti Gjinushi!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Skënder Gjinushi** – Ti nuk mund të bësh konkluzione.

**Flutura Aça** – Ju lutem!

**Skënder Gjinushi** – Jo, ju lutem!

Ka replikë mbi replikë. Nëse dikush...

**Flutura Aça** – Ju fyet disa herë.

**Skënder Gjinushi** – Foli me emra. Ajo nuk mund të bëjë konkluzione, sepse...

**Flutura Aça** – “Intelekti”, “kjo”, “ajo”, nuk shkon.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Skënder Gjinushi** – E ka në natyrë që deformon çdo gjë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Flutura Aça** – Zoti Gjinushi, a mund të vazhdoj unë?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem, zonja Zhupa, të vazhdoj unë!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zonja Zhupa, të konkludojmë.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Ju lutem, a mund të vazhdoj unë?

*(Diskutime pa mikrofon)*

Zonja Zhupa, ju lutem, lërimi debatet personale!

*(Diskutime pa mikrofon)*

Zoti Gjinushi, ju lutem, sepse nuk shkon kështu!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nuk është.

Ju lutem!

*(Diskutime pa mikrofon)*

Zoti Gjinushi, pas kësaj fjale, duhet të dilni jashtë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju duhet të dilni jashtë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo.

Ju përdorët një fjalë të papranueshme nga unë në të gjitha pikëpamjet.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem!

Ta mbyllim këtu!

Ju përdorët një fjalë të papranueshme nga unë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju ndoshta jeni mësuar të përdorni të tillë fjalor mes burrash, por në këtë komision, sa të kem unë frymë, nuk mund të përdoren fjalët që keni përdorur ju sot. Ju përdorët një fjalë, që menduat se unë nuk e kam dëgjuar, por e dëgjova. Përsëriteni me mikrofon hapur, që të regjistrohet!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Përsëriteni, zoti Gjinushi, me mikrofon të hapur fjalën që sapo thatë tani!

**Petro Koçi** – Ti do të administrosh mbledhjen...

**Flutura Açka** - Zoti Koçi, ju lutem!

**Petro Koçi** – Sa është ora?

**Flutura Açka** – Hapeni mikrofonin dhe thoni fjalën që thatë më parë!

**Petro Koçi** – Çfarë ke bërë deri tani?

**Flutura Açka** – Ju lutem!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Fjala që thatë ju është e papranueshme, e pahijshme për këtë komision.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Megjithatë, është fjala juaj. Përgjegjësia është personale.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Më keni shqetësuar shumë me këtë. E prishët shumë keq këtë komision. Ndoshta jeni mësuar të thoni çfarë ju pëlqen të thoni në tavolina me burra, duke pirë raki, por në këtë komision ka një etikë dhe ju e shkelët etikën, zoti Gjinushi.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Për respektin personal që kam ndaj jush, nëse keni kurajën ta thoni me mikrofon hapur, thojeni.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Fjalën që sapo përmendët.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Në të kundërt, mos flisni më që nga ky moment!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem, pushoni së foluri që nga ky moment!

Zoti Opre, sot jeni i pafuar nga ky komision, keni ardhur vetë. Nuk e di kush ju ka ftuar. Keni hyrë edhe në listën e rendit të ditës. Ju duhet të prisni shkresën që duhet të jetë nisur. Nëse

stafi nuk e ka nisur, ka bërë shumë gabim. Duhet të sillni përgjigje brenda rregullave të këtij parlamenti dhe të këtij shteti.

Zoti Gjinushi, ju jeni ftuar personalisht...

**Petro Koçi** – Ky është vazhdim i mbledhjes së djeshme.

**Flutura Açka** – Faleminderit për respektin!

Shpresoj të shihemi sërish bashkë!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem, zoti Beqiraj!

Pas fjalës që dëgjova, nuk kam dëshirë për asnjë koment.

Zoti Ndreca, ju lutem!

**Eduard Ndreca** – Kryetare, ne kemi kaq orë në mbledhje dhe pjesa më e madhe është debat jashtë çështjes së rendit të ditës. Ne mund të kemi shumë arsye për të pyetur...

**Flutura Açka** – Kur të zbardhet, nënvizoni me vija të kuqe çfarë është jashtë rendit dhe unë do të kërkoj...

**Eduard Ndreca** – Patjetër që ka shumë. Edhe debate personale ka.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem!

Për orë të tëra këtu po bëhen debate...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nuk e kam me ju. Unë po flas për procedurë.

**Flutura Açka** – Ju lutem, vazhdoni!

**Eduard Ndreca** – Ne i kemi shteruar të gjitha pyetjet, përgjigjet dhe kërkesat. A mund të kalojmë në votimin e projektligjit, sepse është vonë?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Flutura Açka** – Zonja Zhupa, nuk e vendosni ju këtë gjë.

**Eduard Ndreca** – Të kalojmë në votim.

Tjetra: çdo nismë duhet të kalojë në votim në këtë komision. E votojmë apo jo, do të biem dakord me komisionin.

Unë propozoj të kalojmë në votim, sepse kemi shumë orë...

**Flutura Açka** – Nëse doni të shkelni ligjin, vazhdoni programin tuaj.

**Eduard Ndreca** – Ne kemi orë të tëra në këtë sallë.



**Flutura Aça** – Ky është problemi.

**Eduard Ndreca** – Zonja kryetare, në këtë shkresë, të bërë nga kryesia e komisionit, është i ftuar zoti Gentian Opre.

**Flutura Aça** – Unë nuk kam dijeni. E kam parë zotin Opre në komision bashkë me ju.

**Eduard Ndreca** – Mos na vër faj neve apo zotit Opre.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ne kemi bërë debat...

**Flutura Aça** – Po bën avokatin e zotit Opre?

**Eduard Ndreca** – Jo, nuk po e bëj. Kemi një shkresë të komisionit tonë. Ne biem në kundërshtim me veten.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zonja kryetare, kemi një njoftim të komisionit.

**Flutura Aça** – Zoti Ndreca, megjithëse jam kryetare, ndonjëherë në këtë komision nuk më pyesin, sepse ka fuqi më të mëdha fuqia e kartonëve dhe e politikës suaj. Ky është problemi dhe shqetësimi im. Pse ndodhin këto gjëra pa qenë në dijeni kryetarja e komisionit?

**Eduard Ndreca** – Përtej kësaj që thatë, ju jeni kryetare e komisionit. Ushtrojeni detyrën tuaj!

**Flutura Aça** – Kryetarja nuk ka fare dijeni.

**Eduard Ndreca** – Ushtrojeni detyrën me tagrin e plotë, siç ju takon!

**Flutura Aça** – Unë e kam parë zotin Opre kur e keni parë edhe ju. Nuk e di kush e ka ftuar.

**Eduard Ndreca** – Unë, si anëtar i këtij komisioni, kam këtë shkresë. Më pas...

**Flutura Aça** – Faleminderit!

Zoti Gjinushi, ju falënderoj!

Zoti Sinani dhe zoti Tole, ju falënderoj!

**Eduard Ndreca** – Kryetare, nuk e mbarova fjalën.

**Flutura Aça** – E kisha për zotërinjtë e ftuar.

Mund të vazhdoni, zoti Ndreca.

**Eduard Ndreca** – Si përfundim, mund të kalojmë në votimin e këtij projektligji, që ta mbyllim? Kemi ardhur në orën 10:00 dhe...

**Flutura Aça** – Zoti Ndreca, pavarësisht respektit që kam për secilin prej jush ju e dini dhe nuk kam pse t’ju them tani, pasi duket sikur e teproj po të bëj retorikë, për të dy iniciatorët, për zotin Beqiraj në veçanti, sepse për zotin Koçi, e përsëris, unë votoj me sy mbyllur çfarëdo të sjellë, pasi kam bindjen që asnjëherë nuk i hyn në hak askujt në këtë parlament, jam e detyruar të mos e kaloj sot në votim për arsyet të cilat i kam shpjeguar në fillim, që duhet t’i zgjidhim bashkërisht. Shkresa nuk ka ardhur. Neni nr. 6, që pretendon zoti Beqiraj, nuk mund të kalojë pa shkresën e Këshillit të Ministrave. Mos më shtyni të bëjmë shkelje. Do ta votojmë kur të dëshironi ju. Të vijë shkresa, do të mblidhemi sërish, do t’i kalojmë nen për nen dhe në tërësi, si të dëshironi ju, por mos më shtyni të bëj shkelje. Në të kundërt, më thoni të iki dhe ju mund të vazhdoni të votoni si të dëshironi. Unë nuk mund të përfshihem në një shkelje të kësaj natyre. Ju lutem! Është e shkruar e zeza mbi të bardhë.

Zoti Beqiraj, më vjen keq, por nuk është në dorën time. Nuk është faji im.

**Ismet Beqiraj** – Për procedurë.

**Flutura Aça** – Urdhëroni!

**Ismet Beqiraj** – Që në fillim, pa nisur me pyetjet, zoti Koçi e shprehu mendimin, duke thënë se ne si nismëtarë tërhiqemi nga pika 6, që ka të bëjë me pagat. Ju lutem, kur të shkojmë te neni 6, një gjë që ne e kemi shprehur, edhe unë kam dhënë dakordësinë, të bëjmë një redaktim atje ku thotë “pika ekzistuese 5 e nenit 22”, që të mos lëmë vetëm administratën, por edhe anëtarët e kryesisë, në mënyrë që brenda vitit ose në fillim të vitit tjetër të mblidhemi përsëri këtu së bashku, se neve do të na kërkohet, të bëjmë organigramën dhe pagat e Akademisë së Shkencave, që të mos merren më akte normative ekstraparlamentare, por të fiksohet. Zotërisë së ministrisë për këtë i thashë që të qëndrojë. Unë dhe zoti Koçi e kemi menduar si do ta formulojmë dhe do t’u themi a ka nevojë kjo nismë për mendim nga Ministria e Financave, se ky, përderisa ka ardhur këtu, e ka autoritetin...

**Flutura Aça** – Problemi është se nuk është i mandatuar, sepse nuk ka marrë asnjë shkresë. Ky është i ftuar nga ju personalisht dhe nuk është i mandatuar, sepse nuk ka marrë asnjë shkresë në dorë...

**Ismet Beqiraj** – Mua ma hidh të gjithë fajin...

**Flutura Aça** – Zoti Beqiraj, a t’ju bëj një pyetje tjetër?

**Ismet Beqiraj** – Pika e dytë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Flutura Açka** – A mbani pak qetësi. Zoti Beqiraj, më dëgjoni një sugjerim shumë miqësor...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zonja Zhupa, ju lutem!

Zoti Beqiraj, ka mundësi të bëni një draft përfundimtar tuajin me shkrim dhe ta dorëzoni sot? Ku jeni me nenin 6, sepse e keni ndërruar 5 herë?

**Ismet Beqiraj** – Neni 6 nuk është ndërruar asnjëherë.

**Flutura Açka** – Edhe sot në parashtrim e ndryshuat. Ju lutem shumë, sepse dje në parashtrimin tuaj e hoqët dhe sot e vendosët.

**Ismet Beqiraj** – Nuk është futur, sepse ne e deklaruar që u tërhoqëm nga neni 6...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Flutura Açka** – Në asnjë mënyrë! Nuk ka asnjë nuancë të kësaj natyre. A mund të bëj një pyetje tjetër: a e dëgjuat ju zotin Gjinushi se çfarë tha?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti Beqiraj, konkludoni.

**Ismet Beqiraj** – Çfarë do të mbetet në nenin 6, meqë ju e keni merak. Të shprehet edhe përfaqësuesi i ministrisë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

E ka merak ajo këtë punë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ja, se ju sqaroj unë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ka mundësi, ju lutem?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

A ma dhatë fjalën?

Meqenëse te neni 6 i projektligjit është hequr pika 6, që shton te neni 22...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Flutura Açka** – Ju lutem, se po flet zoti Beqiraj!

**Ismet Beqiraj** – Ne kemi depozituar shtimin e një pike pas pikës 5 të nenit 22 të ligjit ekzistues dhe këtë pikë unë bashkë me zotin Koçi e kemi rrëzuar.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Flutura Açka** – Insinuata seksiste për zonjat në këtë parlament nuk bëj kurrë, sepse është jashtë etikës dhe moralit tim. Zotëri, këtu janë bërë insinuata seksiste nga kryetari i Akademisë së Shkencave dhe është e turpshme. Kjo është e turpshme për mua si zonjë dhe kryetare e Komisionit që ta dëgjoj këtë fjalë nga kryetari i Akademisë së Shkencave, por juve ju duket një hiçmosgjë. Ky është mendimi juaj.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ismet Beqiraj** – Ta vazhdoj apo ta mbyll sqarimin tim? Nenin 6 të projektligjit, i cili është shtimi i pikës 6 te neni 22, ne e tërhoqëm, sepse ka të bëjë me pagat dhe do mendim nga Ministria e Financave.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ja çfarë thotë formulimi i ri...

**Flutura Açka** – Zoti Beqiraj, ma jep me zë dhe me figurë formulimin e nenit 6.

**Ismet Beqiraj** – Neni 6: “Në nenin 22, pika 5 e ligjit ekzistues pas fjalës “administratën”, shtohet togfjalëshi “dhe anëtarët e kryesisë” dhe hiqet togfjalëshi “me propozim të kryesisë”. Pra, pika 5 riformulohet: “Struktura, organika dhe niveli i pagave për administratën dhe anëtarët e kryesisë përcaktohen nga asambleja, e cila ia paraqet Kuvendit për miratim”. Pra, është futur togfjalëshi “dhe anëtarët e kryesisë”. Është bërë një rregullim, sepse administrata është administrata formale dhe është lënë kryesia...

**Flutura Açka** – Faleminderit, zoti Beqiraj!

Fakti që ndërhyni në një nen që ka lidhje me financat dhe që preket një nen që ka të bëjë me strukturën e pagave, nuk është në kompetencën tonë ta kalojmë këtë nen.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ndërhyni ju. Fakti që ju ndërhyni. Ne nuk mund ta bëjmë dot. Ky komision duhet ta marrë me shkrim dhe ta depozitojë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ai mund të japë mendimin e tij, por duhet të vijë nga Këshilli i Ministrave me shkresë, me numër protokoll, se nuk ka asnjë efekt financiar...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nenin numër 6 nuk e kaloni dot, pa ardhur shkresa nga Këshilli i Ministrave, kështu që ju sugjeroj...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Petro Koçi** – Të dyja nenet që propozojmë për financat, nuk kalojnë, por të kalojë e gjithë pjesa tjetër e projektligjit. Kjo është e tepërt, sepse pretendimi juaj është vetëm justifikim...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Në rregull, nuk do t'i kalojmë ato nene.

**Flutura Açka** – Zoti Koçi, nuk ju pranoj asnjë aludim...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Keni 8 orë që talleni me ne. A është neni 6, po apo jo? Keni 8 orë që talleni me ne...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Petro Koçi** – Kjo që po bëni ju tani, është tallje. Vazhdo votimin, sepse këtë po e bëjmë vetëm për të zbatuar një kapriçon tuaj për ta rrëzuar atë nen. Edhe fëmijët e kopshtit e kuptojnë se nuk ka efekt financiar.

**Flutura Açka** – Zonja Bakiu ka një ndërhyrje për procedurë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Merita Bakiu** – Faleminderit, zonja kryetare!

Me gjithë respektin që kam, gjithmonë jemi munduar që t'i kalojmë gjërat me konsensus dhe nuk e kuptoj pse duhet të jetë gjithë ky nxitim që ky projektligj të kalohet sot patjetër, kur edhe ju e kuptoni vetë që sikur ta kishit këtë vullnet të gjithë ju të mazhorancës me ligjin e dekriminalizimit, dekomunistizimit, për Spaçin, por nuk e patët këtë lloj vullneti, sepse do të kishin kaluar të gjitha ligjet. Nuk e patët këtë lloj vullneti, ndërsa sot i sillni njerëzit nga ministria pa u shkuar letra zyrtare, duke thënë se duhet kaluar ligji. E shikoni korrekte ju këtë lloj sjelljeje?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nuk është fare korrektësi, zoti Koçi, me gjithë respektin që kam. Ju keni sjellë njerëzit pa shkresë zyrtare.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Faleminderit, kryetare!

**Petro Koçi** – Thatë se duhet Ministria e Financave dhe Ministria e Arsimit, por për këtë nuk morëm vendim si komision...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Vendimet votohen.

E para, Ministria e Arsimit nuk është përgjegjëse për ligjin dhe, kur bashkëpunoi herën e parë, e ka bërë, sepse ia kanë kërkuar.

E dyta, Ministria e Financave është shprehur se, po të ketë efekte financiare, ne jemi kundër, prandaj ne hoqëm dorë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Flutura Açka** – Këtë po përpiqem t’ju shpjegoj se është shkelur procedura, sepse zoti Opre ka ardhur i ftuar privatisht dhe nuk ka ardhur në mënyrë zyrtare.

**Ina Zhupa** – Nenin 6 mund ta miratojë Kuvendi dhe ne mund të jemi shumë dakord për këtë dhe nuk kemi pse e heqim. Ne duhet të jemi dakord që ta çojmë te Këshilli i Ministrave...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Flutura Açka** – Ju keni anashkaluar komisionin, pasi zotëria ka ardhur me urdhrin tuaj dhe jo prej shkresave zyrtare të komisionit.

**Ina Zhupa** – Pse ka ardhur zotëria i financave?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Duhet shkresa.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Flutura Açka** – Ka ardhur zoti Spaho, por ka sjellë një shkresë 48 orë përpara...

*(Diskutime pa mikrofon)*

Më lejoni t’ju shpjegoj! Ju lutem, të bëj shpjegimin! Zoti Opre ka ardhur, por ka sjellë dy ditë përpara shkresën dhe ka ardhur të mbrojë sugjerimin që i bën këtij komisioni, por sot nuk ka ardhur i përgatitur, sepse nuk kam marrë shkresë. E keni ftuar ju, nuk e kemi ftuar zyrtarisht. Nuk e ka sjellë mendimin e tij zyrtarisht, sepse nuk është njoftuar me shkresën tonë...

**Petro Koçi** – Le të kalojmë në votim.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Flutura Açka** – Duhet të dini një gjë se zoti Opre ka ardhur këtu prej jush. I ftuar me forcën që keni ju në pushtet dhe me të drejtën që ju jep vota...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Çfarë do të bëni me nenin 6? Do të vazhdojmë, apo jo?

Menjëherë pas shkresës do ta votojmë.

Faleminderit!

## **MBYLLET MBLEDHJA**

